

Mirditë, Gjon Ndoj: Emërimet i bën deputeti Mark Marku

Arkëtarja e bankës: Si mi grabiti lekët Viktor Gushi

Fitojmë gjyqin, nuk kemi besim te drejtësia shqiptare

Vrasja e kambistit në Durrës, 62 të shoqëruar në polici

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI III - NR. 21 E martë, 29-01-2013

Fjalëkryqet e fundit nga Kadri Vokopola

▶ Faqe 23

DESHMITE E MARINAREVE

Anija erdhi nga Greqia, ndaloi në Durrës dhe u ngarkua në Mal të Zi

TRAFIKU I ARMEVE SERBE JEMENI BURGOS SHQIPTARET

Tre marinarët shqiptarë në anijen me 180 ton armatim dhe eksploziv me destinacion portin e Um Kasrit në Irak. Jemeni akuzon për trafik. Si u akuzua ministri Imami për tregti me serbët

Lajmi

Një anije me marinarë shqiptarë, prej mesit të dhjetorit është ndaluar në një port të Jemenit, nën akuzën e trafikut të armëve, që vinin nga Serbia. Marinarët, tre prej të cilëve shqiptarë do të dalin sërish nesër para gjyqit, ndërsa rrezikojnë të dënohen.

■ ■ ■ SANAA

Një anije e ngarkuar me municion dhe armë, nisur nga Mali i Zi është kapur në portin e Al Mukallës, në bregdetin e Jemenit. Anija drejtohej nga kapiteni Arif Bakilari, i cili...

▶ vijon në faqe 7

FORCA AJRORE KONFIRMON

▶ Faqe 6



Bie avioni amerikan F-16 në detin Adriatik, zhduket piloti
Aksidenti në orën 20⁰⁰. Ende asnjë gjurmë

VENDIMI

▶ Faqe 16

Vrau 18-vjeçaren, 25 vite burg Shaban Norjas

STUDIUESI

▶ Faqe 18-19



Ylli Polovina: Si u sajua akuza ndaj Mehmet Shehut

Koment

NGA PREÇ ZOGAJ

“Referendumi” i dytë pa kundërshtarë

Berisha hodhi dje idenë e Organizimit pas zgjedhjeve të një referendumi popullor për tre ligjet e pavotuara të paketës së statusit. Kushdo që e merr seriozisht këtë njoftim do të ndihet i befusuar dhe i çuditur.

Së pari, sepse çështja e mosvotimit të tre ligjeve të mbetura është kaq e njohur, kaq e debatuar dhe kaq e ndjeshme për publikun shqiptar sa, nëse nuk zgjidhet deri në fund të legjislaturës, zgjedhjet politike të 23 qershorit do të japin një verdik popullor edhe për të. Ç’kuptim ka në këtë kontekst një referendum pas zgjedhjeve për një çështje të gjykuar nga zgjedhësit? Asnjë kuptim.

Së dyti, ngërçi i krijuar për tre ligjet, për vetë natyrën e tij, zgjidhet më mirë me zgjedhje. Kurse me referendum nuk e di as si do të shtrihet, pasi referendumi politik, si rregull, kërkon nga publiku të shprehë me votë “po” ose “jo” për një temë a për një ligj ku palët politike kanë pikmëmje të kundërta. Për tre ligjet PS nuk ka thënë se është kundër, por e ka lidhur votimin e tyre në Kuvend me zgjedhjen e problemit të krijuar në këshillin e qarkut të Fierit. PS ka shkuar me mendimin se kishte në dorë një...

▶ vijon në faqe 20

LISTAT E PARTIVE

Zgjedhjet, kandidatët për 12 qarqet

PS, PD, LSI, FRD dhe AK piketojnë emrat. Sondazhi, opozita 80 mandate

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Partitë politike kanë nisur piketimin e kandidatave për zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit të këtij viti...

▶ Faqe 10-11

LIVE FROM LIFE

▶ Faqe 20



LIRI PËR NJË TË MAJTË NË ROBËRI!

NGA ANJEZA SHATKU



HIPOTEZA E KUSHËRIRIT

▶ Faqe 12-13

Adriatik Llalla, pinjoll i Gjergj Karaiskaqit?

Analiza e historianit Arben Llalla. Kristo Papa nga Suli



NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Ushqime aziatike dhe meksikane
Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës, km 7, Yrshok Tiranë, Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



Miratojen sot procedurat verifikuese të dokumentacioneve

KQZ pritet që të miratojë mbledhjen e sotme projekt-udhëzimin "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidatit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve". "Në nenin 67, nenin 68, nenin 69, nenin 71, nenin 72 dhe nenin 73 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

parashikohen procedurat për depozitimin, verifikimin dhe miratimin e listave shumëmbetore të partive politike dhe dokumentacionit të rregjistrimit të kandidatit të propozuar nga Zgjedhësit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe përcaktimin e afateve për publikimin e listave të kandidatëve, për zgjedhjet për Kuvendin", thuhet në relacion. Gjithashtu

mbledhjen e sotme pritet dhe projektudhëzimi për miratimin e rregullave për hedhjen e shortit për caktimin e anëtarëve që relatojnë kërkesat ankimore të regjistruara në kqz. "Kodi Zgjedhor i ndryshuar, në nenin 129, paragrafi i parë, parashikon se për çdo kërkesë ankimore të regjistruar KQZ-ja cakton me short si relator një nga anëtarët e saj", thuhet në relacion.

Nuk futet në rend të ditës kërkesën e pakicës, debate dhe akuza

KQZ rrëzon PS, mandatet i ndan Kuvendi të enjten

Biba: Po riktheni "Dushkun", së shpejti fakte për Kukësin

■ ■ ■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve refuzoi të fuste në rendin e ditës kërkesën e tre anëtarëve të majtë për të rivotuar ndarjen e mandateve parlamentare për zgjedhjet e ardhshme. Pas miratimit me konsensus të dy pikave të rendit të ditës, kryetarja e KQZ, Lefterie Lleshi refuzoi kërkesën e tyre, pasi kjo çështje tashmë është në shqyrtimin e Parlamentit. Gjithësesi përballë argumentit të Lleshit si dhe përfaqësuesit juridik demokrat, Niaz Kosovrast, nënkryetari Denar Biba sqaroi se neni 22 i Kodit Zgjedhor, i jep të drejtë 2 anëtarëve të KQZ të thërrosin mbledhjen, për çështjet që dëshirojnë dhe kjo duhet të pasohet nga futja automata në rendin e ditës e ndarjes së mandateve.

DYSHIMET PËR LËVIZJEN

Një tjetër shqetësim i ngjitur në mbledhjen e sotme nga ana e kreut të sekretariatit zgjedhor të PS-së në KQZ-zë, Genc Gjonçaj, kishte të bënte me lëvizjet demografike, sipas tij, të qëllimshme, të bëra në prag zgjedhesh. Gjonçaj i drejtua komisionit me kërkesën për të hetuar mbi lëvizjet e qytetarëve drejt zonave verilindore, pikërisht në periudha parazgjedhore, pasi sic i shpreh ai, së shpejti do dalin fakte për manipulimet që janë bërë.

RREZIK PËR FENOMENIN "DUSHKUN"

Menjëherë sapo përfundoi mbledhja Denar Biba në një prononcim për median, po nga KQZ, akuzoi kryetaren Lleshi se po shkel ligjin. "Po përpigjen të na mbyllin gojën. Nuk duan që qytetarët të mësojnë përmes nesh. Këtu kemi Kodin Zgjedhor, ta lexojnë të gjithë qytetarët. Kryetari ose të paktën dy anëtarë të KQZ thërrosin mbledhjen"- tha

Lajmi

Ashtu siç pritej KQZ nuk futi dje në rend të ditës kërkesën e pakicës në komision për të rimarrë çështjen e ndarjes së mandateve, e cila pritet që të kalojë në votim ditën e enjte në Parlament, pas ezaurimit të procedurave në Komisionin e Ligjeve. Mazhoranca do të votojë për ndarjen e mandateve si në 2009.

Biba. Sipas tij koha e ndarjes së mandateve nuk ka mbaruar pasi afati është deri më 7

mars dhe e vetmja gjë për të cilën u kërkojnë falje shqiptarëve, është se si anëtarë të

KQZ-së nuk kanë më fuqi ligjore për të vepruar më tej mbi këtë çështje. "Familje të tëra me nga 30-40 anëtarë të gjithë një mbiemër. Fakte të tjera në lidhje me punësimin e tyre do të zbulohen", tha Biba.

TRAJNIMI I KOMISIONERËVE

KQZ miratoi dje strategjinë e trajnimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore për

zgjedhjet e 23 qershorit. Në strategjinë e miratuar parashikohet kualifikimi i komisionerëve të niveleve të dyta dhe të treta për administrimin e procesit zgjedhor. Në ndryshim nga vitet e mëparshme këtë vit të gjithë trajnerët që do të angazhohen për trajnimin e komisionerëve të KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve do të përgëndrohet në Tiranë. Do të jetë 52



numri i trajnerëve sipas kësaj strategjie, të cilët do të trajnojnë rreth 280 komisionerë të niveleve të dyta dhe të treta.

Kërkesa për mandatet

Debate për rrëzimin e kërkesës dhe Kukësin

Shqetësimi: Po kërkon të fusni në konflikt Kuvendin me KQZ. Gjonçaj: Mandatet e 2009 në shkelje të ligjit

■ ■ ■ TIRANE

Biba: Kukësi nga 3 mandate që normalisht duhet t'i takonin, kapërcën e shkon në 4. Impakti ishte i jashtëzakonshëm. Nuk ishte një shtim natyror i qytetarëve. Ai informacion që nuk patëm mundësi ta kishim, ne e kemi sot këtu. Auditit, që njëri prej tyre, ai që erdhi si propozim i nënkryetarit të KQZ, më ka sjellë disa informacione, duke paratur parasysh situatën sesi po vepronhet në vend, gjithçka e gjetëm me vend që tashmë që kemi këto informacione ta rimarrim situatën aty ku e lamë. Jemi koherent me vetveten. Kërkuam informacionin, e morën dhe ja ku jemi përsëri. Është një vendim me 7 vota për mosndarjen e mandateve. Një nga arsytet që nuk e futëm në rend të ditës është frika për të votuar sërish atë. Ne duam që ta fusim në rend të ditës kërkesën tonë, është një shkelje e ligjit që po bëhet ditë më diell.

Lleshi: Nuk ka objekt për ta futur në rendin e ditës. KQZ e ka marrë një vendim. Përgjegjësia e zgjedhjeve mbajeni ju, se jeni bërë ju pengesë.

Biba: Ne jemi pro ndarjes së mandateve. Le ta bëjmë sot. Por një nga arsytet që nuk futëm në rend të ditës është frika juaj, sepse fare mirë mund ta kishit votuar kundër. Tashmë kemi informacionin dhe ne jemi të gatshëm të votonim. Jeni në shkelje të ligjit ditën për diell.

Lleshi: Ne se kemi lënë askund.



Genc Gjonçaj

Ne e kemi mbyllur procesin. Procedura është ezauruar. Sipas Kodit Zgjedhor i ka kaluar Parlamentit. KQZ nuk ka më tagrin për të rikthyer e rimarrë shqyrtimin e ndarjes së mandateve. Ju mund t'i drejtoheshit Kolegjit Zgjedhor nga pikëpamja procedurale.

Biba: Nuk kam tagër t'i drejtohem Kolegjit.

Lleshi: Parlamenti e ka në dorë procedurën. Ka kaluar në konferencën e kryetarëve, komisionin e Ligjeve dhe do të kalojë në Parlament. KQZ nuk ka më punë me caktimin e mandateve. Ju nuk votuat as në parim. Procedura në parlament, ne nuk kemi të bëjmë më me mandatet.

Gjonçaj: Është një e drejtë e dhënë nga ligji. Jemi para abuzim-

it. Kjo është hera e tretë, që nuk futet në rend të ditës. Ky nuk është ligji ju po abuzoni me detyrën. Është detyrë e kqz ta rimarrë në shqyrtim. Këtu kemi pikëpyetje shumë të madhe, kemi pikëpyetje zgjedhjet e 2013 dhe marrja e kompetencës nga Kuvendi në çdo arsyetim, sikur t'i kthehet variantit të KQZ-së ose sikur të marrë variantin e 2009 është e paligjshme, i bën zgjedhjet nul, ne e dimë këtë gjë. Përse ta vemë në pikëpyetje procesin e 2013.

Shylla: Ne kemi vënë në dispozicion disa fakte. Përsa i përket faktit që tashmë le të themi që anëtarët e pakicës kanë shkelur ligjin, nuk mendoj kurrësesi që të veprosh në drejtim të dispozitave ligjore, të shkelësh kodin. Është në dinjitetin e

këtij komisioni që të fusë në rendin e ditës këtë çështje të tre anëtarëve të KQZ, së pari për të futur në rrugë ligjore procesin që duhet të kryhet për ndarjen e mandateve.

Shqetësimi: Na propozoni që të marrim në shqyrtim çështjen e ndarjes së mandateve, në kushtet kur ndarja e mandateve është në shqyrtim parlamentar. Çfarë na propozoni ju? Na propozoni që të ndajmë mandatet, çështjen që ju e dini mirë se ju kemi kundërshtuar procedurën. Ajo çështje pret të trajtohet në seancën parlamentare. Ju tentoni të ndërhyri në kompetencat mes KQZ dhe Kuvendit të Shqipërisë. Po propozoni që të ngrini një konflikt të pastër mes dy institucioneve.

Muho: U përmend në diskutime që informacionin vjen nga një audit i propozuar në këtë pozicion, unë shikoj që veprimet e kolegëve nuk kërkojnë ndarjen e mandateve, por politizimin e kësaj çështje. Të kërkojë gjithë ato gjëra te ministri i Brendshëm, do të thotë që nuk jeni për ndarjen e mandateve.

Lleshi: Për anëtarët e tjerë e kemi mbyllur procedurën, për ty ndoshta jo. Procedura tashmë i ka kaluar Parlamentit. KQZ nuk ka më tagrin t'i rikthehet dhe të marrë në shqyrtim mandatet. Nuk kemi më punë me caktimin e mandateve, ju vetë nuk votuat as në parim. Nëse do votosh në parim ka të drejtë të caktohet mandate. Argumenti juaj që unë po shkel ligjin është anti-ligjor. Ne nuk kemi më punë me mandatet.



Majko abstencion marrëveshjet mes Shqipërisë e Kosovës

Komisioni për Çështjet Ligjore, shqyrtoi dhe miratoi dje projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmyjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për transferimin e personave të dënuar", projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmyjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe

Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ekstradimin" si dhe projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmyjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndihmë të ndërsjelltë juridike në çështjet penale". Deputeti i PS, Pandeli Majko abstanoi duke theksuar se nuk mund të ketë marrëveshje dhe në gjuhën serbe. "Ishin të

nënshkruara nga ministrat e drejtësisë së dy vendeve. Arsyeja e abstencionit ishte se marrëveshjet në fjalë ishin nënshkruar në shqip dhe... serbisht. Kjo ndodh për herë të parë në marrëveshjet e nënshkruara midis dy shteteve. Mendoj se gjuha serbe nuk mund të jetë gjuhë "ndërkombëtare" për marrëveshjet midis Shqipërisë dhe Kosovës", shkruan Majko në Facebook.



Kryeministri akuzon kreun e PS-së për vjedhje mandatesh

Berisha: Rama prish zgjedhjet pa filluar

"Opozita kërkoi variantin që e quajti shpifje"

TIRANE
ARTEMISA HOXHA



Ndërkombëtar

Ai (Rama) është kaq antishqiptar, po ata njerëz që e rrethojnë si ka mundësi që ata e tolerojnë që kjo t'i bëhet vendit të tyre'. Çfarë të thosha, por sot çdo shqiptar e thotë, por nuk mund të lej disa përfaqësues të tij që kanë vite që punojnë me problemim zgjedhor që kanë dalë u kanë thënë shqiptarëve se po u grabiten mandatet....

Në foto: Berisha në mbledhjen e grupit

Përrurimi i xhamisë Basha në Maqedoni me vartës dhe zyrtarë të Berishës

Me dhjetra zyrtarë të administratë shtetërore shoqëruan të shtunën e kaluar kryetarin e bashkisë së Tiranës Lulzim Basha, në vizitën e tij zyrtare, për përrurimin e xhamisë së re në Dibër të Maqedonisë. Zyrtarisht është thënë se motivi i vizitës së të dërguarve nga Tirana ishte origjina e tyre dibrane, siç pretendoi edhe kryebashkiaku i Tiranës në fjalën e tij. Mediat nga Dibra, shkruajnë se: "Në këtë eventiment morën pjesë shumë dibranë besimtarë, në mesin e të cilëve edhe Lulzim Basha, kryebashkiaku i Tiranës, Niazzi Kosovrasti, kryetar i Këshillit të Tiranës, Xhemal Gjunkshi, shef i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë së Shqipërisë, Faruk Borova, kryetar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë, Yllka Çausholli kryetare e Komitetit për Krugën e Arbërit, Hysen Xhara, kryebashkiak i Njësisë bashkiake 4 në Tiranë, Florent Pustina, Drejtor i Infrastrukturës Tiranë, Gazmend Dibra, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve Tiranë, Flamur Gjymyshka, Drejtor i përgjithshëm i Doganave Tiranë, Ilir Krosi, kryetar i Bashisë së Peshkopisë, Naim Gazid-



Basha në Dibër të Maqedonisë

ede, kryetar i Qarkut dhe Genc Sharku, prefekt i Peshkopisë etj". Gjatë takimeve, Lulzim Basha siguron dibranët se do të jetë garant i "Rrugës së Arbërit", madje ajo do të bëhet me dy tunele. Basha siguroi dibranët se do të jetë garant i Rrugës së Arbërit, ai tha se tuneli i Qafë Murrizit i cili largon Dibrën me Tiranën, shumë shpejt do të çahet dhe jo vetëm një tunel por dy, duke siguruar se ky do jetë bashkimi i Dibranëve të Tiranës ju dhe bashkimi i gjithë shqiptarëve. Dibra me Tiranën do jetë vetëm një kafe larg" -tha ai. Kryetari i Bashkisë së Tiranës tha se projekti i Kryeministrit për bashkim nuk duhet të tremb fqinjët, "ne nuk pushtojmë, nuk grabitojmë troje, ne jemi në trojet tona"-nënvizoi ai.

Çështja e mandateve solli ditën e djeshme dhe re agimin e kreut të qeverisë. Në mbledhjen e grupit parlamentar të PD, Kryeministri Sali Berisha deklaroi se Edi Rama kërkon të votojë variantin e KQZ, të cilin e cilësoi si grabitës mandatesh. "Në përputhje me Kodin Zgjedhor në ushtrim të plotë të kompetencave të tij, skemën e ndarjes së mandateve për zgjedhjet që vijjnë, z.Rama urdhëroi zëdhënësit e tij për t'u thënë shqiptarëve se Berisha po na vjedh mandatet dhe se zgjedhjet po vidhen dhe se zgjedhjet u prishën pa u zhvilluar. Pamë dhe tryeza në të cilat u thirrën me dhjetra përfaqësues të përfaqësive të huaja për t'i informuar për katastrofën e projektit që përgatiti KQZ. Dhe papritmas pa asnjë lloj ndryshimi, pa asnjë fakt të ri, para 3 ditësh deklarojnë se kërkojnë të votojnë variantin për të cilin nuk lanë fjalë, shpifje dhe trillim pa bërë. Dhe natyrisht nuk konsiderojnë se ka institucione, se ka ligje se duhet të vepronë sipas institucioneve, por absurdin e tyre mendojnë ta bëjnë ligj në këtë vend", u shpreh Berisha. Më tej kryeministri u tregoi ligjvënësve demokratë se çfarë i tha një ndërkombëtar për Edi Ramën lidhur me çështjen e mandateve. "Një zotëri ndërkombëtar që më tha haptazi, më tha tekstualisht, 'Ai (Rama) është kaq antishqiptar, po ata njerëz që e rrethojnë si ka mundësi që ata e tolerojnë që kjo t'i bëhet vendit të tyre'. Çfarë të thosha, por sot çdo shqiptar e thotë, por nuk mund të lej disa përfaqësues të tij që kanë vite që punojnë me problemim zgjedhor që kanë dalë u kanë thënë shqiptarëve se po u grabiten mandatet dhe tani u thonë, kërkojmë atë projekt që grabite mandatet e shqiptarëve. Nuk ka njeri, më ekstrem njerëzor dhe fatkeqësi më të madhe sesa në një vend të lirë, të zhveshë nga çdo anagram dinjiteti njerëzor", u shpreh Berisha në mbledhjen e grupit të PD.

Dështon ligji për nëpunësin Rusmali: Referendumi popullor do tu lejë si peshku në zall

TIRANE

Rikthehet dhe një herë në Komisionin e Ligjeve shqyrtimi i një preli ligjeve që kërkon shumicë të cilëduar në Parlament. Bëhet fjalë për ligjin "për nëpunësin civil", i cili ngjalli mjaft debate mbledhjen e djeshme. Demokratët dështuan në tentativën e tyre për miratimin me konsensus të ligjit për këtë ligj, që kërkon edhe konsensusin e opozitës në Parlament. Në mbledhjen e djeshme të Komisionit të Ligjeve, mazhoranca miratoi vetëm me votat e saj projektligjin që pritet të përmirësojë rregullat e punësimit në administratës publike dhe mbrojtjen e nëpunësve nga shkarkimet pa shkak. Deputetët e opozitës u larguan nga mbledhja, pasi sipas tyre ekstradimi i "Qarkut të Fierit" për të votuar më pas ligjet me 3/5 në Kuvend. Nënkyetari, Fatmir Xhafaj, rikonfirmoi qëndrimin e opozitës se pa zgjidhjen e problemit të kreut të këshillit të Qarkut Fierit, opozita nuk do të japë pëlqimin e saj për ligjet që kërkojnë 3/5. "Ne nuk do të jemi pjesë e këtij projekti, i këtij diskutimi sepse ju nuk keni zgjidhur atë që ne e konsiderojmë të rëndësishme, këshillin e qarkut të Fierit, i cili është pushtet i qeverisjes vendore, të cilin ju e keni grabitur dhe e mbani peng. Po në fakt, ju mbani peng zbatimin e ligjit", tha deputeti i PS-së, Xhafaj. Por, kryetari i Komisionit, Ilir Rus-



Komisioni i Ligjeve

mali, u shpreh se ky qëndrim i opozitës ka vetëm si synim, të pengojë integrimin e vendit. "Nuk e doni as ta votoni dhe as t'i jepni pëlqimin për një motiv të thjeshtë. Nuk keni probleme me ligjin, e keni me integrimin e Shqipërisë. Pikë. Çdo gjë tjetër është e kot që diskutohet. Siç ua kam bërë të qartë dhe kryetari i PD-së, referendumi popullor do tu lejë si peshku në zall. Të shkretët ju! Mesa duket qytetarët do ta marrin vetë në dorë këtë situatë", u shpreh Rusmali. Ligji pritet që të sjellë një sërë ndryshimesh edhe në ligjet e tjera të cilat kërkojnë 3/5. Gjithsesi miratimi i ligjit për "Nëpunësit Civil", mbetet i pamundur pasi kërkon 3/5.



Koplik, Topi: Një absurd kthimi nga komunist në demokrat

Nën moton "Për Shtetin dhe Shqiptarët" Kryetari i FRD Bamir Topi zyrtarizoi degën vendore në rrethin e Malësisë së Madhe. Nga Kopliku, Topi sulmoi Berishën duke u shprehur se është absurde se si një ish-komunist të kthehet në demokrat. "Sot politika gjithnjë e më shumë bëhet përrëth 3-4 restoranteve në qendër të Tiranës dhe kjo është më e padënja për politikanët shqiptarë,

ndërkohë kur vijnë periudhat elektorale pushtetarët tanë veshin rrobat e terrenit për të treguar se janë njësoj si ju por që në menyrën më absurde tregojnë mungesë sinqeriteti", ka deklaruar Topi në Malsi të Madhe. Njëherësh ai ka evidentuar faktin se modeli i liderëve shqiptarë i ngjason atyre të lindjes të cilët ngulen në karrixe për shumë vite, ndërsa nuk ka lënë pa përmendur edhe opozitën të cilën e ka

cilësuar si opozitë të dobët që nuk ka bërë detyrën e saj së duhet. "Kryeministri ka frikë se po humbet pushtetin, ndërsa nga ana tjetër kryetari i opozitës ska frikë se nuk vjen dot në pushtet", deklaroi kreu i FRD. Topi u shpreh se qëllimi i FRD është për ta kthyer politikën në favor të qytetarit ndërkohë që la të kuptohet se pas datës 23 Qershor FRD do jetë një forcë politike vendimmarrëse në shërbim të qytetareve.

Partitë piketojnë emrat. Rama, Berisha, Meta, Topi, Spahiu "kokë më kokë" në Tiranë

Zgjedhjet ja kandidatët e mundshëm për të 12 qarqet

S'ka lëvizje, "bërthama" e listave, grupet aktuale parlamentare

Lajmi

Partitë politike kanë nisur piketimin e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit të këtij viti. Boshiti rreth të cilit, me disa ndryshime të vogla janë listat e deputetëve aktualë por dhe figura të reja e qarkullime brenda qarqeve.



Përballja

Risi, vënia përballë Berishës në krye të listës së kandidatëve për deputetë të qarkut të Tiranës e liderit të opozitës, Rama. Për herë të parë një përplasje kokë më kokë mes tyre. Në kryeqytet mësohet se kandidon dhe kreu i LSI Meta, kreu i FRD Topi si dhe kreu i AK Spahiu.



TIRANE

Partitë kryesore politike kanë nisur piketimin e kandidatëve për deputetë, që do përfshihen në listat shumëemërore sipas qarqe për të përballur me qytetarë gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit të këtij viti. Më të avancuara janë dy partitë e mëdha, PS e PD, por dhe partitë e tjera LSI e Metës, FRD e Topit dhe AK e Spahiu. Që janë në procesin e diskutimit dhe të evidentimit të njerëzve që kanë më shumë mbështetje në komunitet ku pritet të konkurrojnë për të thithur sa më shumë vota më 23 qershor. Dy partitë e mëdha politike, PS e drejtuar nga Edi Rama e PD e drejtuar nga Sali Berisha s'kanë bërë shumë ndryshime përsa i përket listave të kandidatëve për deputetë sipas qarqeve, duke u rrotulluar e përdorur si "bërthamë" të tyre listën e deputetëve aktualë. Por dhe duke shtuar figura të tjera politike, si dhe duke lëvizur kandidatët për deputetë, kryesisht në drejtimin e listave në disa qarqe. Kështu PS mësohet se përpos vendosjes së emrave të deputetëve aktualë, do lëvizë Ben Blushin nga qarku i Korçës në qarkun e Elbasanit, ndërkohë që Valentina Leskaj pritet të kryesojë listën e kandidatëve për deputetë të qarkut të Vlorës. Mësohet gjithashtu dhe afrimi i intelektualëve në kandidimin për PS, ku tashmë risia më e madhe është vënia përballë Berishës në krye të listës së kandidatëve për deputetë të qarkut të Tiranës, të vetë liderit të opozitës, Edi Rama, duke na prezantuar tashmë për herë

të parë një përplasje kokë më kokë mes tyre. Por që në kryeqytet mësohet se kandidon dhe kreu i LSI Meta, kreu i FRD Topi si dhe kreu i AK Spahiu. Dhe PD mësohet se është mbështetur në listën e deputetëve aktualë, duke shtuar në lista e disa nga zv.ministrat më të suk-

sesshëm, siç bëhet fjalë në qarkun e Fierit, në të Tiranës, por dhe në qarqe të tjera. Nga ana tjetër demokratët kanë tentuar të ruajnë balancat, ndërsa nuk përjashtohen mundësitë

për ndryshime radikale në këto lista, për shkak të përllogaritjes së forcave deri në momentin final ligjor kur listat përfundimtare të dërgohen në KQZ për tu "mbyllur" përfundimisht

deri në pritje të rezultatit pas zgjedhjeve të 23 qershorit. Dhe për PS për partitë e tjera, listat e kandidatëve të mundshëm për deputetë sipas qarqeve s'janë përfundimtare, pasi do ndryshohen deri në momentet e fundit, në varësi të situatave politike dhe në varësi të listave

të rivalëve politikë. Për më tepër listat e publikuara nga ne, jo domosdoshmërisht kanë këtë renditje, por janë marrë sipas burimeve nga degët e partive nëpër rrethe dhe seksibiliteteve që kanë për kandidatët e mundshëm për zgjedhjet e ardhshme.

LISTA E PJESSHME E MUNDSHME KANDIDATEVE TË PD, PS, LSI, FRD E AK PËR ZGJEDHJET E 23 QERSHORIT 2013

LISTA E PD	TIRANE	VLORE	LEZHE	GIROKASTER	BERAT	KUKES	FIER	DURRES	DIBER	KORÇE	SHKODER	
Florian Mima Ilir Rusmali Myqerem Tafai Luan Skuqi Viktor Gumi Arben Ristani Lajla Përnaska Vath Tabaku Edit Harxhi Taulant Bino Ermal Dobi	Sali Berisha Aldo Bumçi Rajmonda Bulku Keltis Kruja Eno Bozdo Majlinda Bregu Gert Bogdani Gent Strazimiri	Astrit Patozi Arben Qirjako Leonard Demi Kreshnik Cipi Kosta Barka Glori Hysi Agron Shehu Lorena Imeri	Edi Paloka Mark Marku	Genc Ruli Spiro Ksera Teuta Kalemi	Genc Pollo Mehmet Xheka Lefter Maliqi Dhori Kule Miranda Haxhia	Flamur Noka Besnik Dusha Fatos Hoxha	Sokol Olldash Alfred Rrushaj Mesila Doda Enkelejd Alibeaj Fatos Beja Vasiljaq Ngresi Blerim Koreshi Ferdinand Murati Ilir Bano	Ferdinand Xhaferri Albana Vokshi Osman Metalla	Jemin Gjana	Sherefedin Shehu Selami Xhepa Bedri Hoxha Mirjana Bulku	Eduard Halimi Igli Cara Ndrim Babasi Ylli Lama Dardan Domi	Rahim Çota Dashnor Sula Zyhibi Hida Aurel Blykbash Mimoza Haseku
LISTA E PS	QARKU TIRANE	DURRES	FIER	ELBASAN	VLORE	GIROKASTER	KORÇE	SHKODER	DIBER	KUKES	LEZHE	
7. Ditmir Bushati 8. Artan Lame 9. Ndre Legisi 10. Enkelejd Shkrelli 11. Eduard Shalisi 12. Xhemal Qefallia 13. Dashamir Peza 14. Ilir Gjoni 15. Artan Gajçi 16. Auron Tarë 17. Rakip Suli 18. Elisa Spiropali 19. Shpetim Cami 20. Pajtim Bello 21. Parid Cara	1. Edi Rama 2. Vasilika Hysi 3. Saimir Tahiri 4. Besnik Baraj 5. Namik Dokle 6. Fatmir Xhafa 7. Eglantina Gjermani	1. Blendi Klosi 2. Klodian Spahiu 3. Hazir Gashi 4. Gazmir Bishqga 5. Edison Konomi 6. Gëzim Agasi	1. Gramoz Ruçi 2. Bashkim Fino 3. Albert Çaçi 4. Piro Lutaj	1. Ben Blushi 2. Ilir Bejta 3. Shegush Ligori 4. Taulant Balla 5. Damian Gjiku 6. Agim Leka 7. Skënder Hasa 8. Ndrim Hysa	1. Valentina Leskaj 2. Arben Isaraj 3. Luiza Xhuvani 4. Arben Malaj 5. Eltar Deda	1. Armando Subashi 6. Ervin Çuko 7. Arben Çajko 8. Arjon Muça 9. Anduel Xhindi 10. Dritan Prifti 11. Fatos Klosi 12. Lidia Gjermani	1. Pandeli Majko 2. Mimi Kodheli 3. Alfred Dalipi 4. Arben Ahmetaj 5. Ollta Xhaçka 6. Irena Kallço 7. Demir Agastra	1. Aslan Dogjani 2. Rexhep Ukperaj 3. Ylber Duraku	1. Ilir Bejta 2. Tom Doshi 3. Paulin Sterkaj 4. Ndue Kola 5. Astrit Beçi	1. Aslan Dogjani 2. Rexhep Ukperaj 3. Ylber Duraku	1. Gjovalin Kadeli 2. Armando Prenga 3. Gjok Jaku 4. Ndre Deda	
LISTA E LSI	TIRANE	VLORE	GIROKASTER	KORÇE	DURRES	FIER	SHKODER	DIBER	KUKES	LEZHE		
Ilir Meta Edmond Haxhinasto Klajda Gjoshja	Nora Malaj Dritan Ylli	Edmond Panariti Shkelqim Selami	Vangjel Tavo	Zef Cupi Qemal Elezi	Leter Koka	Nora Malaj Dritan Ylli	Belma Muka	Sali Shehu	Aleksander Biberaj	Fran Kaçorri		
LISTA E FRD	TIRANE	DURRES	FIER	SHKODER	DIBER	KUKES	LEZHE	DIBER	SHKODER	VLORE		
Bamir Topi Sajmir Shehri	Gazmend Oketa	Leter Koka	Monika Kryemadhi Spartak Braho	Belma Muka	Sali Shehu	Aleksander Biberaj	Fran Kaçorri	Sali Shehu	Belma Muka	Myslim Pasha		
LISTA E AK	TIRANE	VLORE										
Kreshnik Spahiu	Myslim Pasha											



Berisha ironizon Ramën për aleancën me komunistët

Kryeministri Berisha ka ironizuar koalicionet më të fundit të Ramës për zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit, duke përmendur përfshirjen në këtë aleancë dhe të komunistëve. Duke shuar për një moment aleancën e tij të 8 majit me të ndjerin kreun komunist Hysni Milloshi, Berisha ka përmendur djalin e ish-diktatorit, Ilir Hoxha, që s'është për hir të së vërtetës pjesë e asnjë prej partive komuniste

e PPSH. "Ju e patë, më së fundi edhe Lila mungonte aty në koalicion dhe Lila u ul në tryezën e koalicionit me Ramën. Është fjala për Ilir Hoxhën. Një bashkëbiseduesi im në Facebook këto ditë më tha se në atë darkën e gabuar nuk rezultoi të jetë folur për Enverin. Në fakt aty për Enverin u fol më gjatë se për çdo gjë tjetër dhe u fol pikërisht nga Edi Rama, Spartak Ngjela dhe Koço Kokëdhima. Por, shpresoj që mikun tim të

rrejtet social ta bind fakti se pardje krahas Fiqiri Xibrat qëndronin dhe dy partitë komuniste, njëra e Nexhmijes që përfaqësohej nga djali i saj dhe tjetra e Vitos, e përfaqësuar nga akrahaja e saj. Këto janë risitë e fundit në kampin e zotit Rama, në radhët e tyre", tha Berisha në mbledhjen e grupit parlamentar të PD. Duke kërkuar nga deputetët që të zbrisin në bazë për të rreguar mirëqeverisjen nga kjo mazhorancë.

Socialistët paralajmërojnë se opozita arrin në 80 mandate

Sondazhi i PS: Ne 72 deputetë PD vetëm 54

Tek 60 mandatet e mazhorancës futen dhe të LSI

TIRANE

JAKIN MARENA

Socialistët mendojnë se Berisha bashkë me aleatët s'merr më shumë se 60 deputetë në zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit të këtij viti. Këtë qëndrim ata e

mbështesin në një testim që i kanë bërë elektoratit në të 12 qarqet e vendit, ku sipas tyre rezultoni se PS do fitojë rreth 72 deputetë në zgjedhjet e 23 qershorit. Ky ka qënë përfundimi i një sondazhi të kryer nga strukturat e saj. Gjatë mbledhjes së Asamblesë Kombëtare të PS, kreu socialist, Edi Rama informoi anëtarët me rezultatet finale të këtij sondazhi, duke u shprehur se opozita fiton e gjitha bashkë 80 mandate deputetësh, ndërkohë që PD nuk merr më shumë se sa 54 deputetë, duke futur ndoshta në shifrën e 6 deputetëve për të plotësuar numrin e 60 mandateve dhe LSI, PR e PDIU. Kampionin e sondazhit PS e ka gjetur në pika të ndryshme të qarqeve, ku ka mbështetës të PD e të PS, por dhe duke përdorur një përllogaritje tepër të shtrënguar, bërë mbi ndarjen e re tw zonave në bazë të ndryshimit të fundit bërë nga përfaqësuesit e saj në KQZ, dhe jo në ndarjen e mandateve të vitit 2009 që PD pritet ta miratojë në Kuvend, për të testuar mbështetjen që ekziston për të në rang vendi. Kështu besohet se rezultatet është pozitiv në Tiranë: 17 deputetë, nga 33 mandate që janë në gjithë qarqun. Sipas sondazhit të bërë nga PS, vihet re barazim rezultati me PD-në në qarqet e Elbasanit apo të Durrësit, në Dibër e Kukës. Shkrota mbetet ende një bastion i PD-së, siç rezultoi edhe nga sondazhi i socialistëve. Nga rezultatet e këtij sondazhi të PS, edhe forca e re politike e drejtuar nga Bamir Topi rezultoi me një mandat në Tiranë e në Gjirokastrë, megjithatë, këto mbeten rezultatet e një sondazhi që bëhet gati 5 muaj para ditës së zgjedhjeve. Sipas këtij testimi të drejtuesve socialistë nëpër 12 qarqet e vendit, PD këtë herë i rezultojnë të marrë shumë pak mandate deputetësh, të cilat nuk ia bëjnë të mundur qeverisjen bashkë me aleatët e saj të deritanishëm.

SONDAZHI I PS/NUMRI I MANDATEVE PËR ÇDO ZONË ZGJEDHORE

QARKU	PS	PD	LSI	FRD	MANDATE
QARKU BERAT	4 PS	2 PD	1 LSI		7 MANDATE
QARKU DIBËR		3 PD		3 PS	6 MANDATE
QARKU DURRËS	7 PS	5 PD	1 LSI	1 FRD	14 MANDATE
QARKU ELBASAN	7 PS			7 PD	14 MANDATE
QARKU FIER	9 PS				16 MANDATE
QARKU GJIROKASTËR	3 PS	1 PD		1 FRD	5 MANDATE
QARKU KORÇË	6 PS			5 PD	11 MANDATE
QARKU KUKËS	2 PS			2 PD	4 MANDATE
QARKU LEZHË	4 PD			3 PS	7 MANDATE
QARKU SHKODËR	7 PD			4 PS	11 MANDATE
QARKU TIRANË	17 PS	13 PD	1 LSI	1 FRD	33 MANDATE
QARKU VLORË	7 PS				12 MANDATE
PS NË TOTAL					72 DEPUTETË

FEJTONI

NGA BARDHYL BERBERI

Weekend mes ankthit e peshës së karrikeres së deputetit

Pogradeci është magjik edhe në stinën e dimrit. Kohë pushimesh në ditët e weekend-it. Këtë fund javë që sapo kaloi, buzë liqenit në lokalet luksoze në Tushemisht sheh të pushojnë politikanë, ministra, kryetarë partish, vajza e kryeministrit, të gjithë kanë ardhur familjarisht. Por ky është vetëm imazhi skenik i tyre të veshur sportivë apo me tuta e xhupa të trashë e kapuçë mbi kokë.

Por po t'i shikosh më imtësisht, dallon se telefonin nuk e heqin nga veshi për asnjë çast dhe sheh që mimika e fytyrës së tyre herë çelët dhe herë merr pamje të vrejtur. Pranë tyre qëndrojnë një takëm politikanësh, biznesmenë apo gazetarë të pushtetit, të cilët janë në rezonancë me shefat e tyre. Ata harrojnë dhe ngrejnë edhe tonet e zërit pasi janë jashtë kontrollit. Weekend-i i fundit në Tushemisht ishte krejtësisht specifik. Vajza e kryeministrit me bashkëshortin e saj dhe mikun francez Favre të sapodekoruar ulen të pushojnë madje me një orkestër të famshme nga Tirana, e me këngëtare me emër si Irini Qirjaqi që shpalo talentin përpara personalitetëve, e tryezave plot bollëk me qingja të pjekur e mish kaprolli, lepuj të egër, por pak entuziazëm. Sulmet që i ka bërë kohët e fundit Taulant Balla, duket se i kanë lënë një hije mavi poshtë syve.

Mbërrin edhe Ilir Meta në këtë darkë. Dikush i pëshpërit shokut:

"Më the që Iliri do të shkojë me të majtën në zgjedhje nuk e sheh se ata "hanë në një çanak"? Shikoje përbri vajzës së kryeministrit.

Është lojë, - ia pret tjetri. - Iliri do t'ia dredhë Berishës. E zemë me bast. Madje do...

vijon në faqen 20



PS, Felaj:

"Nuk ka manovër që e shpëton Berishën nga ndëshkimi me votë"

Asnjë manovër e paligjshme nuk e shpëton dot Berishën "Ae shpuren e tij nga ndëshkimi me votë popullore në 23 qershorit". Kështu është shprehur për mediat deputetja e PS, Ermonela Felaj. Duke treguar dosjen e hartuar, në bashkëpunim me nëpunës të ndershëm, lidhur me lëvizjet e popullsisë ajo tha çdo shkelës do përgjigjet para drejtësisë. "Në orvatjen e dëshpëruar për të mbajtur pushtetin që po i ikën nga duart, Kryeministri përpjetë çdo ditë të manipulojë shqiptarët me të pavërteta deri edhe absurde", tha Felaj.

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com



Forca Ajrore konfirmon, bie F-16 në Adriatik, zhduket piloti



Një avion amerikan gjuajtës model F-16 mund të ketë rënë mbremë gjatë stërvitjes në detin Adriatik, ndërsa autoritetet amerikane thanë se fati i pilotit të bazës së tyre në Itali nuk dihet. Kërkimet të mbështetura nga Roja Bregdetare e Italisë janë në rrugë e sipër, ndërsa Forcat Ajrore nuk

dhanë detaje të mëtejshme. Ata thanë vetem se "kishin humbur kontaktet" me avionin F-16 rreth orës 20.00-shprehje e përdorur për një rënie të mundshme, megjithatë zyrtarët e Forcës Ajrore nuk deshën të speculonin lidhur me incidentin. "Avioni po performonte në një mision trainimi mbi detin Adriatik, me një

person në bord. Kushtet e pilotit janë të panjohura në këto momente"-tha Forca Ajrore në një deklaratë. Roja Bregdetare e Italisë konfirmoi se po ndihmonte në operacionin e kërkim-shpëtim. Një zëdhënës në bazën ajrore të Avianos në Italinë e Veriut tha se informacione të reja do të jepen më vonë.

Përplasjet në PD-në Mirditë, flet ish-nënshkryetari

Gjon Ndoj: Emërimet i bën Mark Marku

Drejtuuesi demokrat akuzon deputetët

Lajmi

Ish-nënshkryetari i PD-së në Mirditë, Gjon Ndoj akuzoi dje në një intervistë për "Shqiptarja.com" drejtuesit e PD-së në qendër dhe deputetin Mark Marku për emërimet klienteliste dhe sabotim të degës së PD-së në Mirditë

■ ■ ■ TIRANE
ARTEMISA HOXHA

Dy ditë më parë, PD-ja Mirditë u përfsi nga debatet e ashpër për klientelizëm dhe akuzat për shpërdorim e pushtet nga drejtuesit dhe përfaqësuesit e partisë në qendër. N/kryetari i PD-së Gjon Ndoj, pasi nuk u lejua të fliste në konferencën e PD-së, hodhi një lumë akuzash ndaj deputetëve, dhe vetë drejtimin të PD-së, duke denoncuar faktin se shumë emërimet në administratën e drejtuar nga PD-ja janë bërë përmes pagesave të rrysh-feteve, duke ofruar dhe prova për këtë. Ai akuzoi deputetin e zonës Mark Marku dhe ish-kryetarin e PD-së Mirditë, Gjovalin Prenga për përcaktimin e delegatëve të konferencës në mënyrë klienteliste. Ndërsa deputeti Marku ia ktheu Ndojt se ai reagonte kështu, ngaqë nuk kishte ardhur emri për kandidat për kryetar të degës së PD-së Mirditë. Pas akuzave, Ndoj dha dorëheqjen emënjeshmë nga posti i kryetarit të PD-së dhe nga antarësia e saj. Ndërsa në një intervistë për "Shqiptarja.com", ai sqaroi akuzat, pësi për dhe çfarë parashikon për PD-në në Mirditë.

Z. Ndoj, si qëndron e vërteta e "konfliktit" me deputetin e deleguar të PD-së në Mirditë, Mark Marku pasi në një sms të shkëmbyer me atë, ju i thoni se ai ka ndryshuar qëndrimin lidhur me përfaqësimin e partisë në Parlament. Ju si e keni parë performancën e Markut si deputet?

Është e vërtetë që unë kam shkëmbyer mesazhe me z. Mark Marku dhe mesazhet nuk është etike që të nxirren në shtyp pavarësisht nga marrëdhëniet politike të momentit që mund të jenë të nderuara, por meqenëse z. Mark abuzoi para demokratëve të Mirditës duke thënë se unë isha i vetmi që i kam kërkuar të më mbështeste për të kandiduar dhe për këtë kishte edhe mesazhe, nga atëherë vendosa që t'i bëj publike. Unë asnjëherë nuk i kam kërkuar ndihmë, por i kam thënë se: "me këto veprime klienteliste do të na detyrosh të largohemi nga PD" dhe kur më tha se është për procedurë i kam thënë se po që për procedurë bjer kandidaturën tënde të votohet me mua, pavarësisht nga manipulimet që janë bërë në zgjedhjen e seksioneve dhe kjo besoj se nuk është kërkesë për ndihmë, por është sfidë. Përsa i përket performancës së z. Mark Marku si deputet, më pëlqejnë deputetët që i ngrenë problemet, por i urrej ata që ndryshe thonë dhe ndryshe bëjnë dhe kur vjen puna për të marrë përgjegjësi për një problem i shmanjen përgjegjësi. Me sa kam informacion për zgjedhjet lokale z. Mark Marku nuk ka marrë përgjegjësi për Mirditën, por i është shmangur atyre. Njëherë të tillë nuk më pëlqejnë.

Akuzat tuaja shkojnë dhe më tej, kur ju thoni se nuk keni frikë nga kërcënime të tipit pushime nga puna nëse dikush largohet nga partia. Në ditën tuaj ka patur raste të tilla për pushime nga puna për persona që kanë shprehur qëndrime të kundërta në PD? Një nga personat që ka vuar

MESAZHET E KËMBYERA:

Gjon Ndoj, Mark Marku:

Mirëbrëma! Ka 500 vjet që Mirdita i beson Oroshit, dhe është hera e parë që me daljen tënde si përfaqësues i Mirditës në parlament, po zhvendosesh. Megjithatë do e shikojmë rezultatin në qershor, sepse vetëm po i doli kundër PD-së, atëherë ajo të vlerëson. Dhe po të jap fjalën se do jem i pari, por dhe kam shumë të tjerë pas meje. Kam një avantazh se jam i pa punë, pra nuk keni mundësi me më kërcënuar për heqje nga puna, si formë presioni për reagimim tim.

Mark Marku, Gjon Ndoj:

Sa për dijeni, kandidaturat janë përcaktuar nga baza e janë kaluar nga kryesia Rrëshen, përzgjidhen nga kryesia në Tiranë dhe votohen prapë nga demokratët e Mirditës. Unë i besoj procedurës demokratike dhe e respektoj atë. Cilado qofshin kandidaturat dhe fituesit e dala prej këtij procesi përfshirë edhe ty, do të kenë urimet më të përzemërta nga unë. Te fala Marku..!

Gjon Ndoj, Mark Marku:

O po të jetë për votë, megjithë manipulimet që keni bërë në Komunën Fanë, provojeni të votoheni me mua, dhe të shikojmë se kë do votojnë demokratët e Mirditës...

jtur jam edhe unë, vetëm se nuk i përshtatesha performancës së z. Paloka. Jam detyruar të punoj jashtë qarkut të Lezhës për më shumë se 3 vjet dhe megjithëse unë kam qenë dy mandate në krye të PD, sepse ai nuk firmoste që unë të isha në ndonjë pozicion brenda

mesazhin që "vetëm po doli kundra të vlerëson" përndryshe hyn të ata gomerët që "thon ec se ky mban".

Ju lëshoni akuzat për emërimet klienteliste, ku bazohemi për këtë? Apsolutisht janë bërë



Në foto:
Deputeti i PD-së,
Mark Marku

qarkut të Lezhës. Kemi pas kandidatë të kryesisë së PD në Mirditë që i kanë hequr nga puna pasi kanë kandiduar për kryetar komune të pavarur, por njëri që mori shumë vota e afroi PD-ja menjëherë dhe me këtë nuk është rasti i parë që PD jep

emërimet klienteliste dhe për vetë faktin se askush nuk mund të fillojë punë pa firmën e deputetit, i cili është i pari i listës së qarkut, duke shmangur gjitha forumet e PD. Kjo nuk ka shpjegim tjetër se po t'iu interesojë PD-ja këtyre zotëri



Ish-nënshkryetari i PD-së në Mirditë, Gjon Ndoj

nuk do t'i shmangnin forumet. Kemi pas një rast në kryesinë PD-së Mirditë, ku ishte hera e parë që meqenëse sekretari i qarkut do të dilte në pension do ta zëvendësonin me një që do të merrte votat në kryesi, u futën disa kandidatura në garë po kur u mor vesh nga deputeti Mark Marku dhe ish-kryetari Gjovalin Prenga (dr.) i mar-dhënieve me publikun pranë kryeministrit se kandidatura e tyre nuk i merrte votat në kryesi, erdhën dhe iu lutën kryesisë që të mos bënin votim të fshehtë se përcahej PD-ja, por t'ia linin deputetit Marku dhe kryetarit megjithëse 7 vetë kërkuan votim të fshehtë përsëri këta zotërinj nuk pranuan. Statuti i PD-së e ka që në qoftë se kërkohen 4 vetë votim të fshehtë, kryesia është e detyruar të bëjë votim të fshehtë.

Tashmë që keni dhënë dorëheqje nga posti i nënkryetarit të PD-së në Mirditë, a do të kontribuoni për këtë parti për zgjedhjet e 23 qershorit?

Përsa kohë të jenë në listën e PD-së Mark Marku, Edi Paloka apo ndonjë rikthim tek Gjovalin Prenga unë do të punoj kundër PD-së. Do të punoj për PD nëse këta persona do të votohen në strukturat e PD në Mirditë me kandidaturat alternative, ku të kem të drejtë edhe unë të votohem me ta. Nëse marrin mbështetje më të madhe se unë atëherë unë do të jem ushtar i tyre.

Si e shikoni performancën e mazhorancës në organizimin e strukturave të saj, vetëm pak muaj para zgjedhjeve?

Është me të vërtetë për të

ardhur keq, flas vetëm për Qarkun e Lezhës, ku unë kam informacion, nuk di më larg, por në qoftë se PD në të gjithë Shqipërinë është si në Lezhë, Mirditë dhe Kurbin vaj medet. Shpresoj që nuk është kështu. Ne në Mirditë kemi qenë shumë të organizuar. Ka 22 vjet që kush ka pas dëshirë për të kandiduar, nuk i është hequr emri askujt në Tiranë, por është ballafaqur me votën, ka humbur po ka mbetur në PD. Vetëm në konferencën e fundit janë hequr emrat e disa figurave të PD-së dhe e kemi ditur se kujt do hiqej emri dhe kujt jo që 3 muaj më parë. Kjo merr vesh nga deklaratat e grupit të punës, të cilët e deklarorin në rreth të ngusht se "sa të jem unë, filanin nuk e lejoj të vij" dhe sikur kjo të mos mjaftonte, si rrallë herë janë manipuluar edhe seksionet, të cilat në shumë vende nuk jan thirrur anëtarët e PD, por janë emëruar delegat sipas preferencave. Në një seksion ka pasur delegat burrë grua apo babë e bir apo dy djem xhaxhajsh se bashku me kunatë në një seksion dhe numri i këtyre rasteve i kalon 20 delegatë. Ajo që është më e rëndësishmja në ato seksione, ku janë bërë manipulime të tilla ka qenë deputeti Mark Marku dhe kryetari Gjovalin Prenga të deleguar nga kryesia e PD-së rrethit. Kemi pasur raste që kemi marr vendim kryesisë për t'i hequr mandatin dhe përsëri ditën e konferencës kanë pas emrin në listë dhe kanë votuar. Në kushte normale kur ka mbi njëzet delegatë të një familje dhe konferenca është mbyllur me 10 vota, duhet të anulohet kjo konferencë sigurisht se nuk do të ndodhë një gjë e tillë sepse nuk jemi në kushte normale.

Marrëdhëniet me SHBA, Berisha kontratë tjetër me Patton Boggs

Kompania amerikane e lobimit, Patton Boggs, ka lidhur një kontratë me qeverinë shqiptare për të përmirësuar imazhin e saj si dhe marrëdhëniet e qeverisë me Washingtonin. Lajmin e bën të ditur agjencia e lajmeve "O'Deyers", që merret me kompanitë e lobimit dhe marrëdhëniet me publikun. "Patton Boggs ka rënë dakord për të siguruar hapësirë në media për

Shqipërinë si dhe për të përmirësuar pozicionin e saj me qeverinë amerikane," shkruan kjo agjenci. Nuk dihet se ç'detaje përmban kjo kontratë, e cila do paguhet me para të taksapaguesve shqiptarë. Qeveria nuk ka bërë asnjëherë transparencë për marrëveshjet e saj të lobimit me kompanitë amerikane. Vjet në shtator agjencia "O'Deyers" raportoi se kompania Podesta ka

lidhur një pakt mujor prej 60 mijë dollarësh me qeverinë shqiptare, për të çimentuar marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA-në. Kohët e fundit marrëdhëniet janë krisur mes SHBA e qeverisë, sidomos pas mesazheve të forta të Amerikës për zgjedhje të lira dhe të ndershme në vendin tonë. Po ashtu, amerikanët janë shqetësuar pas retorikës nacionaliste të kryeministrit Sali Berisha.

JEMEN 180 tonë armatim dhe eksploziv të prodhimit serb

Kapen shqiptarët me armë serbe në Jemen

Anija ndaloi në Durrës, dhe më pas në Malin e Zi

SANAA

vijon nga faqja 1

...udhëtonte bashkë me oficerin e parë Mihal Cangonji dhe kryemekanikun Nezir Shahaj. Ndërkohë, në bord ndodheshin edhe tre marinarë të tjerë, dy indianë dhe një grek. Anija EOS ndaloi në datën 16 dhjetor të vitit që kaloi në këtë port për furnizim, karburant dhe ushqime dhe në 19 dhjetor të gjashtë marinarët u arrestuan nga policia portuale në Al Mukalla. Sipas agjencive të lajmeve jemenite, të hënën marinarët kanë dalë para gjykatës në rajonin e Hadramaut në Jemen. Agjencia e lajmeve jemenite ka paraqitur edhe fotot e gjyqit, kapitenin Arif Bakillari kur po bën betimin, duke i dhënë dorën gjykatësit Abdu Ali Aead. Nga grupi i të arrestuarve kapiteni është i vetmi që komunikoi në anglisht. I kontaktuar në telefon, Arif Bakillari ka treguar se anija EOS ishte nisur nga Greqia dhe ai mori drejtimin e saj në Durrës, më pas në Malin e Zi u ngarkua sasia e armatimit e kontraktuar. Agjencitë e lajmeve thonë se armët janë prodhim serb. Anija u nis më 17 korrik të vitit që kaloi dhe në 16 dhjetor ndaloi në portin e Al Mukallës, në Jemen, për furnizim me karburant, ndërsa në bord kishte 180 tonelata armatim dhe eksploziv me destinacion portin e Um Kasrit në Irak. Sipas jemenitëve, anija humbi rrugën dhe u end nëpër det për 5 muaj e më pas mbërriti në Jemen. Aty kapiteni deklaroi të dhëna kontradiktore për ngarkesën dhe destinacionin dhe mohoi faktin se kishte armatim në kundërshtim me ligjet vendase dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas padisë së ngjitur, të akuzuarit kanë shkelur ligjet kombëtare dhe rregullat ndërkombëtare, ku më e rëndësishmja është lundrimi në det me lëndë plasëse dhe municione, pa iu përmbajtur koordinatave të përcaktuara ndërkombëtarisht. Nësor marinarët do të dalin në një tjetër seancë gjyqësore për verifikimin e ngarkesës. Ndërkohë, kapiteni Arif Bakillari, i kontaktuar në telefon, ka treguar versionin e tij të ngjarjes. Sipas tij, ngarkesa është e rregullt dhe në disa



Profirma-INVOICE NO. 1
Tirana, date ____ / ____ / 2006.

To account of "MEICO" Contract No Nr. 134/13 date 18.11.2006.
TERMS OF PAYMENT: Advance payment (TT) American Bank of Albania "Ismael Cemal" street No.27, Tirane.
SWIFT: USALALTR account number NO.200 338 531 01

No	Description	Quantity pcs	Price USD/pcs	Amount USD
1.	7.62x54mm ammunition brass case, Albania	10 000 000	0.03117	311 700
Total value				311 700 USD

Delivery condition : FOB Durrës port.

Faksimile e një kontrate për tregtimin e armëve në Jemen (lart) Marinarët e arrestuar

GENERAL DIRECTOR
YIHI PINARI

pjesë të udhëtimit është shoqëruar nga anijet e NATO-s. Ai mbahet i ndaluar së bashku me 5 marinarët e tjerë. Sipas tij, diplomatët indianë, irakenë dhe grekë janë vënë në lëvizje për fatin e marinarëve, ndërkohë që burime diplomatike në Tiranë thonë se ambasada në Arabinë Saudite po ndjek çështjen edhe nëpërmjet konsullit të nderit në Jemen. Kapiteni ka thënë se gjithçka po ndodh

sepse jemenitët duan të mbajnë ngarkesën e destinuar për në Irak.

AKUZAT

Një dokument i ambasade amerikane në një nga vendet e Ballkanit i cili disponohet nga Wikileaks dhe që u publikua në 2011, hidhte dritë mbi trafikun e armëve në disa shtete përfshi edhe Shqipërinë. Dokumentet e Eikileaks flisnin për shtetasin

Slobodan Tesic, emri i të cilit ndodhet në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara. Ky emër, është i njohur edhe për autoritetet shqiptare, pasi Tesic dhe kompania e tij ishin hologe të kompanisë shtetërore për importin dhe eksportin e armëve MEICO. Ndërmarrje në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë, e cila ka nënshkruar kontrata në emër të qeverisë shqiptare. Sipas dokumenteve, Shqipëria u identifikua si pjesë e rrjetit të kontrabandës së armëve nga Serbia në Jemen dhe në Lindjen e Mesme. Dy nga këto dokumente të tregojë dhe datën nga 14 dhjetor 2009 dhe 15 janar 2010, bazuar në informata të dhëna nga shërbimi sekret bulgar, një ngarkesë kontrabandë me armë me vlerë rreth 95 milionë dollarë erdhi nga Serbia për në Jemen dhe kaloi në një pjesë të itinerarit të saj tranzit nga porti i Durrësit. Marrëveshja u nënshkrua për kalimin e ngarkesës, me Qeverinë e Shqipërisë në tetor 2009, kurse municioni është eksportuar nga Serbia në janar 2010. Për të vepruar si një ndërmjetës, Slobodan Tesic krijoi kompaninë Melvave Corporation LTD, një kompani e regjistruar në disa vende, duke përfshirë edhe Beogradin, Zvicrën dhe Qipron. Në dokumentet amerikane ishte fshirë emri i kompanisë, por investigimi ishte në gjendje të identifikojë kompaninë dhe të sigurojë dokumentacion të gjerë mbi këtë shoqëri. Në këto dokumente është përmendur edhe një partner i Tesic, i quajtur edhe Messuri Sharenach Nenad, i cili gjithashtu ka gëzuar pasaportë si një qytetar britanik, por nuk ka licencë të lëshuar nga Qeveria britanike për tregtinë e armëve.

Ambasada në Arabinë Saudite

Lajmi për marinarët shqiptarë nga ambasada në Athinë

Ambasada në Arabinë Saudite është njoftuar për këtë Arast, nga ambasada shqiptare në Athinë, sepse mes marinarëve ishte edhe një shtetas grek. Ministria e Jashtme e Shqipërisë tha se prej dy javësh ambasadori ende në detyrë në Riad, Admirim Banaj, prej dy javësh ka bërë disa demarsh pranë autoriteteve jemenite. Sipas saj, ambasada ka komunikuar me ambasadorin e Jemenit në Arabi Saudite, por pa arritur ndonjë zgjidhje. Është përdorur edhe roli i konsullit të nderit të Shqipërisë në Jemen, një figurë e respektuar në atë vend, por porti ku janë ndaluar marinarët është në një zonë të trazuar dhe ku qeveria jemenite ka pak influencë. Por megjithë korrespondencën mes diplomatëve tanë dhe Ministrisë së Jashtme, ende nuk është arritur të ketë një njohje nga afër të problemeve me marinarët shqiptarë, të cilët do të dalin nesër para gjyqit.

Ministri përgënjeshtroi

PS: Imami, trafik me tregtarë serbë

PS denoncoi katër muaj më parë trafikun e armëve të Ministrisë së Mbrojtjes me vendet që janë në konflikt, ndërsa në lojë janë përdorur firma serbe. Sipas dokumenteve të opozitës, në Jemen u çuan 21 mijë predha, mortajave dhe 4 milionë fishekë, në periudhën fund 2009, fund 2010 dhe fillimi i vitit 2011, kur edhe nisi konflikti civil në Jemen. Sipa dokumentave rezultun se në dhjetor të 2010 Meico ka kërkuar për herë të dytë shtyrjen e afatit të eksportit për 3 muaj, transaksioni është kryer duke përdorur Malin e Zi si



Ministri Arben Imami

tranzit"-akuzoi PS. Në emër të PS-së, deputeti Erjon Braçe kërkoi që ministri Imami të mbajë përgjegjësinë politike që i takon, ndërkohë kërkoi sqarime se pse në 90% të kontratave shtetas serbë janë pjesë e tyre. "Pse nuk është konsultuar lista e zezë e OKB-së. Pse SHIU nuk e ka hetuar këtë trasankcion kaq problematik. Pse agjencia e eksportit ka humbur licensën për këtë kompani. Njolla që ka marrë Shqipëria është e zezë. Përgjegjësia është e rëndë. Politikisht ministri duhet të dorëhiqet. Administrativisht drejtori i SHIU-t duhet të sh-

karkohet dhe të ndiqet penalisht", deklaroi Braçe tetorin e shkurt. Ministria e Mbrojtjes u përgjigj se: "Aktiviteti i shitjes së armëve është tërësisht i ligjshëm si çdo aktivitet tjetër me natyrë kontraktuale. Destinacioni i mallit në dokumentin e saktë që kemi është Gjeorgjia. Kjo kontratë nuk është realizuar pasi Ministria e Mbrojtjes u tregua strikte në kontrollin e dokumentit. "I kemi shitur armë edhe Jemenit, i raportuam në OKB. Në kohën e lidhjes së kontratës nuk ka pasur luftë civile në Jemen në vitin 2010".



Halimi: Reformë në drejtësinë civile, gati shërbimi online

Ministri i Drejtësisë Eduart Halimi, ka prezantuar disa nga reformat që dikasteri i tij do të ndërmarë në drejtësinë civile. Sipas Halimit, ndryshime ligjore, do të kryhen në "Kodin e Procedurës Civile" dhe "Kodin Civil", si pjesë e rëndësishme e reformës në drejtësi. "Sot prezantojmë paketën e ligjeve, që shkon në favor të interesit të qytetarëve dhe sistemit bankar, sistem që është jetik në kohët që jetojmë,

në kushtet kur kërkohen imunitete ndaj krizës ekonomike dhe një rritje e qëndrueshme ekonomike dhe nuk ka kohë për të humbur, për shkak të procedurave të tejzgjatura që zhvillohen në sistemin gjyqësor", u shpreh Halimi. Ndryshimet parashikojnë që procesi i trajtimit të trashëgimisë të mos kryhet më nga gjykatat, por të kalojë të noterët. Gjithashtu, reforma parashikon lehtësimin

e procedurave për urdhrat e ekzekutimit, krijimin e një portali unik për aksesin online në hipotekë dhe regjistrin e përmbartësve. Ministri i Drejtësisë, u shpreh se këto reforma janë shumë të rëndësishme dhe ka kërkuar nga opozita ti mbështesë ato. "I ftoj deputetët të ngrihen në përgjegjësinë e tyre politike, për t'i votuar këto ndryshime në respekt të qytetarëve që i kanë votuar", u shpreh Halimi.

Procesit ndaj vrasësit, ja dëshmia në gjykatë

"Me armë të koka i dhashë lekët e arkës"

Arkëtarja: Si më grabiti Viktor Gushi

Lajmi

Një punonjëse bankare, e cila është bërë prehe e grabitjes nga Viktor Gushi, ka rrëfyer dje në gjykatë momentet e ankthit dhe frikës. Anita Metani, 28-vjeçe, ka treguar se si Gushi arriti të merrte qetësisht afro 1 milionë lekë. Dëshmia është dhënë dje në sallën e gjyqit, në prani dhe të akuzuarit.

TIRANE

KLAJDI BODLLI

Seanca e dytë e zhvilluar ndaj grabitësit të bankave Viktor Gushi, ka vijuar me dëshmitaren e radhës, një punonjëse e një prej bankave të grabitura në Tiranë. Ajo ka treguar për trupin gjykues, sesi kanë rrjedhur ngjarjet. Skenari është pothuajse i njëjtë, hyn në bankë drejton pistoletën dhe merr paratë. Më pas largohet qetësisht. Kush bën rezistencë vritet, kush dorëzon paratë ja del paq. Anita Metani, 28-vjeçarja nga Tirana, ka qenë dëshmitarja e radhës në gjyqin ndaj Viktor Gushit. Ajo ka rrëfyer për një grabitje të ndodhur në prill të 2009, në fillimin e një banke në Rrugën "Ferit Xhajko". Sipas Metanit, Gushi ka hyrë në bankë qetësisht. "Kishte veshur një shall, për të mbuluar pjesën e poshtme të fytyrës", është shprehur arkëtarja. "Në dorë mbante një pistoletë të vogël ngjyrë gri, si dhe në kokë kishte veshur një çorape. Në 1 minutë që qëndroi në bankë më tha vetëm dy fjalë, 'Mbushe ose ndryshe të vrava'", tregon arkëtarja, duke shtuar se, ndërjerë nën kërcënim dhe e frikësuar, i ka dhënë rreth 1 milionë lekë Gushit. Ky i fundit akuzohet për 16 grabitje, si dhe vrasjen e një arkëtareje dhe një argjendari.

Ndërkaq, gazeta Shqiptarja.com, zbardh dëshminë e arkëtares në sallën e gjyqit.

Prokurori: Çfarë mbani mend nga grabitja e prillit të 2009 në bankë?

Unë isha në arkë, teksa po i shërbeja një klienti. Në moment, më vjen një përon me një shall në fytyrë dhe me pistoletë në dorë. Më hedh një qese plastike dhe më thotë, "mbushe".



Gushi

16 grabitje mendohet të ketë kryer Viktor Gushi, të cilat i ka pranuar dhe vetë para uniformave blu. Mes tyre, ai edhe ka vlarë një argjendare dhe një arkëtare banke.

Gjykatësi: Ju si reaguat?

Unë hapa arkën, në të cilën kisha paratë në prerje të hollë dhe fillova t'i fusja në qese. Por ai më tha: "mbushe plot se të vrava". Në këtë moment, hapa

sirtarin në të cilin kisha prerja të mëdha dhe i futa në qesen plastike. Ndërkohë kisha shtypur alarmin.

Gjykatësi: Si ishte veshuri autori?

Veshjen nuk e mbaj mend, po më kujtohet që shalli që kishte vënë në fytyrë, ishte përafërsisht me ngjyrat e flamurit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pistoleta ishte e vogël dhe kishte ngjyrë gri. Ndërkohë në dorën që mbante pistoletën, kishte veshur një çorape, material lino.

Gjykatësi: Sa lekë arriti të merrte grabitësi?

Paratë që i dhashë, ishin të bëra gati për një klient, i cili do t'i tërhiqte nga klienti e tij. Besoj se shkonin te nëntëqind e tetëdhjetë mijë lekë të reja.

Prokurori: Sa kohë ndenji në bankë?

Besoj te 30 sekonda, maksimumi një minutë. Menjëherë sa mori paratë u largua.

Gjykatësi: E patë nga u largua?

Jo, nuk e vura re sepse isha e terrorizuar. As kur hyri dhe as kur doli.

Durrës Vendimi

Vrasja e 4 policëve, 9 vjet burg kumatit të Dritan Dajtit

DURRES

Ndërkohë që gjyqi i Dritan Dajtit vazhdon të shtyhet pa fund, për shkak se nuk ka avokat, bashkëpunëtori i tij Ergest Xhoxhi, është dënuar me 8 vite e 6 muaj burg. Vendimi është marrë, nga Gjykata e Shkallës së parë në Durrës. Xhoxhi ka qenë i akuzuar si bashkëpunëtor me Dritan Dajtin, në vrasjen e 4 efektiveve të Policisë, më 7 gusht të 2009 në Durrës. Ai akuzohet për veprën penale të "përkrahjes së autorit të krimi" dhe "falsifikimit të dokumentave" në bashkëpunim. Për këto dy vepra penale, ai u dënua me 8 vite e 6 muaj burg. Kryetari i Trupi Gjykues Ervin Metalla, u shpreh se për veprat penale të sipërpërmendura, është dhënë dënimi maksimal për Xhoxhin.



Ergest Xhoxhi, ishte së bashku me kumatin e tij, Dritan Dajtin i akuzuar për vrasjen e 4 policëve në Durrës. Gjykimi ndaj tij, fillimisht filloi në Gjykatën e Krimeve të Rënda në Tiranë. Më pas,

Xhoxhi bëri kërkesë që dosja e tij ndahet nga ajo e Dritan Dajtit, duke preferuar të gjykohej në Gjykatën e Durrësit. Gjykata e Krimeve të Rënda, pranoi kërkesën e tij dhe çështja u transferua në Durrës. Pas pothuajse 4 vitësh, dënohet një ndër personat e akuzuar për vrasjen e 4 policëve, në zonën "Iliria" në Durrës. Ndërkohë në Tiranë, vazhdon procesi gjyqësor ndaj Dritan Dajtit, kumatit të Ergest Xhoxhit si dhe ndaj Mariglen Muçajt, ish punonjësi policie, i akuzuar për "shpërdorim detyre".

Procesi ndaj Dritan Dajtit, është lthyer në një teatër më vete, pasi prej shumë seancash ai vetëm shtyhet. Shkak është bërë, mungesa e një avokati për Dritan Dajtin. Të gjithë avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata, japin dorëheqjen ose nuk pranojnë të mbrojnë Dajtin, në këtë proces gjyqësor.

LAJME SHKURT

■ Priste autobuzin, i vjedhin çantën

Një grua është bërë pre e grabitësve mbremjen e hënës në Tiranë, Ngjarja ka ndodhur, në afërsi të Bankës së Shqipërisë. Gruaja ka qenë duke pritur autobuzin, kur dy të rinj me motor i janë afruar dhe i kanë tërhequr çantën që mbante në dorë, brenda së cilës ndodhej një laptop. Forcat e komisaritit numër 3 mbëritën në vendin e ngjarjes dhe shoqëruan disa persona, që dyshohet se kanë djegni për autorët.

■ Vidhte tubat e kondicionimit, arrestohet

Komisariati Nr.4, ka bërë të mundur arrestimin në flagrancë të Artur Oshafit, 28-vjeç, lindur e banues në Tiranë. Arrestimi i tij, është kryer pasi është kapur në flagrancë, teksa po vidhte tubat e kondicionimit, në një objekt në ndërtim në Rrugën e Dibrës. Policia ka arritur të sekuestrojë, në cilësinë e provës materiale, 26 metra linear tub bakeri, i vjedhur nga objekti në fjalë.

■ Në pranga, qëlluan me automatik

Policia e Tiranës ka bërë të mundur arrestimin e 3 personave. Ato janë Nik Vatnika, Uljan Muça dhe Sokol Mema. Arrestimi i tyre është bërë pasi dyshohet se mesditën e së dielës, kanë qëlluar me armë në shtëpinë e shtetasit Emri Mani.

■ Kapën me Kanabis dy 17-vjeçarët

Seksioni Kundër Narkotikëve ka arrestuar në flagrancë, D.Lazaj dhe G.Jaupaj, të dy 17-vjeç, lindur në Fier dhe banues në Tiranë. Arrestimi i tyre është bërë rreth orës 12.30 minuta të së shtunës. Dy 17-vjeçarët, kanë qenë duke ecur në këmbë pranë godinës nr.9 në Qytetin Studenti. Gjatë kontrollit, atyre ju është gjetur rreth 8.2 gramë Kanabis Sativa e futur në dy qese farmacie.

■ Ndalohen, vidhni kapakët e pusetave

Komisariati i policisë së Kavajës, ka arrestuar në flagrancë shtetasit Artur Xhamani, 47-vjeç dhe Indrit Kasa, 37-vjeç. Arrestimi i tyre është bërë pasi dyshohet, se këto persona kanë vjedhur 5 kapakë pusetah në lagjen Nr.3 Kavajë. Në cilësinë e provës materiale, janë sekuestruar 5 kapakët, ndërkohë që dy personat akuzohen për vjedhje.



Itali, ndërron

Artan Meta, baristi

shqiptar i dhunuar



Artan Meta

Ka ndërruar jetë në një spital të Italisë, Artan Meta 45-vjeçari shqiptar, i cili 4 ditë më parë u dhunua nga një student italian, në ambientet e një lokali ku ai punonte si barist. Pas 4 ditëve në koma, 45-vjeçari nuk ka mundur t'ia dalë dhe ka humbur jetën në spital. Ai ndërroi jetë

rreth orës 16.00 të së hënës në Spitalin "Brotzu". Mjekët e kishin operuar për të ulur hematomën në kafkën e tij, por gjendja e tij shëndetësore, sipas bluzave të bardha ishte dëshpëruese. Artan Meta, barist në "Mondial" bar, kishte respektin e të gjithë banorëve të

Villasorit. Të enjten ai i ishte afruar 18-vjeçarit, duke e qortuar pasi ky i fundit kishte goditur makinëtën shitëse të cigareve, pasi nuk i kishte kthyer kusurin. Por i riu Italian, reagoi egërsisht ndaj 45-vjeçarit shqiptar, duke e qëlluar me shkelma e grushte.

"Paradë suksesesh", shifrat thonë të kundërtën

Tiranë 2012, rritet kriminaliteti

Policia dështon me parandalimin e krimit

Lajmi

Drejtoria e Policisë së Tiranës ka zhvilluar analizën vjetore për 2012-ën. Në komunikatën për mediat, Policia e Tiranës shprehet se objektivat e saj për vitin 2012 janë përbushur me sukses, madje duke pasur një rritje cilësore progresive të punës së saj. Një gjë e tillë nuk i përgjigjet realitetit, që karakterizohet nga një rritje e frikshme e krimit.

KRIME	AUTORE	VRASJE
7639	7770	323
NË 2012 Vepra penale të të gjitha llojeve, janë evidentuar nga policia e Tiranës.	NË 2012 Persona janë evidentuar si autorë të morisë së veprave penale të regjistruara.	NË 2012 Vepra të rënda penale janë regjistruar në Tiranë, si vrasje, trafik droge etj.
6236	5686	290
NË 2011 Vepra të të gjitha natyrave janë raportuar në policinë e kryeqytetit.	NË 2011 Eshtë numri i personave që kanë kryer vepra të ndryshme penale në Tiranë.	NË 2011 Krime të rënda u shënuar në kryeqytet, nga grabitjet me armë, trafiku e vrasjet.



Analiza e policisë së Tiranës

Propozimi

Meta: Reforma për të ndaluar dhunën ndaj grave

TIRANE



Ilir Meta, kreu i LSI

Gratë e Lëvizjes Socialiste zhvilluan dje një tryezë me temë "Për një shoqëri aktive, jo indiferente". Ndër të tjerë, kryetari i LSI-së, deklaroi se është e domosdoshme një politikë konkrete, reforma konkrete në legjislacion që forcojnë pozitën e gruas në familje dhe shoqëri, ligje më të qarta dhe më ndëshkuese për ata të cilët nuk e përbajnë dot veten e tyre dhe në jehonësisht politika stimuluese, të cilat i ndihmojnë dhe i lehtësojnë gratë të ecin në rrugën e punësimit dhe në rrugën e pavarësisë së plotë të tyre sa më të plotë ekonomike. Sipas Lideri të LSI-së shoqëria jonë i ka mundësitë për të shënuar një hap të rëndësishëm përpara në këtë drejtim. "Duhet më shumë bashkëpunim dhe bashkërendim midis forumeve që merren me

çështjet e gruas, jo vetëm ato politike, por edhe të shoqërisë civile, dhe sa më i fortë të jetë ky bashkëpunim aq edhe më rezultativ do të jetë progresi që të gjithë dëshirojnë në këtë drejtim. Natyrisht që kjo nuk mund të realizohet pa ndërgjegjësimin e gjysmës tjetër të shoqërisë, ajo që është edhe përgjegjësjë kryesore për shkakun e kësaj dhune, pra të burrave, por nuk duhet të mendojmë se nuk ekziston ky sensibilizim, përkundrazi", tha Meta.

Tryeza

Rama: Shifrat alarmuese, duhet ndryshim rrënjësor i policisë

TIRANE



Edi Rama, kreu i PS

Partia Socialiste zhvilloi dje tryezën për luftën kundër dhunës ndaj gruas. Në fjalën e tij, kryetari i PS-së Edi Rama i ka cilësuar si tragjike shifrat e vrasjeve të grave në Shqipëri. "Përballë shifrave të 2012 është e qartë se nuk ka vend për të diskutuar domosdoshmërinë e një ndryshimi rrënjësor, rrënimin i përgjithshëm materializohet edhe në shifrat e kriminalitetit ku edhe shifra tragjike e vrasjeve të grave mund të jetë një rekord negativ. Kur kjo parti që sot qeveris erdhi në qeveri atë vit evidentoheshin 8250 krime ndërsa në vitin 2012 u evidentuan 20688 krime. 12438 krime me shumë, 1500 krime në vit më shumë, për të ardhur në një shifer e cila është e papranueshme në raport me të shkuarën dhe në raport me kontekstin e Europës ku ne duam të integrohemi" tha Rama. Kryesocialisti Rama e lidhi rritjen e kriminalitetit në vend me

rrënimin moral e profesional të policisë dhe me rrënimin ekonomik dhe social të vendit. "Sot Shqipëria është vendi me numrin më të madh të vrasjeve si dhe është vendi me numrin më të madh të vdekjeve në rrugë. Kemi sot një vend që ka trajtimin më të ulët financiar në rajon të policisë dhe policia jonë është më e keqpajtura se çdo polici tjetër e rajonit, paguhet më mirë në Kosovë dhe Bosnjë", shtoi Rama.

ulëta. Në analizën e zhvilluar ditën e djeshme, shumica e mediave të shkruara nuk janë njoftuar nga Policia e Tiranës, duke u mjaftuar vetëm me nisjen atyre të të dhënave zyrtare. Të dhëna të cilat trigojnë

qartë, se puna e uniformave blu të kryeqytetit për parandalimin e krimit, le shumë për të dëshiruar. Në shifrat e Drejtorisë së Policisë thuhet se Sektori Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve ka evidentuar rreth

527 vepra penale, ku janë implikuar 631 autorë. Janë ndaluar 216 dhe 408 janë proceduar në gjendje të lirë. Gjithsej janë sekuestruar 936 kilogramë kanabis; 29 kilogramë heroinë; 2 kilogramë kokainë dhe 150

kilogramë përzierës kokaine dhe heroine. Në kuadër të veprave penale në fushën e krimit financiar, janë regjistruar 860 vepra penale e zbuluar 850. Gjithashtu, Strukturat Kundër Krimit Ekonomik kanë sekuestruar

rreth 10 milionë euro asete të krimit. Sipas Policisë së Tiranës, Seksioni për Hetimin e Aseteve Kriminale, në kuadër të ligjit Antimafia, ka hetuar mbi pasuritë e krimit, duke prekur dhe familjarët apo të afërmit e tyre.

Shqiptarja.com ka krahasuar shifrat e vitit 2012 me ato të vitit 2011, ku, edhe me një shikim të thjeshtë, vihet re qartë një rritje e kriminalitetit në të gjithë Qarkun e Tiranës. Kështu, në vitin 2012 në këtë qark janë evidentuar rreth 7939 vepra penale dhe, sipas të dhënave, janë zbuluar 6236. Në gjithë këto vepra penale, janë përfshirë 7770 autorë, arrestuar 1243 në flagrancë dhe 5856 janë proceduar në gjendje të lirë. Ndërkohë, në vitin 2011 numri i veprave penale ishte më i ulët. Gjatë atij viti janë evidentuar 6236 vepra penale, pra rreth 1200 më pak se viti 2012. Gjithashtu në to janë përfshirë 5686 autorë ose 1902 më pak se në vitin 2012. Ndërkajq Sektori Kundër Krimeve të Rënda, gjithmonë sipas Drejtorisë së Policisë së Tiranës, ka arritur të evidentojë rreth 325 vepra penale dhe ka zbuluar 215 prej tyre. Por sërish në vitin 2011, kemi në numër më të ulët të këtyre veprave, të cilat janë 290 ose 35 më pak. Nga shifrat, duket qartë që kriminaliteti në vitin 2012 në Qarkun e Tiranës është rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2011. Duhet theksuar se viti 2011, ishte dhe një vit elektoral, pasi u zhvilluan zgjedhjet lokale dhe megjithatë, shifrat janë më të

BULQIZE Minierat

Haxhinasto: Dorë e hekurt për firma pa licensë

■ ■ ■ **BULQIZE**

Dorë e hekurt për të gjitha subjektet e palicensuara, që operojnë në sektorin minierar. Kjo deklarata u bë dje nga zv.kryeministri dhe ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Edmond Haxhinasto, gjatë një diskutimi me task forcën e Bulqizës. "Ka subjekte që



Ministri Edmond Haxhinasto

operojnë pa dokumente, pa licensa; ato angazhohen në procepe pune në zona të mbyllura, por nganjëherë edhe në zona ku operojnë subjekte të licensuara. Policia është shumë e vendosur të zbatojë ligjin; kemi lënë detyra përkatëse edhe për të, por do të bëjmë edhe disa ndryshime të tjera të akteve nënligjore, që të përsosim procedurat mbi subjekte që

operojnë në mënyrë të paligjshme", tha zv.kryeministri, njëkohësisht kreu i METE-s. "Ky sektor menaxhon asete të rëndësishme për vendin. Ndryshimet do të kenë të bëjnë me standardet në punë, ruajtjen e jetës së punëtorëve, ndërkohë që do të ecim edhe drejt rritjes së efikasitetit të këtij sektori duke bërë investimet që duhen", deklaroi Haxhinasto.

Kryeministri shpall ndryshim në taksën e sheshtë

Lajmi

Kryeministri shqiptar ka shpërfilur sërish këshillën e përsëritur të ndërkombëtarëve për të mos rritur pagat e punonjësve. Ndërkohë, ai ka shpallur një ndryshim në taksën e sheshtë, me tatim zero për pagat deri në 30 mijë lekë

Berisha kundër FMN: Do t'i rritim pagat!

"Rroga deri 30 mijë lekë, tatim zero"

■ ■ ■ **TIRANE**

GENC KONDI

Berisha deklaroi dje në mbledhjen e grupit parlamentar demokrat se nuk ka ndërmend që, në këtë vit elektoral, të dëgjojë këshillat e institucioneve më të mëdha financiare ndërkombëtare, për të mos rritur nivelin e shpenzimeve operative, ku përfshihen pagat. "Pavarësisht respektit që kam për Fondin Monetar Ndërkombëtar, më duhet të them se në të gjitha rastet ka këshilluar të mos rriten rogat. Dhe Rama ka votuar për të mos rritur rogat. Po të dëgjoja variantin e mosrritjes së rrogave, rroga mesatare do të ishte 260 mijë lekë, por, me kurajë dhe vendosmëri, në kemi rritur rogat dhe pensionet dhe kjo do të mbetet politikë konstante edhe në kuadrin e rritjes së mëtejshme të rrogave dhe mbështetjes së fuqishme të biznesit", deklaroi Berisha.

Përfshirja e kreut të PS në këtë kritikë duket se ka për qëllim armiqësimin e shtresave më të varfëra me Ramën, që ka shpallur si politikë fiskale taksimit progresiv, që parashikon rritjen e nivelit të taksimit për paga më të larta.

Nga ana tjetër, Berisha shpalli, në distancë pesë muaj nga zgjedhjet, se PD, duke i qëndruar besnike taksës së sheshtë, po bën disa modifikime, do të heqë krejtësisht tatim-fitimin për ata që marrin një pagë mujore nën 30 mijë lekë të reja. Berisha tha se ky vendim nuk është vetëm një 10 për qind rritje rroge, por, njëkohësisht, edhe një mbështetje e madhe për sipërmarrjen dhe tregun e punës. "Ky vendim synon shpërndarjen më të mirë të të ardhurave dhe është një për-



Kryeministri Sali Berisha

pjekje më e madhe që ato të ardhura të shndërrohen në mirëenie për qytetarët", u shpreh kryeministri.

Në fakt, një ide të ngjashme e kishin shprehur edhe socialistët, kur prezantuan paketën fiskale draft. Mimi Kodheli deklaroi se pagat deri në 20 mijë lekë nuk do të ttoheshin, ndërkohë që ato në intervalin 20-40 mijë lekë të reja do të

tatoheshin me vetëm 7 për qind nga një qeverisje e majtë e ardhshme. Berisha premtori tatim zero deri në 30 mijë lekë, por më tej të gjitha të ardhurat tatonen me 10 për qind.

Në administratën shtetërore, numri i punonjësve që marrin nën 30 mijë lekë është i kufizuar, por fasoni merr një frymëmarrje të fuqishme, tha Berisha.

Ndërkombëtarët

FMN: Jo rritje shpenzimesh

Mendimi ynë është që qeveria nuk duhet të bëjë ulje taksash apo rritje të shpenzimeve, por të kundërtën. Kjo duhet të bëhet në një mënyrë që të mos ndikojë negativisht rritjen dhe kjo është arsyeja e rëndësishme së mosprekjes së shpenzimeve kapitale, pasi, kur shkruhen këto shpenzime, kjo sjell një ndikim negativ në rritjen ekonomike". Ka deklaruar kështu për Zërin e Amerikës kreu i Misionit të Fondit Monetar për Shqipërinë Nadeem Ilahi. Ai shtoi se, në këtë fazë, me këtë borxh të lartë, qeveria nuk mund të stimulojë më eko-



Nadeem Ilahi

nominë. Stimulimi përmes borxhit është shumë i vështirë për shkak se huadhënësit shqetësohen për mundësinë për t'i paguar. "Ka disa sfida në shpenzimet, që mund të shkruhen, por që nuk janë ndërmarrë", tha ai, duke argumentuar se viti 2013 do të jetë një vit i vështirë për ekonominë shqiptare.

Opozita

Malaj: Qeveria duhet t'i paguajë detyrimet privatit

Qeveria duhet të hartojë një strategji afatmesme për ndërhyrjen në sistemin fiskal, me qëllim rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Kështu është shprehur ish-ministri i Financave, deputet i PS-së Arben Malaj, për median, duke komentuar dhe re-



komandimin e shefit të misionit të FMN-së për Shqipërinë. Sipas Malajt, vetëm nëpërmjet një strategjie të tillë, të mirëstudiuar, mund të realizohet rritje e të ardhurave në buxhet, por edhe duke mos ndikuar në uljen e performancës së rritjes ekonomike.

Malaj rekomandon se një ndërhyrje e shpejtë për të përmirësuar direkt klimën e biznesit do të ishte pagesa e borxheve që qeveria i ka këtij komuniteti. Sipas deklartimeve të subjekteve private, ky detyrim tashmë ka arritur në 200 milionë euro dhe sa vjen e rritet.

Mazhoranca

Shehu: Rritja e taksave në kohë krize, e rrezikshme

Politika e rritjes së taksave në një kohë krize nuk është e rekomandueshme, madje është e rrezikshme për ekonominë. Deputeti i PD-së, Sheriefedin Shehu, u shpreh se rekomandimi i FMN-së për rritje të taksave nuk bëhet në kohën e duhur. Prioritet absolut për

momentin, sipas tij, mbetet rritja e efikasitetit të administrimit të sistemit tatimor me nivelet aktuale të taksimit. "Rritja e taksave është një politikë që mund të konsiderohet në periudha normale të zhvillimit të ekonomisë dhe kur të gjithë faktorët e tjerë të politikave



fiskale janë ezauruar. Shqipëria ka nevojë për investime të huaja, ndaj ajo duhet të jetë konkurruese sa i përket ngarkesës fiskale", deklaroi ai. Sipas Shehut, kur efektet e krizës të jenë tejkaluar, mund të konsiderohet një rregullim i niveleve të taksimit.

Kursi i këmbimit valutor

Për datën 28.01.2013

EURO	139.52	Ndryshimi ditor +0.11
DOLLAR	103.81	Ndryshimi ditor -0.04
PAUNJ	163.24	Ndryshimi ditor -0.44
FRANCA	112.04	Ndryshimi ditor -0.33

Burimi: Banka e Shqipërisë

Çmimet mesatare në tregjet e Tiranës

28.01.2013 (lekë/kg)

FRUTA	
Mollë	79
Portokall	88
Mandarina	125
Limon	132
Ullinj	172
PERIME	
Domate	133
Kastravec	247
Spec	234
Spinaq	176
Lakër	48
Lulelakër	197
Karrota	65
Patëllxhan	337
Kungull	310
Fasule	294
Qepë	71
Patate	82

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe USAID



Shalsi: Shitja e 4 HEC-eve, kundër interesit të vendit

Partia Socialiste ka vijuar edhe dje të këmbëngulë në tezën se privatizimi i katër HEC-eve, që ndodhet në fazën fundore të procesit tashmë, është një gabim i madh dhe një veprim që shkon kundër intereseve të shqiptarëve, për të cilin, madje, opozita ka depozituar edhe një kallzim penal pranë Prokurorisë së Tiranës. Deputeti Eduard Shalsi edhe një herë nëpërmjet shifrave

shpjegoi qëndrimin e PS se përse nuk duhet të shiten dhe as të privatizohen këto HEC-e me kapacitet mesatar. "Të 4 HEC-et kanë një fuqi të instaluar prej 78 megavatësh dhe prodhojnë mesatarisht rreth 400 milionë kilovatorë në vit, shifër që, duke u shumëzuar me 2.2 lekë, që përfaqëson çmimin e vendosur nga ERE si tarifë shitjeje e energjisë së prodhuar nga këto

hidrocentrale, bëjnë 880 milionë lekë. Pra, për të plotësuar sot nevojat e konsumatorëve shqiptarë, për rreth 400 milionë kilovatorë, qeveria shqiptare shpenzon 880 milionë lekë ose rreth 6.4 milionë euro", tha deputeti socialist. HEC-et Ulëz, Shkopet dhe Bistrica 1 e Bistrica 2 janë në fazën e negocimit të kontratës midis METE-s dhe kompanisë turke Kurum.

EKSKLUZIVE/ Flet për Shqiptarja.com zëdhënësja Pulpanova

CEZ: Nuk kemi besim te drejtësia shqiptare

"S'paguajmë ne, për ata që s'duan të paguajnë!"

Lajmi

Zëdhënësja e CEZ Group në Çeki ka deklaruar dje për Shqiptarja.com se e konsideron mjedisin e biznesit në Shqipëri si të paqëndrueshëm dhe të paparashikueshëm. Ndërkohë, ajo tha se kompania nuk i ze besë Gjyqësorit shqiptar dhe për këtë i është drejtuar një arbitrazhi ndërkombëtar

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Për herë të parë, pas heqjes së licensave të shpërndarjes dhe tregimit të energjisë elektrike në Shqipëri, flet për një media shqiptare nga Praga zëdhënësja e kompanisë-mëmë CEZ Group, Barbora Pulpanova. E pyetur nga Shqiptarja.com, ajo ka shprehur mendimet e këtij subjekti lidhur me situatën e krijuar, fajin për të dhe mënyrat e zgjidhjes.

CEZ humbi licensat për shitjen dhe shpërndarjen e energjisë në Shqipëri. E prisnit ju këtë, në momentin kur kompania juaj hyri në tregun tonë?

Ne hymë në tregun shqiptar me qëllimin e qartë për të drejtuar një biznes që do të kishte përfitime, si për CEZ Group, ashtu dhe për shqiptarët.

Ku u gabua, në fillim dhe më pas?

Situata në Shqipëri u bë më e komplikuar në fillim të vitit të shkuar, kur, për shkak të thatësirës drastike të vitit të mëparshëm, kompanisë shtetërore KESH iu desh të importonte energji nga jashtë me çmime shumë më të larta, gjë që e soll në prag të falimentimit; kompania nuk do të kishte mbijetuar pa ndihmën e qeverisë shqiptare. Qeveria vendase u mundua ta zgjidhte situatën me një vendim pa precedent në Evropë: të gjitha kostot ju ngarkuan investitorit të huaj, CEZ Shpërndarjes.

Cila mendoni se ishte pengesa kryesore për



Zëdhënësja e CEZ Group, Barbora Pulpanova

zgjidhjen në mënyrë paqësore të problemeve midis shtetit dhe CEZ-it në Shqipëri?

Për fat të keq, negociatat që pasuan midis CEZ dhe palës shqiptare nuk ishin të suksesshme dhe për CEZ Shpërndarje nuk ishte e pranueshme që vazhdimisht të paguante për ata qytetarë sh-

qiptare dhe institucione shtetërore që janë mësuar të mos paguajnë për energjinë që konsumojnë.

A keni hasur probleme të ngjashme në vende të tjera?

Shqipëria është i vetmi vend ku nuk është arritur rikthimi i planifikuar i investi-

meve. Sa për shpërndarjen, CEZ-i kryesisht fokusohet në përmirësimin e prodhimit të vet, që do të thotë optimizim i llogarive dhe ulje e humbjeve në rrjet - në Bullgari dhe Rumani, këto përpjekje kanë sjellë rezultate pozitive.

Si do t'iu pëlqente që ta zgjidhni këtë konflikt?

Ne gjithmonë kemi parapëlqyer ta zgjidhim këtë

Për investitorët e huaj, ky është një sinjal i qartë që mjedisi i biznesit në Shqipëri është i paqëndrueshëm dhe i paparashikueshëm

situatë nëpërmjet pajtimit.

Është situata aktuale një sinjal negativ për të tjerët investitorët të huaj seriozë?

Për investitorët e huaj, ky është një sinjal i qartë që mjedisi i biznesit në Shqipëri është i paqëndrueshëm dhe i paparashikueshëm.

Çfarë hapash pritet të ndërmarre kompania juaj në të ardhmen?

Pas heqjes së licensës, CEZ-i do të bëjë kërkesë për kompensim dëmsh. Në të njëjtën kohë, CEZ-i do të ndërmarre hapat e parë për fillimin e arbitrazhit ndërkombëtar.

A është në gjendje administratori shtetëror Sahit Dollapi të bllokojë shitjen apo transferimin e aseteve të kompanisë në Shqipëri?

Kjo është një pyetje për z. Dollapi.

A keni besim në vendimet e gjyqësorit në Shqipëri?

Nëse ne do të besonim në drejtësinë shqiptare, nuk do të kërkonim të shkonim në arbitrazhin ndërkombëtar. Ne e konsiderojmë mjedisin në Shqipëri si shumë të paqëndrueshëm dhe të paparashikueshëm.

A mendoni se kompania juaj - në njëfarë mënyre - është përdorur për qëllime elektorale, në të kaluarën - procesi i privatizimit - dhe tani - heqja e licensës?

Kjo është një pyetje për palën shqiptare.

Është e vërtetë se disa prej zyrtarëve të lartë të politikës shqiptare janë faturuar "zero" kilovatorë për konsumin në banesat e tyre?

Ne kemi një qasje të drejtë dhe të barabartë për çdo konsumator.

LAJME SHKURT

■ Takimi i Komitetit Drejtues të Projektit Energjetik

Zhvillohet në Tiranë takimi i Komitetit Drejtues të Projektit të Energjisë Powered. Projekti përfshin rajonet e Adriatikut në Itali, si Abruzzo, Puglia, Veneto, Marche, si dhe Shqipërinë e Malin e Zi. Ky është një projekt për studimin e fizibilitetit për ndërtimin e centraleve që funksionojnë duke shfrytëzuar erën dhe është i financuar nga Bashkimi Evropian me fondet e Projektit Ndërkufitar IPA-Adriatik 2007-2013. Projekti kap vlerën mbi katër milionë euro.

■ Halimi: Ekzekutimi i shpejtë i kolateralit nga gjykatat

Problemet me të cilat janë ndeshur bankat për vite me radhë, për shkak të procedurave të tejgjatura të ekzekutimit të litujve në sistemin gjyqësor apo sa i takon pezullimit të kredive, mendohet të marrin zgjidhje pozitive me reformimin e këtij procesi. Reforma në drejtësinë civile parashikon përmirësimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit dhe lehtësimin e procedurave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, tha dje kreu i Drejtësisë Eduard Halimi.

■ Kriza globale dominon takimin e përvitshëm në Davos

Gjendja e dobët e ekonomisë globale, vazhdimi i konfliktit në Siri dhe mungesa e stabilitetit pas Pranverës Arabe dominuan në bisedimet e mbledhjes vjetore të elitës botërore në Davos. Një numër i madh pjesëmarrësish pranuan pasigurinë në atë se çka sjell e ardhmja. "Eurozona veçanërisht është e ndjeshme për shkak se i është nënshtruar të gjitha krizave politike dhe procesit të ngadalshëm të konsolidimit", theksoi shefja e FMN Lagard.

Shlyerja

ERE: Vendos qeveria për detyrimet reciproke

■ ■ ■ TIRANE

Pas kalimit sërish në duart e shtetit, kompania CEZ Shpërndarje pritet të shlyejë të gjitha borxhet që iu ka operatorëve të tjerë, por edhe debitorë ndaj saj duhet t'i shlyejnë kompanisë detyrimet e prapambetura. Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë thanë dje se administratori i ri do të dorë-



zojë pranë ERE-s, së bashku me strukturën e re sesi do të menaxhohet kompania, edhe protokollin për likuidimet. "Në këtë protokoll likuidimi do përfshihen si detyrimet që kompania CEZ ka ndaj kompanive publike dhe ato që ka ndaj kompanive private të furnizimit me energji elektrike." - deklaroi Entela Çipa, përfaqësuese e ERE-s. Përsa i përket

borxheve që institucionet shtetërore i kanë kompanisë së shpërndarjes, vendimi do të merret nga qeveria, pas përcaktimit të mënyrës sesi do të bëhet shpronësimi i aksioneve të CEZ-it. "Pas vendimit që do dali nga Këshilli i Ministrave do merret dhe një vendim lidhur me asetet dhe me vlerën reale që ato kanë, duke përfshirë dhe borxhet." - u shpreh ajo.

Arvanitasit e Greqisë

TIRANE
ARBEN LLALLA*



Adriatik Llalla



Gjergj Karaiskaqi

HIPOTEZA e kushëririt të prokurorit të përgjithshëm për prejardhjen e familjes. Rrënjët shqiptare të përfaqësuesve të "Agimit të Artë"

Deputeti i Agimit të Artë Kristo Papa vazhdon të bëjë deklaratat ekstremiste duke provokuar kombin dhe shtetin shqiptar. Por nga buron urrejtja e Kristo Papa i cili është shqiptar ortodoks, që e di shumë mirë gjuhën shqipe, gjuhën e heronjve të revolucionit të 1821, gjuhën që e flasin dhe e flasin shumë personalitete të Greqisë? Kristo Papa lindi në vitin 1962 në Athinë, ai është i pagëzuar me emrin e gjyshit që ishte prift, origjina e tij është nga fshati Lipa që i përket zonës së Lakka të Sulit, krahinë që historikisht është banuar dhe banohet nga arvanitas ose grek me origjinë shqiptare. (Greqia duke patur popullsi nga kombet e tjera si arvanitas, sllavë, ortodoks nga Azia e vogël, çdo 10 vite u ndërron fshatrave se kujt Prefekturë duhet ti përkasin, kjo bëhet me qëllim për të bërë ngatërrimin e studiuesve të statistikave për popullsinë në Greqi). Fshati Lipa nga është origjina e vërtetë e familjes Kristo Papa është themeluar si fshat midis shek.16-17 nga sullotë dhe ndodhet 51 km larg qytetit të Janinës. Lipa ka rreth 50 banorë sot dhe i përket komunës së Sellon të Bashkisë së Janinës. Ka një kala të vjetër dhe një kishë. Në vitin 1997 Kristo Papa bashkë me familjen rikthehet në Janinë ku hapi një biznes për shitjen e mobiljeve COCO-MAT. Është babai i tre fëmijëve.

Kristo Papa që në fëmijëri u edukuar me frymën e heronjve revolucionar të 1821 që ishin nga Suli, të cilët prej shumë vitesh ishin kundërshtarët më të mëdhenj të Perandorisë Osmane dhe të pushtetit të Ali Pashë Tepelenës. Figurat e heronjve shqiptar të Sulit u bënë objekt frymëzimi të poetëve me famë në ato vite. Babai i Kristos, Ilija Kristo Papa ka lindur në vitin 1924, dhe ishte fëmija i pestë i një prifti të thjeshtë dhe një mësuese. Në moshën 17-vjeçare ju bashkëngjiti trupave të Napoleon Zervës. Majori Ilija Kristo Papa merr pjesë direkt në ndërhyrjen ushtarake të kolonel Gjeorgjio Papadhopolos, i cili instaloi diktaturën ushtarake në Greqi nga viti 1967-1974. Ushtaraku Ilija Papa u caktua në trupat e besueshme të sigurisë së Papadhopolit të cilin e emëroi më vonë Komisioner i qeverisë në Bankën Greke. Pas rënies së diktaturës më 1974, edhe pse u arrestua me akuzë për tradhti nga deputeti i PASOK, Evangjelo Janopolos, ai i shpëttojë burgut falë bashkëpunimit që vazhdoi me Kostandin Karamalisin. Në vitin 1975 doli në pension bashkë me qindra ushtarak që i kishin shërbyer sistemit diktatorial të Gjeorgjio Papadhopolos. Në moshë të thyer 89-vjeçare Ilija Papa vazhdon të jetë aktiv i organizatës "Agimi i Artë" dhe të propagandojë tek rinjtë frymën e juntës diktatoriale të Papadhopolos dhe të ideologjisë naziste Hitleriane.

Diktatori Papadhopolos ishte arvanitas, shpeshherë intelektualët arvanitas në fillim të viteve 1980 arrestoheshin nga sigurimi grek me pretekstin se po ringjallin ideologjinë e Papadhopolosit, këtë e ka deklaruar i

ndjeri Aristidh Kola në një intervistë që ja mora dy muaj para se të vdiste ku thotë: "Në fshatin e parë që shkuam, na pritën me lot në sy arvanitasit. Bëmë një takim të bukur, ku merrnin pjesë mbi 2.000 vota, por u zgjuan sigurim-sat e shtetit grek (AS-FALIA) dhe SFEVA (organizatë për çlirim-in e Vorioepirit). U futën brenda në godinë, duke bërë rrëmujë, na bllokuan dhe përzunë popullin arvanitas të fshatit. Të nesërmen, të gjitha gazetat e majta dhe të djathta shkruanin për ne, duke na sharë dhe thënë "njerëzit e Papadhopolit u zgjuan".

Figura më e dashur e Kristo Papës është Skënderbeu, Kolokotroni dhe Ali

Kristo Papa që në fëmijëri u edukuar me frymën e heronjve revolucionar të 1821 që ishin nga Suli, të cilët prej shumë vitesh ishin kundërshtarët më të mëdhenj të Perandorisë Osmane dhe të pushtetit të Ali Pashë Tepelenës. Figurat e heronjve shqiptar të Sulit u bënë objekt frymëzimi të poetëve me famë në ato vite

Pasha, këtë ma kanë thënë disa miq të afërt të Kristos të cilët janë arvanitas dhe me deklaratat e kohëve të fundit të tij antishqiptare janë habitur dhe distancuar. Megjithatë mendimi im është se deputeti Papa po bënë një punë të lavdërueshme me deklaratat ekstremiste duke i treguar botës perëndimore se Greqia mbetet një vend primitiv ku feja ngatërrohet me kombësinë si në mesjetë, ku në Greqi ka forca të ideologjisë naziste të cilat rrezikojnë të përhapen në vendet e BE si oktapod. Besoj se problemet e brendshme të Greqisë bëjnë që klasa politike e saj të gjejë ngushëllime duke reflektuar me dhunë kundër emigrantëve dhe shqiptarëve në veçantë. Kjo është një metodë e njohur për ne që kemi jetuar disa vite të jetës në atë vend.

Deklarata tej ekstremiste e Kristo Papës se nëse Agimi Artë vjen në pushtet do i shpallë luftë Shqipërisë

është bërë për marketing politik prandaj unë publikisht do ta pyesja se kundër kujt do luftojë Kristo Papa? Kundër nipave të Marko Boçarit (1790-1823) që jetojnë në Vlorë, kundër nipave të të Kiço Xhavelles (1801-1855) që jetojnë në Leskovik dhe Tiranë me mbiemër Tasho apo kundër nipave të Gjeorgjio Lallës-Karaiskaqit (1782-1827) që jetojnë në Gramsh-Elbasan dhe Tiranë!?

Dua të sqaroj lexuesit se arvanitas-i Kiço Xhavela është ish-krumbari në Greqinë, një pjesë e fisit të tij jetojnë në Shqipëri, pjesë nga Fisi i Boçarëve jetojnë në Vlorë, ndërsa Gjeorgjio Karaiskaqi është djali i Dhimitër Isko Lalla.

Gjergj Lalla i parë nga Suli kishte djalin Dhimitër Isko Lalla që bënte pjesë në trimat më të besueshëm të Ali Pashait. Dhimitër Lalla përdhanoi Zoinë në vitin 1781, një

Kristo Papa ideologu nazist

"Agimi i Artë" lindi kundër të majtës, tani kundër shqiptarëve

Nëse do shohim organizatën e Agimit të Artë nuk janë vetëm nazistë, as neonazistë, por janë diçka tjetër për të cilët bota duhet të trembet. Ata janë një organizatë e errët, e tmerrshme të cilët promovojnë ushtrinë naziste të Hitlerit për të cilën bota e sotme ndjen ende dhimbjet që i shkaktojnë ajo ushtri me ideologjinë e saj vrasëse deri në zhvarrosje të kombeve.

Kristo Papa që ne e shohim duke dhënë deklaratat për një luftë midis Greqisë dhe Shqipërisë ishte drejtuesi i shtypit dhe propagandës së "Agimit të Artë", në shkrimet që shkruante Papa ngrinte lartë figurat e nazistëve gjermane me një përkushtim patologjik. Agimi i Artë si organizatë u themelua për të dobësuar partitë e majta në Greqi, jo kundër shqiptarëve, bile shpesh herë në revistën e tyre botoheshin shkrime ku thuhej se grekët dhe shqiptarët janë



Shkrimet e Kristo Papës për ideologjinë naziste

vëllezër. Por pas viteve 2000, kjo organizatë u bë kundërshtarja më e fortë e emigrantëve shqiptar dhe Shqipërisë. Mendoj që këtu duhet të kenë gisht lobi sllav në Greqi që është shumë

i fuqishëm dhe kisha ortodokse.

Nëse do shohim nga e kanë origjinë shumica e deputetëve të Agimit të Artë do vërejmë se shumica e tyre vijnë nga fshatrat arvanitas si p.sh Nikolaos Mihalolakos, Eleni Zarlua, Kristo Papa, Mihail Arvaniti, Nikolaos Mihas (mbiemri këtyrë ka qenë Bythkalli para shumë viteve sepse e njoh familjen e tij), Dhimitrios Kukuqi, Estathios Bukuras (edhe një kushëririn e këtij e njoh, flasin shqip shumë mirë), Ilias Kacidharis etj. Lirisht mund të them se po u bëhet ADN do dali se e kanë të njëjtë me shqiptarët, por për fat të keq shteti shqiptar nuk ka institucione të të merren më seriozisht me këto gjëra dhe ministria e jashtme nuk ka diplomatë që kanë njohuri për arvanitasit. Kjo më dhemb shumë, prandaj ftoj publikisht ndonjë historian dhe studiues të më kundërshtojë këto që shkruaj.



Deputeti i "Agimit të Artë", Kristo Papa

Grua e ve, por shumë e bukur e cila kishte lidhje me Ali Pashain. Nga ky përdhunim lindi një femi që do të quhej Gjergji Llalla, i pakëzuar me emrin Gjeorgjio Karaiskaqi (1782-1827), hero i Revolucionit grek të 1821. Pra, Gjergji Karaiskaqi është djali i Zoisë dhe i Dhimitër Llalla, edhe emrin Gjeorgjio e ka nga gjyshi, Gjeorgjio Llalla. Në moshën të rritur Gjergji Llalla i dytë u pagëzua i krishterë nga Ndre Karaisko i cili i dha mbiemrin e tij Karaiskaqi. Këtë e shkruan Dhimitër

shit, formuan fshatrat: Shën Mëri, Shën Mitri, Dardhvezë, Sulki, Dushkë, Kushov, Janç, Tunjë etj. Nëse do të vërejmë disa fshatra kanë emrat të krishterë, por që janë mysliman sot, kjo tregon për origjinën e tyre të vjetër. Duhet të dimë se ekziston ende një rrugë nga Janina-Leskovik-Korçë-Gramsh, kjo rrugë nuk është e re, por e hershme. Banorët e parë që u ngulën në Sul ishin ushtarë e gardës të Gjergji Kastrioti Skënderbe. Mbas vdekjes së Gjergji Kastrioti Skënderbeut, rreth 200



Ilia Papa në vitin 1974

luftëtarë arvanitas me familjet e tyre formuan fshatin e Sulit afër qytetit të Janinës dhe luftonin kundra turqve për lirinë e tyre. Më vonë Suli u zgjerua nga një fshat në krahinë dhe u popullua nga shqiptar ortodoksë çamë. Ata, për t'i shpëtuar skllavërisë osmane turke, u shpërngulën nga fshatrat e tyre të Çamërisë rreth viteve 1500-1600 dhe u vendosën në Sul të Janinës, krijuan fshatra të rinj me emra shqiptar. Që një pjesë e popullsisë së sulotëve janë çamër këtë na e deklaroi anglezi V.M. Lik "Suljotët janë një farë e Çamërisë, njëra prej katër degëve të Shqipërisë". Ndërsa studiuesi Ciapolini thotë: "Suljotët nuk dinin fare greqisht, gjuha që ata përdornin është, shqipja e dialektit të Çamërisë". Mundem këto t'i gjeni në disa arkiva, por edhe në Institutin për Çështjen Çame në Tiranë.

Më vjen keq që historianët tanë i anashkalojnë me qëllim disa gjëra të vërteta rreth shqiptarëve të Greqisë, nëse ne do ishim marrë më seriozisht me këto çështje grekë dhe shqiptarë do ishin më afër duke mos i ngritur kurthe njëri-tjetrit.

*Historian i pavarur

BABAI I KRISTOS Në moshën 17-vjeçare ju bashkëngjit trupave të Napolon Zervës. Majori Ilia Kristo Papa merr pjesë direkt në ndërhyrjen ushtarake të kolonel Gjeorgjio Papadhopulos, i cili instaloi diktaturën ushtarake në Greqi nga viti 1967-1974.

REVISTA E NAZISTËVE

"Grekët dhe shqiptarët janë vëllezër të një race"

Skrimi i botuar më Tetor 1986, në revistën e Agimit të Artë

Përkundër fraksioneve të de gjeneruara koloniane dhe in situacioneve, opinioni jonë i ndershëm dhe krenar gjithmonë nuk ka injoruar çmimin e sakrificës. Në të njëjtat ritme përtërimë origjinën tonë, duke prekur një çështje të nxehtë kombëtare, duke përcaktuar gjakun e hershëm dhe prejardhjen, rezultat i botëkuptimit të racës sonë dinamike. Duke hedhur tutje propagandën e partive politike të injorantëve dhe të aparatçikëve, të cilët i referohen me pasion patriotik historisë duke predikuar ngjashmërinë e patundur të grekëve me shqiptarët apo Arvanitasit. Mendimi, dokumentimi, tradita e lashtë dhe njohuritë shtrihen në ditët e sotme dhe kanë përqafuar çdo fushë të kulturës sonë. Përtej ngjashmërisë dhe afrimitetit të grekëve të lashtë me ilirët, nëpërmjet origjinës indo-evropiane, vëzhgimi i kujdesshëm i historisë përfordon identifikimin e ekzistencës kombëtare. Duke njohur vlerat e luftës dhe përpjekjeve të herojve tanë shprehim drejtësi historike duke ndëruar përpjekjet e tyre paravarësisht origjinës së tyre të specifike. Në njohjen e gjërë të Greqisë do të duhet të shtojmë dhe shpërthimet e kësaj historie, duke kujtuar këtu luftëtarë e Pirros, të Teutës,



Skrimi "Grekët dhe Shqiptarët, një popull, një race, një atdhe", tetor 1986

të Farias, të Gentit kundër Perandorisë Romake. Por, edhe në vijim dhe ato të periudhës së Perandorisë Bizante, strategët ilir si, Velisari dhe Vranajt, por dhe vet perandorët Konstandini i Madh (nga Dardania), Anastasi, Juliani dhe Leon Zguri, i japin historisë një përgjigje më të plotë. Vlerësimi se, vitaliteti me të cilin kanë vaditur nënën Greqi këto fise të pasur të atdheut është

të jo vetëm e nevojshme, por edhe e vërtetë. Sepse luftëtarët e zjarrtë që lanë gjurmë me aktet e tyre heroike dhe dhanë jetën në More, Rumeli, në zonën e Shtatë Ishujve, në Epir dhe në zona të tjera padyshim i dhanë një shtysë të madhe me qëllim që të ndihmojnë vëllanë e jugut, i cili ishte rebeluar kundër osmanëve, kështu që me të drejtë përkrahjen si Dorët (fisi ilir) e helenizmit modern. Prapa fanatizmit dinak dhe kurryeve të pakuptueshme që qëllimisht fshehin një nga elementët më të bukur të historisë sonë, shfaqet sakrificat dhe trimëria Arvanitase gjatë kohës së revolucionit kombëtar më 1821. Sakrificat e familjes Gjika në Moldavi, besalinitë dhe burrritë e Buaive, Grevenarëve e mbrojtësit të madh të familjes së Shkurtëve, Buzara, e Bardhëve, Llallave dhe Suliotëve si dhe shpallja e shpërthimit i revolucionit grek në Mesini në Mars të 1821-t nga Dredhët, luftëtarët e panumërt në mbrojtje të ishujve të Idrës dhe Spees. Figura të pakthyeshme me kalimin e kohës si Kokali, Andraço, Kaçioni, Grindali, Plaputa, Kuqionin, Mjauli, Kolokotroni, Spiromilo, Bubulina,

Ngjyrat



Në foto: Grekët shkruajnë Gjeorgjio Kastrioti i quajtur Skënderbe, Mbreti i Shqiperisë

"Agimi i Artë" përdor simbolet e vjetra shqiptare

Në përgjithësi organizata "Agimi i Artë" përdor simbolet e vjetra shqiptare, ajo si një kryesore ka fushën e kuqe me shkronja të zeza dhe shqiponjën dy krenare që është simboli i familjes së Kastriotëve. Por pasi fitojë disa vende në Kuvendin e Greqisë ndryshojë ngjyrat nga Kuqja e Zi në të Kaltër me të Bardhë, kjo u bë pasi partitë majtiste i akuzuan se janë me origjinë shqiptare dhe përdorin ngjyrat e flamurit të Skënderbeut. Në numrin e revistës të Agimi i Artë të Tetorit 1986 shkruhej me shkronja të madh: "Grekët dhe Shqiptarët, një popull, një racë, një atdhe". Shkrimi në fjalë revista i kishte kushtuar dy faqe të saj ku jepeshin të dhëna mbi lidhjet e dy popujve. Shkruasi i artikullit thotë se shqiptarët dhe arvanitasit janë e njëjta gjë. Ai jep disa të dhëna në lidhje të ngjashmërisë së gjuhës së Omerit me gjuhën shqipe si dhe flet për Pirron, Kostandinin e Madh, Justinianin, Kolokotronin etj., të cilët ishin ilirë. Me interes është fakti se autori i shkrimit të botuar në revistës e "Agimit të Artë" është njeri nga themeluesit dhe drejtuesit kryesor i cili ka vënë iniciata FAETHON.

Prapa fanatizmit dinak dhe kurryeve të pakuptueshme që qëllimisht fshehin një nga elementët më të bukur të historisë sonë

Karajskaqi, Kundurioti, Boçari etj. Të gjithë këta kanë qenë eksponentët të luftës anti-turke dhe pasardhës të Aleksandrit të Madh të Ballkanit, Gjergji Kastrioti Skënderbeut së bashku me figurën shumë të keqkuptuar të labit Ali Pashë Tepelena...



Alartekst-i do të ndryshojë këtë vit të ri shkollor

Sistemi i sigurimit të teksteve Shkollore të arsimit parauniversitar, Alartekst-i, do t'i nënshtrohet sërish ndryshimeve vitin e ardhshëm shkollor në lidhje me kohëzgjatjen e afateve që do të kenë botuesit për hartimin e teksteve. Sipas ministrit të Arsimit, ndryshimet në reformën vijnë si rrjedhojë e përmirësimit të mëtejshëm në

përzgjedhjen e teksteve më të mira shkollore. Tekstet alternative do të vazhdojnë të shtohen në tregun e librit shkollor, por do të jenë mësuesit ata që do të bëjnë përzgjedhjen e teksteve më të mira. Sistemi i sigurimit të teksteve shkollore nuk është më ai i para vitit 2006. Reforma e tekstit shkollor e emëruar "Alartekst", ka bërë që në

Ministrinë e Arsimit, të dalë nga funksionet botuese të librit mësimor. Pasi, gjetja e autorëve, shtypshkronjat, shitja e teksteve, marrëveshjet për copyright-in e tyre, etj, janë detyra të botuesit, tashme dhe jo e ministrit. Viti që vjen sistemi i detyruar 9-vjeçarë do të ndryshojë. Ai do bëhet gjatë vitit arsimi fillor nga pesë vite që është tani.

Trafik, rrugë me gropa është pamja e lagje së re

"Komuna e Parisit" luks dhe baltë

Banorët: Rrugat e ngushtë dhe të dëmtuar

Lajmi

Lagja më e populluar vitet e fundit "Komuna e Parisit" është në një gjendje të mjeruar. Rrugat nga kryqëzimi i stadiut "Selman Stërmasi" dhe deri në dalje të "Unazës së Madhe" është e tëra me gropa dhe me baltë. Ndërsa trafiku në këtë lagje çdo ditë është i rënduar.

TIRANE


Komuna e Parisit, një nga lagjet më të mëdha dhe më të populluara të kryeqytetit ndodhet në gjendje të mjeruar. Nga kryqëzimi i stadiut "Selman Stërmasi" dhe deri në fund të rrugës "Komuna e Parisit", çdo cep i rrugës është i shkatërruar. Sipas një vëzhgimi të bërë nga gazeta "IDEA", nga kryqëzimi i stadiut "Selman Stërmasi" deri në dalje të "Unazës së Madhe", kjo rrugë është e shkatërruar dhe me trafik të rënduar çdo ditë. Kjo për shkak të lidhjes që kryhet në pjesën e përfunduar të "Unazës së Madhe" të Tiranës, vazhdimi i se cilës deri të shkolla "Teknologjike" ende nuk ka filluar. Përgjatë gjithë rrugës "Komuna e Parisit", has në rrugë me gropa dhe baltë. Banorët dhe drejtuesit e automjeteve që kalojnë çdo ditë në këtë segment rrugor shprehen të shqetësuar për gjendjen e kësaj rrugë. "Këtu ngecesh



Shoferët

Këtu ngecesh për minuta të tëra në trafik, ngaqë rruga është e dëmtuar dhe e gjitha me gropa, makinat janë të detyruara të ecin ngadalë. Kjo gjë sjell trafik dhe stres sidomos për ne që kalojmë çdo ditë në këtë rrugë.

Në foto: Rrugët e prishura të "Komuna e Parisit"



për minuta të tëra në trafik, ngaqë rruga është e dëmtuar dhe e gjitha me gropa, makinat janë të detyruara të ecin ngadalë. Kjo gjë sjell trafik dhe stres sidomos për ne që kalojmë çdo ditë në këtë rrugë", shprehet drejtuesi i një automjeti. Por ajo që i shqetëson më tepër drejtuesit e automjeteve që përshkojnë këtë rrugë është fakti se makinat e tyre dëmto-

hen shumë. "Shikoni sa janë gropat na u bë makina copë, duhet ta çojmë çdo muaj në servis. Kjo rrugë duhet të rregullohet urgjentisht jo vetëm për ne, por edhe për banorët e kësaj lagje". Ndërsa banorët e "Komunës së Parisit" ankohen se rruga është shumë e ngushtë dhe kanë shumë vështirësi në kalimin e saj " Rrugat është shumë e ngushtë, të kalojmë ne

apo të kalojmë makinat. Varg janë makinat këtu ditë natë" thotë një banor. " Nuk dimë çfarë do bëhet më këtë rrugë në dimër na mbyl balta në verë pluhuri. Shpresoj të rregullohet sa më shpejt që ne që jetojmë këtu e kemi shumë të vështirë" ankohen një tjetër banor. Si banorët dhe pronarët e bizneseve, të cilët e kanë vendosur biznesin e tyre anës rrugës

kërkojnë që kjo rrugë të rregullohet sa më shpejt sepse sipas tyre ata po jetojnë në fshat në mes të kryeqytetit. Lagjia "Komuna e Parisit" është një nga lagjet më të reja dhe më të populluara kohët e fundit. Kjo lagje ka marrë zhvillim më shumë pas viteve '90. Ku ajo që të bie me shumë në sy janë vila dhe pallatët luksozë të kësaj lagjeje.

LAJME SHKURT

Nis funksionimi Këshilli Rinor i qytetit të Tiranës
Pranë bashkisë së Tiranës ka nisur dje zyrtarisht funksionimi i këshillit rinor të Tiranës. Ky këshill përbëhet nga 48 anëtarë Presidentë dhe kryeministra të 24 shkollave të mesme dhe profesionale të Tiranës. Më datë 25 janar anëtarët e këshillit rinor kanë zhvilluar zgjedhjet për kryetarë dhe nënkryetarë të këshillit. Në postin e Kryetarit është zgjedhur Faljona Kulla presidente e shkollës "Qemal Stafa". Në hapje të mbledhjes së parë të këtij këshilli kryebashkiaku Basha tha se partneriteti me të rinjtë gjimnazistë të Tiranës është shumë i rëndësishëm për qytetin.

Bashkia pret pemët pranë ATSH-së, rrezikojnë banorët
Vetëm pak ditë pas rrezimit të pemës pra ATSH-së, bashkia ka nisur aksionin për prerjen e tyre. Kjo është bërë shkak që punonjësit e Bashkisë, dje në mëngjes të nisnin prerjen e pemëve që ndodhen buzë rrugës pasi ato rrezikonin jetën banorëve aty pranë. Të premtën rreth orës 8 të mëngjes pema që është afër stacionit të urbanit u rrezua në mes të rrugës. Por, fatmirësisht nuk kishte asnjë makinë të parkuar, apo kalimtar gjë e cila mund të shkaktojte viktimë. "Dje erdhën disa punonjësit që të prisnin këto pemë që janë buzë rrugës pasi përbejnë rrezik për banorët e kësaj zone" thotë një banor.

Ksера: Duhet zbatuar ligji për punësimin e "PAK"-së
Ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga bizneset në vend, nuk është zbatuar me rreptësi kështu është shprehur Ministri i Punës Spiro Ksера, në Komisionin e Punës dhe Shëndetësisë ai ka kërkuar nga ky komision që të vihet në zbatim ky ligj, ndërsa deklaroi se zbatimi i tij mbetet prioritet për vitin 2013. Ksера deklaroi se nga 32 inspektorate që ka pasur në total, me reformën e re inspektoratet do të reduktohen në 14, duke ulur kështu veprimet burokratike, rritur transparencën dhe shtimin e punësimit. Në Komisionin e Punës dhe Shëndetësisë kanë raportuar për reformën e inspektorateve edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë.

Problem prej vitësh

"Todi Shkurti", rruga e shkatërruar e "Ali Demit"

Banorët: Bëhet si liqen sa herë bie shi. Asnjë investim për këtë rrugë, e cila është më problematike

TIRANE

Rruga "Todi Shkurti", e cila është pjesë e një prej lagjeve më të mëdha të Tiranës në atë të "Ali Demit", është e shkatërruar. Kjo rrugë ka një gjatësi prej 750 metrash dhe pjesa më e madhe e saj është totalisht e dëmtuar. Pjesa më problematike e rrugës është ajo që ndodhet pranë kompleksit të pallateve "Grand". Banorët e rrugës "Todi Shkurti", shprehen të shqetësuar për këtë fakt "Rrugat është shumë e keqe, e dëmtuar e shkatërruar fare. E shikon edhe vetë. Kur ka shumë shi, siç ka rënë këto ditë gropa mbushen me ujë dhe është shumë e vesh-



Pamje nga rruga "Todi Shkurti"

tirë të kalosh. Të duket sikur po kalon në ndonjë liqen" shprehet një banor e lagjes. Problem në kalimin e kësaj rrugë nuk kanë vetëm këmbësorët, por edhe automjetet, drejtuesit e tyre të inordinuar na thonë " Na u bë makina copë, me këto rrugë që më shumë janë të shkatërruara se sa të rregulluara. Unë kam edhe shtëpinë këtu dhe me duhet të kaloj me makinë çdo ditë dhe pa e eka-gjeruar e çoj makinën pothuajse një herë në muaj në servis. Se me këto gropa që ka kjo rrugë është e pamundur mos të dëmtohet makina. Aq me tepër këto të vegjlat si kjo e imja. Nuk e di a do e rregullojnë këtë vit, uroj që ta rregullojnë me këtë iniciativën e re që ka filluar, ku po rreg-

ullohen disa rrugë" shprehet drejtuesi i një automjeti. Problem për banorët e kësaj rrugë nuk janë vetëm gropa e krijuara nga amortizimi i saj. Por problem janë edhe pusetat, të cilave u janë vjedhura kapakët. "Përditë këtu shoh ndonjë pusët pa kapak. Duhet të jesh shumë e kujdesshme sidomos natën se mund të përfundosh në pusët. Nuk di se si mund të bëhet zgjidhja e këtyre, se sa vendosen kapakët nuk e mbushin javën. Ndonjë ditë do përfundojmë në pusët" na thotë një vajzë. Në buxhetin e Bashkisë së Tiranës, për këtë vit kjo rrugë nuk është e planifikuar për rikonstruksion, edhe pse është një ndër segmentet me kryesore të lagjes se "Ali Demit".



**Fier, mbetjet
spitalore nuk do të
digjen pranë pediatriisë**

Viti 2013 do t'i japë fund ndotjes së mjedisit nga mbetjet spitalore ne qytetin e Fierit. Sipas drejtoreshës së Spitalit Rajonal, Donika Alujshani, mbetjet spitalore nuk do të digjen më në krematoriumin pranë pediatriisë, duke ndotur mjedisin, por do të asgjësohen nga kompani të specializuara për mbrojtjen e mjedisit jashtë qytetit. "Ne kemi hartuar

një projekt afatgjatë, që i jep fund problemit të ndotjes nga mbetjet spitalore", tha ajo. Drejtoria e spitalit ka dërguar projektin e asgjësimit të mbetjeve në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila e ka miratuar atë dhe i ka hapur rrugën financimit të këtij projekti. Sipas Alujshanit, kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe është bërë shpallja

elektronike e tenderimit, për t'u dhënë mundësi kompanive të interesuara të marrin pjesë në këtë proces. "Pavarësisht mbështetjes dhe bashkëpunimit të mirë me bashkinë e Fierit për pastrimin e mbetjeve spitalore, problematika ka qenë prezente, pasi zgjidhja me bashkinë ishte provizore dhe nuk garantonte mbrojtjen e standardeve mjedisore", theksoi ajo.

Specialistët: Situata epidemiologjike e qetë, nuk ka vend për panik

Pesë raste me virusin AH3N2

Në Shqipëri janë shënuar 5 raste me virusin AH3N2, të gjitha rastet janë identifikuar në spitalin Infektiv në QSUT. Pipero: Vetëm një person ka qenë në gjendje të rëndë

Lajmi

Mbërrin në vendin tonë gripi AH3N2. Sipas Institutit të Shëndetit Publik, në Shqipëri janë shënuar pesë raste me virusin e gripit A H3N2. Nga këto 2 raste janë me virusin e tipit A dhe 3 me atë të tipit B. Por sipas specialistëve nuk ka vend për panik.



■ ■ ■ **TIRANE**
JONIDA LATE

Në vendin tonë janë shënuar 5 raste me virusin AH3N2. Nga këto 2 raste janë me virusin e tipit A dhe 3 me atë të tipit B. Ndërsa sipas specialistëve situata epidemiologjike e gripit sezonal paraqitet e qetë, ndërsa, sipas strukturave shëndetësore, nuk ka vend për panik, por për përkujdesje për t'u mbrojtur. Drejtori i Politikave Shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë, Pëllumb Pipero, në lidhje me këto raste është shprehur se personat e identifikuar me AH3N2 janë

paraqitur në spitalin infektiv në QSUT " 5 rastet me gripin AH3N2 janë identifikuar në Tiranë. Pacientët janë paraqitur pranë spitalit infektiv". Pëllumb Pipero është shprehur se të sëmurët janë jashtë rrezikut për jetën "Ata janë paraqitur me simptomat e një gripit të zakonshëm dhe në QSUT janë identifikuar me virusin AH3N2. Një nga këto raste ka qenë në gjendje të rëndë, por tani nuk ka asnjë problem dhe është në kontroll

Ka një aktivitet të ulët të gripit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, numri i rasteve është 34 % më i pakët

të vazhdueshëm nga mjekët". Më tej Drejtori i Politikave Shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë thotë se "Virusi

AH3N2 nuk është virus i ri i panjohur qoftë nga shkencë, apo organizmi i njeriut, Ka disa vite që qarkullon, ndaj nuk ka vend për panik, por për më shumë kujdes, që ka të bëjë me vaksinimin apo konsultimin me mjekun" tha Pipero, sipas të cilit, nuk bëhet fjalë për virus të ri që kërkon masa të shtuara. "Bëhet fjalë për virus të njohur dhe për masa që janë të njohura", përfundoi Pipero. Ndërsa Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik, Enver Roshi, tha se edhe pse ka një tendencë rritjeje të virozave stinore, numri i rasteve nuk e kalon pragun epidemik. "Ka një tendencë rritjeje të rasteve me viroza stinore, por kjo tendencë nuk kalon pragun epidemik. Ka një aktivitet të ulët të gripit. Sipas tij, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, numri i rasteve është 34 % më i pakët. Roshi bëri të ditur se nga 72 mostra të marra në periudhën tetor-janar nga spitali në vend, vetëm 5 kanë rezultuar me virusin e gripit A dhe B. Rastet, sipas tij, aktualisht janë në gjendje shëndetësore të mirë dhe nuk ka raste fatale. Ndërkohë, ISHP është në ndjekje të vazhdueshme dhe monitorim 24 orësh të situatës.

Mjekja

Zeço: Mos neglizhoni vizitat te mjeku

Cilat janë simptomat e gripit AH3N2 ?
Simptomat janë ato të një gripit klasik: Si hundë, kollë, dhimbje fyti, temperaturë, dhimbje koke, nuk është se virusin AH3N2, ka shenjat të veçanta nga viruset e tjera. Ajo që i diferencon është analiza serologjike, që bëhet dhe përcakton se çfarë virusi është.

Personat më të rrezikuar ?

Personat më të rrezikuar janë, të sëmurët kronikë, gratë shtatzëna, fëmijët dhe të moshuarit. Ajo që dua të them është të mos neglizhohet vizita te mjeku.

LAJME SHKURT

■ Moti i keq bllokoi 4 mijë banorë në Tepelenë

Moti i keq me reshje të shumta gjatë javës së fundit ka shkaktuar probleme ende të pazgjidhshme në infrastrukturën rurale. Dy komunat më të goditura nga dëmet që shkaktoi natyra, janë ato të Buzit dhe Luftinjës në rrethin e Tepelenës. Gati 4 mijë banorë të tyre, prej më tepër se një javë kanë ngrulur të izoluar për shkak të shkatërrimit total të një pjese rruge në afërsisht të Sektorit të Tretë, në ish-minierën e qymyrgurit. Intensifikimi i reshjeve ka spostuar dyshemenë e rrugës jo në dy, po në plot pesë vende prej të cilave, një është tërësisht e datë jashtë funksionit. Kjo gjendje ka rënduar edhe tek 700 nxënësit e shkollave të mesme, 9-veçare dhe parashkollore, që të mos marrin dije në 10 ditët e fundit, për shkak të mungesës së mësuesve. Deri tani asnjë ndërhyrje nuk është kryer nga ana e komunës apo dhe drejtorisë rajonale të rrugëve.

■ Banorët e fshatrave të Lumit të Vlorës, protestojnë

Pak ditë pas përmbytjeve dhe problemeve me rrëshqitjet e dheut për shkak të mungesës së argjinaturave, banorë të fshatrave pranë Lumit të Vlorës, kanë protestuar, duke kërkuar që shteti t'i hedhë sytë nga ata. Të mbështetur dhe nga deputeti Fatmir Toçi, banorët shprehën indinjatën e tyre dhe për gjendjen e rrugës. Ata paraditen e djeshme protestuan për gjendjen e keqe të rrugës më të madhe që lidh Vlorën, me 100 fshatra të krahinës së Labërisë. Në mbështetje të protestës ishte dhe deputeti i Partisë Socialiste, Fatmir Toçi, i cili tha se kjo zonë ka dale jashtë çdo lloj vëmendje të qeverisë së korruptuar të Berishës dhe premtori që sapo të vijnë në pushtet kjo rrugë e rëndësishme e Vlorës do të jetë e para që do të rikonstruohet.

KORÇE Infrastruktura

Rrugët nacionale dhe të qytetit jashtë standardit

Drejtuësit e mjeteve: Rrugët, gjithë gropa. Dëmet janë të konsiderueshme, makinat na u shkatërruan

■ ■ ■ **KORÇE**



Dimri i këtij viti edhe pse jo shumë i ashpër ka filluar të nxjerrë në pah të gjitha problemet infrastrukturorë në Korçë, jo vetëm brenda në qytet, por dhe në akset nacionale. Problematike janë pothuajse të gjitha rrugët, kryesisht para teatrit, pazarit, bashkisë, stacionit të autobusëve. Por, problem kanë edhe akset nacionale, një i tillë është aksii Korçë-Ersekë si dhe aksii që të çon në pikën turistike të Voskopojës, ku drejtuesve të mjeteve duhet fillimisht ta zhytin automjetin mes gropave dhe ujit dhe më pas të vazhdojnë rrugën. Drejtuesit e mjeteve shprehën të shqetësuar nga

ky fakt, ndërsa kërkojnë marrjen e masave, pasi dëmi dhe vlera në lekë sipas tyre nuk mund të llogariten "Rrugët, gjithë gropa. është problem shumë i madh. Dëme të konsiderueshme, ndërsa bashkia nuk do t'ia dijë", shprehet një drejtues mjeti. "Skandal fare, dëmin që shkaktohet mos e pyet", ankohejt një tjetër. "Na i paguan shteti dëmin. Patjetër që duhen të merren masa, çdo gjë e mirë është e mirë për të gjithë jo vetëm për ne", shprehet një drejtues, i cili po udhëtonte në aksin Korçë-Ersekë. Të lodhur nga premtimet pa fund, ka dhe nga ata qytetarë të cilët për të shprehur shqetësimin zgjedhin formën e ironisë. Për këtë kategori është e kotë të flasësh, pasi zëri i tyre nuk dëgjohet më tash-

më. "Cfarë të them unë, edhe po të them diçka do bëhet? Për mua asgjë nuk është shqetësim, ata e dinë, ata marrin rrogë ne nuk dimë gjë. Taksat do t'i paguajmë, jemi të detyruar. Nuk dimë gjë, nuk merremi me këto punë. Cfarë dëmi i bëhet automjetit, sa më shumë gropa të ketë më mirë është", shprehet me ironi një drejtues mjeti. Nuk është hera e parë që dimri nxjerr në pah problemet në rrugët e Korçës, duke dëshmuar kështu dhe cilësinë e dobët të tyre. Në shumë raste është mjaftuar vetëm me mbulimin e gropave me dhe apo me beton. Por, kjo ka qenë e përkohshme pasi kanë mjaftuar vetëm pak minuta shi që çdo gjë të kthehej në gjendjen e mëparshme.



RRETHE

Elbasan, Shëndeti

Publik "mbyll"

rubinetat: Uji i ndotur

Drejtoria e Shërbimit Publik në Elbasan, jep alarmin për ujin e ndotur të një fshati. Për këtë arsye, ky institucion ka bllokuar ujësjellësen e fshatit Shalës, pranë Belshit, për shkak të tubacioneve të amortizuara dhe rrjetit jashtë qdo standardi. Këtë e ka konfirmuar për Shqiptarja.com dhe A1 Report, Bujar Kllugjeri, Drejtori i Shëndetit Publik në

Elbasan. Sipas Kllugjerit, ky ujësjellës, në bazë të kontrolleve të kryera, rezultoi se përcillte ujë të pijshëm në kushte jooptimale. Gjithashtu, ai theksoi se, nga ana e kësaj drejtorie, i është lënë afat 1 javë kohë Ujësjetillësit për ndërhyrjet e nevojshme pasi çdo gjë është e amortizuar. "Në lidhje me situatën e higjienës së ujit, vazhdojnë kontrolle të herëpashershme nga ana e

Shëndetit Publik, në të gjitha komunat, pasi shirat e rena me intensitet bëjnë që në pikat e amortizuara të ketë ndotje dhe rritje mikrobike në ujin e pishëm. Inspektorët e Shëndetit Publik u bëjnë thirrje banorëve, të cilët furnizohen nga ujësjellësi i fshatit Shalës, të mos e konsumojnë aktualisht, për të pirë këtë ujë, pasi lejohet vetëm për çështje komunale", theksoi Kllugjeri. a.q

DURRES

Jepet vendimi, 80-vjeçarit i ulet 1/3 e dënimit

Përjetë në qeli vrasësi i vajzës 18-vjeçare

Shaban Norja i preu kokën Ajshe Vatës

Lajmi

I akuzuari për vrasjen e 18-vjeçares Ajshe Vata, ngjarje e ndodhur më 14 tetor të vitit të kaluar, në Xhafzotaj të Durrësit, do të qëndrojë 25 vjet në burg. Gjykata e Durrësit e dënoi dje Shaban Norjen me burg përjetë, por duke përfituar nga ulja e një të tretës së dënimit, ai do përfiton 25 vjet burg.

DURRES

ARTUR KORRIKU

Vetëm Zoti e di sa jam penduar që e kam vrasë". Kaq ka mundur të thotë në shenjë dëshpërimi Shaban Norja, 80 vjeçari, i cili do të qëndrojë plot 25 vjet në burg, i akuzuar për vrasjen e prarjen e kohës të 18-vjeçares, Ajshe Vata, e cila ishte dhe 3 muajshe shtatzënë. I cili ka pranuar që në fillim ekzekutimin në mënyrë macabre të adoleshentesh, u akuzuar nga prokuroria për vrasje me paramendim në rrethana cilësuese. Gjykata e Shkallës së Parë në Durrësit, përfundoi dje në kohë record gjykimin, duke bërë që brenda 3 muajve, procesi të mbyllet. Togat e zeza të Durrësit, kanë pranuar kërkesën e prokurorisë me burg përjetë për Shaban Norjen, duke vendosur të njëjtin masë dënimi, por fakti që ai ka pranuar veprën penale, ia ul atë automatikisht në 25 vjet heqje lirie.

Kryetari i trupit gjykues, Edvin Metalla, njëkohësisht dhe kryetar i Gjykatës së Durrësit, pasi dëgjoi edhe njëherë pretendimet e avokatit, lexoi në seancën e djeshme gjyqësore vendimin e dënimit, duke e lënë pas hekurave Norjen, ndoshta përjetësisht, edhe për shkak të moshës së tij.

"Vetëm zoti e di sa i penduar jam". Kaq ka mundur të thotë ndër dhembë i moshuar pas vendimit, ndërkohë që avokati mbrojtës, në emër të klientit të tij, i kërkoi të falur familjarëve të viktimës dhe vetë opinionit publik.

Trupi i dekapituar i Ajshe Vatës, u gjet më 14 tetor të vitit të kaluar pranë Xhafzotajt, në rrethin e Durrësit, nga kalimtarë të rastit, vetëm 500 metër larg banesës së saj. Trupi ishte i ndarë nga koka, ndërkohë që kjo e fundit nuk



Shaban Norja

u gjet. Pas shumë shoqërimesh, marrjes në pyetje dhe hetimesh, policia arriti të vërë në pranga 80-vjeçarin Shaban Norja. Fillimisht ai nuk e pranoi krimin, por pas disa orësh në polici, deklaroi se ai e kishte vrasë. Madje, tregoi edhe vendin ku e kishte fshehur kokën e prerë të vajzës, të cilën policia e mori dhe e dërgoi në morg.

Gjatë procesit 4 muajsh të Shaban Norjes, në gjykatën e Durrësit nuk mori pjesë asnjë prej të afërme apo familjarëve të tij. Po ashtu, as nga njerëzit e viktimës Vata.

Shaban Norja ka deklaruar para policisë, pak pas arrestimit, si dhe gjatë marrjes në pyetje nga prokurorët, se ai e kishte vrasë Aishe Vatën, pasi ajo i ishte lutur. "Nuk kam dashur ta vras, por ajo me lutej. E qëllova dhe më pas ia preva kokën, vetëm që të humbja gjurmët e të mos gjendej asnjë mundësi të më zbulonin", deklaroi në tetor 2012 Shaban Norja, i cili më pas pranoi se, edhe femija 3 muajsh në barkun e 18-vjeçares, ishte i tij dhe kjo ishte arsyeja pse Aishe Vata kërkonte që Norja ta vriste.

Hetimet

Nga përdhunimi, incest, pistat për vrasjen e Vatës

Menjëherë pasi u zbulua trupi pa kokë i vajzës 18-vjeçare, pistat e policisë për motivin e krimit, ishin të shumta. Një ngjarje e tillë makabër nuk mbahej mend se kur kishte ndodhur, ndërkohë që në policinë e Durrësit u thirrën menjëherë familjarët e Aishes, të cilët dëshmuar për orë të tëra për lidhjet e saj, shoqërinë, njohjet, ndonjë problem të mundshëm etj. Por, kur nga Mjekësia Ligjore, policisë i shkoi raporti se viktimja kishte qenë 3 muajshe shtatzënë, situatë "doli jashtë kontrollit". Menjëherë pistat e hetimit u shtyrën në ndonjë incest të mundshëm familjar ose ndonjë përdhunim të kohëve më parë. Kështu, në polici u rithirrën familjarët e

saj, si dhe miqtë e të njohurit e vajzës. Kur nuk u arrit gjë me ta, hetimet nisën duke verifikuar çdo lëvizje, shoqërim apo njihje të vajzës kohë e fundit. Kështu, si i dyshuar u shoqërua Shaban Norja, plot 80 vjeç, i cili në fillim u mendua se mund të jepte vetëm ndonjë informacion që mund ta ndihmonte policinë, pasi ishte dhe fqinj i vajzës. Por, pas disa orësh marrje në pyetje, ai ka deklaruar se ishte vetë autori i ekzekutimit makabër. Ai ka treguar se edhe femija në barkun e Aishes ishte i tij dhe se ky ishte shkak i vrasjes. "Ajo më luter nitë e natë ta vrisja, pasi uën nuk e lejoja ta abronte femijën", deklaroi Norja, i cili i tregoi policisë edhe vendin ku kishte fshehur kokën e prerë.



Ajshe Vata

LAJME SHKURT

■ Vlorë, arrestohet i dyti për acidin
Policia e Vlorës ka vënë në pranga një person të dytë, i cili është akuzuar për bashkëpunim në sulmin me acid ndaj gjykatëses Mishgjoni, pak javë më parë. Policia njoftoi dje se ka vënë në pranga Ledio Kamberin, 19 vjeçe, nga lagjia "28 Nëntori" në Vlorë, pasi dyshohet se ka ndihmuar Nertili Zotajn, (i arrestuar), në sulmin me acid të gjyqtarës Mirela Mishgjoni, duke i treguar autorit banesën e gjyqtarës.

■ Durrës, kapet i kërkuari për plagosje
Policia e Durrësit ka nisur procedimin penal në mungesë, ndaj Erjon Kecit, 23 vjeç, nga Shijaku. Sipas burimeve zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Durrësit, hetimi dhe shpallja në kërkim filloi pasi 19-vjeçari nga Tirana M.C., e ka denoncuar se, në "Lagjen e Mesn", në Fermë-Sukth, e ka plagosur me armë në pjesën e këmbës. Fillimisht u bë shpallja në kërkim për Erjon Kecin dhe u morën masa në drejtim të kërkimit të tij duke bashkëpunuar edhe me komisaritet në rrethe, si dhe pikat e kalimit kufitar. Po sipas policisë, ai është ndaluar të djelenë në Morinë, duke tentuar të largohet për në Kosovë.

■ Kruijë, pranga rojes për armë pa leje
Një i shpallur në kërkim nga policia, është arrestuar, pasi ishte akuzuar për armëmbajtje pa leje. Forcat e komisaritetit të Kruijës vunë në pranga të shtunën rreth ors 11.00, Ramadan Danin, 55 vjeç nga fshati Tapizë. Sipas njoftimit zyrtar të policisë, arrestimi i tij është bërë pasi më 7 janar, në vendin ku punonte si roje, i janë gjetur një pushkë model 56, kaliber 7.62 mm dhe 20 copë fishekë, ndërsa në momentin e kontrollit, ai nuk ndodhej në vendroje.

■ Elbasan, në qeli se rrihte gran
Policia e Elbasanit ndaloi dje Fatmir Sulen, 52 vjeçe, banues në lagjen "Qemal Stafa. Arrestimi i tij, sipas njoftimit për shtyp është bërë se, ky person, në mënyrë sistematike, ka goditur me sende të forta bashkëshorten e tij P.Sula. Pas denoncimit të gruas, 52-vjeçari ishte shpallur në kërkim për "dhunë në familje".

FIER

Trafiku

Braktis mjetin me 340 kile hashash

FIER

Rreth 340 kilogramë hashash janë bllokuar dje nga policia e Fierit. Ka qenë ora 03.00 e mëngjesit, kur uniformat blu janë sinjalizuar për një makinë me targa të huaja, e cila lëvizte nga Vlora në drejtim të Fierit, me një ngarkesë të dyshimë. Menjëherë janë vënë në lëvizje policitë e Fierit dhe Vlorës, për të ngritur post-bloqe, por duket se personat që ndodheshin në automjetet e kanë braktisur atë. Dhe, pikërisht pranë Levanit, kur shoferi ka vënë re nga larg edhe praninë e poli-



Droga e kapur dje në Fier

cisë, e ka devijuar rrugën dhe e ka braktisur makinën "Mitsubishi", me targa greke IBY5169, pikërisht në vendin e qajtur

Liqeni i Levanit. Ndërsa disa shërbime janë vënë në ndjekje të autorit, të tjerët i janë afruar mjetit, Brenda të cilit kanë vënë re një sasi të konsiderueshme lëndë narkotike. Pas verifikimeve, kanë rezultuar 344 pako me Cannabis Sativa, e cila pasi është peshuar, ka rezultuar të ketë plot 340 kilogramë. Droga ishte e mbështjellë me natriban dhe sipas policisë, mendohet se do të udhëtonte gjatë natës drejt Gjirokastrës e më pas drejt Greqisë. Ndërsa autori po kërkohet, të paktën deri dje në mbrëmje, kanë nisur hetimet edhe për origjinën e drogës, e cila mendohet se është e kultivuar në zonat e Lumit të Vlorës. **klh**



Itali, arrestohet shqiptari që hodhi acid mbi turmën



Saimir Thekna

Dy vëllezër italian dhe një shqiptar janë arrestuar nga policia italiane, pasi më 22 qershor të vitit të shkuar, hodhën acid mbi turmën e spektatorëve të një koncerti të muzikës jazz. Ngjarja është shënuar në qytetin e Catanias në Itali, ku janë vënë në pranga dy vëllezërit Filipo dhe Francesco

Piazza dhe shqiptari Saimir Thekna, 22 vjeç. Hetimet e uniformave blu të Catanias kanë qenë të shtrira në kohë, ndërsa dëshmitë e shumë personave që u ndodhën atë moment si spektatorë, kanë ndihmuar për zbardhjen e ngjarjes 8 muaj më pas. 30 persona u lënduan nga acidi i hedhur ndërsa ende disa prej tyre

marrin mjekim në spital nga djegiet e marra. Arrestimi i 3 të rinjve nga policia e Catanias është përshëndetur masivisht nga banorët e zones, të cilët prej kohësh jetonin me tmerrin e përditshëm nga ato çaste, ku gjatë një koncerti të muzikës jazz, për pak minuta gjithëka për ta u kthyer në ankth dhe frikë.

DURRES Asnjë gjurmë e autorit të ekzekutimit të Kotares

Vrasja e kambistit 62 vetë në polici

Vëllai dyshime për maskat: S'ishin ordinerë

Lajmi

Plot 62 persona janë shoqëruar nga policia e Durrësit, pas vrasjes dhe grabitjes së kambistit, Fatmir Kotarja, ngjarje e ndodhur në mesditë. Megjithë hetimet intensive, kontrollet dhe postbilloqet, autorët nuk janë zbuluar ende. Ndërkaq, i vëllai ka shprehur dyshime për grabitësit, pasi sipas tij, ishin shumë gjakftohtë.

DURRES

ARTUR KORRIKU


Megjithëse kaluan 48 orë nga ekzekutimi i kambistit në prag të shtëpisë, ende asnjë gjurmë për autorët. Dhjetra persona janë shoqëruar nga Drejtoria e Policisë së Durrësit, kontrollet dhe postbilloqet kanë qenë në punë pa ndërprerje, por dy vrasësit, të cilët i morën edhe 2.5 milionë lekë, ende nuk janë zbuluar.

POLICIA

Policia ka publikuar dje variantin e saj lidhur me ngjarjen e rëndë, sku mbeti i vrarë 47-vjeçari. Sipas komunikatës së policisë, Kotarja, në kohën kur është kthyer nga vendi i tij i punës, lokal i këmbimit valutator, në lagjen Nr.6, në Durrës, para portës së banesës, dy persona të maskuar dhe me armë zjarri automatik, e kanë qelluar dhe me pas i kanë marrë në sedilen e makinës një shumë prej 2.500.000 lekësh. "Nën drejtimin e Prokurorisë veprike hetimore kanë vijuar edhe përgjatë natës, ku në ambientet policore janë shoqëruar e pyetur mbi rrethanat e hetimit 62 persona.

VËLLAI

Në një prononcim për Tv A1 Report dhe Shqiptarja.com, Xhemal Kotarja, vëllai i viktimës, thotë se i ka tërhequr vëmendjen gjakftohtësia, me të cilën grabitësit ishin afruar në mes të ditës dhe kishin qelluar me automatik të shkurtër. "Sa vijnë tek porta, dy persona me armë. Unë do hapja portën për të futur makinën brenda, kur shoh dy persona që vinin me vrap. I thashë vëllait, Fatmirit, bjeru, se ne mbanim çifte, ai e mbante madje në sediljen mbrapa,



Në foto: (Majtas) Vëllai i kambistit të vrarë Xhemal Kotarja (arf) Viktima Fatmir Kotarja

rrinte ke sedilja prapa. Kaq ishte dhe kërcëti. Këtu u bë batërdi duke shtrirë. Edhe Fatmiri shtiu dy herë, me çifte por

e kishin qëlluar më parë dhe s'mundi as të kishte shenjë", ka sqaruar vëllai i viktimës, i cili bashkë me të ishte kthyer

në shtëpi. Por, diçka duket se i ka bërë përshtypje, duke i krijuar dhe dyshime se "tradhëtinë" mund ta kenë brenda,

nga njerëz të njohur apo të mbështetur fuqishëm nga dikush. "Ata ishin shumë gjakftohtë. Nuk donin t'ia dinin nëse ishte ditë apo natë. Mua nuk më bënë gjë, sepse unë isha tek porta dhe isha me duar lart. Dhe ja... Ata ishin të veshur gati njësoj, me maska të zeza e rroba të zeza. Nuk kishte njeri që mund t'i dallonte. Ishin dy trupa të vegjël", kujton Xhemali për momentin e vrasjes. Sipas tij, gjithë ngjarja ndodhi brenda një minute. "Më pas, mora vëllain për ta dërguar në spital, por nuk munda të bëja asgjë për jetën e tij. 25 milionë lekë të vjetra morën. Për kaq lekë të merret jeta. Turp!", thotë Xhemal Kotarja, duke kujtuar dhe tentativën e grabitjes të 12 viteve më parë. I pyetur nëse dyshon se dikush mund t'i kishte ndjekur ai përgjigjet: "Nuk janë hajdutë ordinerë, sepse hajdutë ordiner ka frikë, pasi ne e kishim armën, sepse me armë futeshim e dilnim nga dyqani, por ata sikur ishin me antiplumb."



FOTOLAJM

NE HALL PER PAK BENZINË

Fotografia që shikoni, është shprehur në qytetin e Kukësit, ku si në shumë qytetet të tjera, policia ka probleme me furnizimin e mjeteve me karburant. Duket qartë që makina është në mes të rrugës, e parkuar në dysh, ku dhe e ka lënë karburanti. Në foto duket qartë në polic me uniformë, dhe një tjetër, polic, por ndoshta me gradë më të lartë, pasi është i veshur civil, duke i hedhur makinës karburant me një pagure plastike. Nuk dihet nëse e kanë thithur me tup nga ndonjë serbator i një makine tjetër policie, apo e kanë marrë në ndonjë karburant. Fatkeqësia për policinë, do të ishte, nëse policët e kanë blerë me lekët e tyre karburantin.

LAJME SHKURT

Elbasan, arrestohet hajduti

Një 45-vjeçar është prangosur nga uniformat blu të Elbasanit, pasi dyshohet si personi që ka vjedhur kablo elektrike në disa zona të qytetit. Sipas uniformave blu, me datën 26 janar, u bë arrestimi në fragrancë i Romeu Saliut, 45 vjeçe, banues në lagjen "28 Nëntori". Drejtoria e Policisë, njoftoi me anë të komunikatës zyrtare, se prangosja e Saliut është bërë pasi ka tentuar të vjedhë kabllo elektrike të njërit prej pallateve në lagjen ku ai jetonte.

Vlorë, pranga grabitësve

Dy persona janë arrestuar ditën e djeshme nga policia e Vlorës, ndërkohë që një i tretë është shpallur në kërkim pasi akuzohet për grabitje me armë dhe maska. Sipas njoftimit zyrtar të policies, janë arrestuar Rakip Hoxhaj, 34 vjeç lindur dhe banues në fshatin Hadëraj dhe Lorenc Saliaj, nga fshati Rexhepaq. Arrestimi i këtyre shtetasve u krye, pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe një person tjetër të identifikuar dhe shpallur në kërkim nga policia, të maskuar dhe të armatosur kanë grabitur shtetasin N.I., të cilit i kanë marrë paratë dhe sendet me vlerë që kishte me vete.

Gjirokastrë, kapen 12 klandestinë

Dymbëdhjetë shtetas sirianë dhe marokenë, klandestine, të cilët kishin hyrë nga Greqia, për të kaluar nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së, janë ndaluar nga policia e Gjirokastrës. Sipas policisë, 12 klandestinet, 8 prej tyre shtetas sirianë dhe 4 shtetas marokenë, kishin hyrë ilegjisht në vendin tonë. Klandestinet u ndaluan në aksin rrugor Gjirokastrë-Tepelenë, në afërsi të Ujit të Ftohtë dhe ata janë ndihmuar nga tre persona nga Tepelena, të cilët në këmbim të transportimit në thellësi të vendit tonë, u kishin kërkuar nga 1500 euro.

Durrës, në pranga hajduti

Një 26-vjeçar i kërkuar nga policia është arrestuar dje në Durrës. Sipas uniformave blu, Bojken Lushi, kërkohet nga policia e Beratit, i dyshuar për shumë vjedhje. Sipas akuzave të ngritura, ai dyshohet se ka vjedhur disa banesa në qytetin e tij të origjinës, Berat, disa dyqane dhe pjesë të ndryshme automjetesh.



Ekskluzive

INTERVISTA e studiuesit dhe publicistit për Shqiptarja.com, rrëfen detaje të panjohura e interesante mbi misteret që shoqëruan vrasjen e ish-kryeministrit më jetëgjatë shqiptar

YLLI POLOVINA: Shehun spiun folklorik e përshkroi vetëm Enveri

Studiuesi i pasluftës: Nuk ka asnjë gjasë që ish-kryeministri shqiptar të ketë qenë agent dhe ca më pak poliagjent

ARMAND PLAKA

(Vijon nga numri paraardhës)

Në pjesën e tretë të rrëfimit të tij ekskluziv për Shqiptarja.com, studiuesi Ylli Polovina thellohet edhe më shumë në analizën e tij rreth "misterit" Shehu, dhe ndërthur shumë mendime e dyshime, të pohuara e të papohuara, nga të cilat të bëjnë përshpikje sidomos përfundime si: Enver Hoxhën duhej ta pyesje edhe kur duhej e si të vdisje. Apo edhe si: ...spiun folklorik me radiomarrëdhënese në shtëpi dhe antenë të futur në oxhak, si në filmat për pesë lekë, Shehun e përshkroi vetëm Enveri. Por me një siguri matematikore, Polovina pohon edhe se takimi mes Titos dhe Mehmet Shehut në bordin e transoqeanikut "Queen Elisabeth", në vitin vitin 1960, nuk ka ndodhur kurrë dhe se asgjë nuk e justifikon akuzën e rëndë të përftuar nga "tabloja sinoptike" e Hoxhës në 1982, se ish-kryeministri shqiptar kishte qenë një "poliagjent". Gjithçka e bazon në fakte e dëshmi historike, por edhe në instiktin e tij analitik, si njohës shumë i stërholuar i karaktereve, kohës dhe çështjes për të cilën ka marrë përsipër të flasë. Ndërsa e mbyll me planet e tij të ardhshme letrare e publicistike, një pjesë e të cilave do të njohin shumë shpejt dritën e botimit, pohon më parë mendimin e tij në lidhje me çështjen e Kosovës (demonstratat e 1981), pohimet e ish-ministrit të jashtëm Nesti Nase, atij të Shëndetësisë, Llambi Ziqishti etj, sigurisht në kontekstin e dosjes "Shehu", dhe dekonstrukton me forcë edhe mendime e pohime që janë marrë të mirëqena për realitetin e djeshëm e të sotëm, duke na sjellë edhe detaje rrëqethëse mbi fundin e disa ish-pushtetarëve që i ndërthru me vete dosja "Shehu". Trajtuar në pika të veçanta, ky numër përpiqet të shtjellojë këto çështje:

1. Cila do të ishte Shqipëria "ndryshe" me Mehmet Shehun?
2. A u takua vërtetë me Titon Shehu në në "Queen Elisabeth", në 1960?
3. A kishte gjasa që Shehu të ketë qenë agjent apo poliagjent?
4. Cila ishte domethënia e shprehjes "Po vdes i pafajshëm" në letrën e Shehut për Hoxhën?
5. Cili ishte roli i Shehut dhe Alisë në lidhje me çështjen e Kosovës?
6. Përsa u eliminua Llambi Ziqishti dhe çfarë ishte i detyruar të thoshte Nesti Nase?

-Pra, ju jeni i bindur se me Mehmet Shehun në krye nuk do të kishte kurrë një Shqipëri "ndryshe".
-Që me të në krye do të kishte një Shqipëri "ndryshe" i pari në historinë tonë, pra shumë më herët se gazetaret dhe ekranet e pas vitit 1990 të mbusheshin me rrëfime dhe interpretime



Studiuesi Ylli Polovina

personale se të paktën Shehu ishte njeri i amerikaneve dhe do të bënte siç do ta urdhëronin ata, ka qenë vetë Enver Hoxha. "Tabloja sinoptike" vetëm këtë mision ka pasur, djallëzimin e tij në atë kohë. Për pasojë, kur ai regjim i përmbys, kjo shkaktoi, si në çdo bumerang, efektin e kundërt: engjëllizimin e Mehmet Shehut. Por më lejoni të mos ndalem këtu, jo vetëm se lexuesi di shumë, por edhe sepse unë vetë jam i ngopur me zbrazësinë e kësaj loje dritëshkurtër politike, pra që Shehu ishte njeri i SHBA-së dhe do ta shndërronte Shqipërinë në një demokraci. Siç citova më lart një librin tim të para tri viteve, "Amerika, Mehmet Shehu dhe Ramiz Alia", aty përshkruaj dhe hetoj 42 ditë të kryeministrit, të pabëra kurrë publike, gjatë udhëtimit dhe pjesëmarrjes së tij, në shtator-tetor 1960, në mbledhjen vjetore të OKB-së. Tek "Tabloja...." Hoxha e akuzon se pikërisht gjatë

Pjesë...e rëndësishme e skemës së falsifikuar të "Tablosë..." ishte edhe Fiqirete Shehu. Çfarë nuk tha ajo kundër të shoqit, me gjoja data...vendtakime. ..U helmua dhe vdiq

udhëtimit detar për në Nju Jork, Shehu ishte takuar me Titon në transoqeanikut britanik "Queen Elisabeth". Po ashtu, një i quajtur dokument tepër sekret i CIA-s, i gjetur, sipas versionit zyrtar punist të tetor-nëntorit 1986, në arkivin e ambasadës së SHBA në Buones Ajres, kërkon të provojë një takim agjenturor të tij në Nju Jork me këtë shërbim të fshehtë. Në libër paraqes dokumente arkivore dhe dëshmi të shumta mbi atë se çfarë bëri në kryeqytetin amerikan, përditë e pothuaj orë pas ore, Mehmet Shehu, por nuk mbaj një qëndrim timin. Tani po e them: Shehu jo vetëm nuk ka pasur asnjë kontakt agjenturor në Nju Jork dhe asnjë

jë afrim me Titon në vapor apo gjatë mbledhjes së Kombeve të Bashkuara, por nuk ka asnjë gjasë të jetë agjent dhe ca më pak poliagjent. Politikanët e rëndësishëm nuk kanë nevojë të jenë spiunë. Ata janë tepër të vetëstërvitur që të mos i kenë këto "skelete në dollap". Ata janë njaftueshëm inteligjentë, që pa u kompromentuar, pra pa lënë firma, të bashkëpunojnë për kohshëm me interesa shtetesh të tjera.

Ja pse spiun folklorik me radiomarrëdhënese në shtëpi dhe antenë të futur në oxhak, si në filmat për pesë lekë, e përshkroi vetëm Enveri. Të tillë ai e bëri jo se që njeri i paditur, por për të përbulluar nevojat imediate të efektit të vetëvrasjes së papritur të Mehmet Shehut. Me vetëdhënien e jetës për partinë dhe marksizëm-leninizimin, për të vërtetën e tij, ky e kishte s'fiduar, mospyetur, mosbindur, anashkalluar, shpërfillur. Deri në mbyllje të asaj letre-testament, përherë duke iu drejtuar me "ju", Shehu vendos, si gurë të rëndë, lutjen e tij të fundit: "Amanet familjen time, Fiqiretin, djemtë (përfshi dhe Skënderin dhe Bashkimin), fëmijët e nusës e djemve! Po të shihni se është interesi i Partisë thoni se "Mehmeti vdiq aksidentalisht, duke manipuluar armët!", ose si të doni. Edhe armik po më quajtet, kam besim se asgjë s'mbetet pa u zbuluar nga koha, e vërteta s'vdes kurrë. Po vdes i pafajshëm".

"Po vdes i pafajshëm"? Kujt ia thoshte ai këtë? Enver Hoxhën duhej ta pyesje edhe kur duhej e si të vdisje. Prandaj, i fyer që nuk i mori leje as për të ikur në atë botë, kundërveproi për ta përbalitur. I kishte bërë presion të pandërprerë për tre muaj me radhë dhe e dinte fare mirë që një gjendje e tillë mund të shkaktonte depresion tek ai. Qe akoma i gjallë rasti i Nako Spiros, kur agjentët jugosllavë ia programuan presionin me një dokument antienvierist që ky pati lënë në Beograd dhe i drejtuan, pa i përlery duart drejt-përdrejtë, vetëvrasjen. Njëri prej tyre, madje, prej një dritareje përballë zyrës së Nakos, ndoqi dhe pa edhe vetëstirjen me armë. Pastaj u largua dhe raportoi. Në spital, më pas, ndërsa qenë mundësitë t'ia shpëtomin jetën, jo vetëm telekomanduesit sllavë, por edhe jo pak politikanëve shqiptarë, me në krye Hoxhën, ia deshën interesat që i tejzgjari dhe cmirëmadhi Nako Spiro, të jepte shpirt.

Enver Hoxha, mendoj, ia bëri presionin shtypës Mehmet Shehut, mbase jo për ta shtërnguar të vetëvritej, por që ta ulte përfundimisht kokën e tij kryelartë dhe të hiqte dorë nga pretendimi se gjallë apo vdekur i takonte vendi i pasardhësit. Duket, prej teprisë së presionit, gjendja i doli nga duart. Hoxha, po ashtu, e dinte se që në vitet e para të pasluftës Mehmet Shehu pati shkuar ndërmend dhe tentuar edhe dy vetëvrasje të tjera. Si është e mundur, vërtet, që në mbrëmjen e vonë të 17 dhjetorit, megjithëse autokritika e fundit e kryeministrit



Në foto: Mehmet Shehu dhe Enver Hoxha në vitin 1966

që plot 39 faqe dhe me praninë të plotë të fajit politik, ia quajti atë "alibi"? Kjo fjalë nënkuptonte më e pakta se gjithçka Shehu e kishte bërë qëllimisht për të krijuar një vijë politike paralele, çfarë do të thoshte dënim me vdekje. Këtë mesazh mori, vërtet, kryeministri atë natë? Kjo iu dha posaçësisht, siç të qe, për të vendosur si të vepronte, dhënia e një ampule helmi apo doreze pistolette? Në letërën e tij Shehu përgjegjësinë e vetëvrasjes ia lë shefit të tij ("Unë po lë jetën për Partinë pa hezitim dhe gjakftohtësi, se s' më latë rrugë tjetër për të mbrojtur Partinë").

-A kanë mbetur elementë dyshimi për të cilat ia vlen akoma të diskutojmë, se



Demonstratat në Kosovë, pranverë 1981

Mehmet Shehu u vra edhe për këmbënguljen tij për të çliruar Kosovën, siç lakohe sot këndej e matanë kufirit?

-Prej disa vitesh kam mbledhur materialin e njaftueshëm, ku përpiqem ta provoj këtë, por radha e shkrimit të këtij libri ende nuk ka ardhur. Pa e zbuluar lëndën, ju deklaroj se Shehu u shty në vetëvrasje edhe për çështjen e Kosovës. Ju kujtoj se për demonstratat e Kosovës të marsit 1981, është prononcuar disa herë edhe dëshmitarja e vetme ekstra që ka mbetur, Nexhmije Hoxha. Po të dëshmonte

HOXHA, ia bëri presionin...Shehut, mbase jo për ta shtrënguar të vetëvritej, por që ta ulte përfundimisht kokën...dhe të hiqte dorë nga pretendimi se ...i takonte vendi i pasardhësit

HAZBIU nuk u likuidua fizikisht thjesht se duhej zhdukur si ngatërrestar i nesërm në punët e trashëgimit të pushtetit, por sepse ..dinte përmasat e mashtrimit të "Tablosë..."

POLOVINA

Mehmeti u shty në vetëvrasje edhe për çështjen e Kosovës

thjesht më pas. E siguroj lexuesin se Mehmet Shehu "ka dorë" edhe më parë. Si dhe pse, nuk po shkoi më tej, por po kthehemi tek akuzat për këtë çështje që u montua në mungesë, në gjyqin kundër Kadri Hazbiut. Qe ish-ministri i Jashtëm Nesti Nase, i burgosur tashmë, që ia bëri. Ai shqiptoi para trupës gjyqësore: "Në vitin 1981, kur ndodhën ngjarjet tragjike në Kosovë, kur tanket dhe forcat serbomadhe ushtarake, me topa e avionë, shtypën, gjakosën, vranë e prenë vëllezërit tanë në Kosovë, Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu e Feçor Shehu, përpiqeshin me këtë mënyrë, që jo vetëm ta pengonin këtë lëvizje, këtë revoltë të gjithë popullit të Kosovës, por donnin që nëpërmjet formave të ndryshme, të arrinin të ndryshonin edhe ngjarjen në Shqipëri, gjë që pikërisht, është dhe qëllimi final i organizatës kundërrivolucionare. Pra, marrja e udhëheqjes, rrezimi i pushtetit dhe ndërimi i kursit të politikës në vendin tonë". Po ashtu Nase, nën pranga, tha: "Në vitin 1981, në qershor, më thërret Mehmet Shehu në zyrë. Vajta për disa çështje që kishin të bënin me disa ndryshime që do të bëheshin në ambasadorët tanë jashtë vendit. Se, sipas rregullit, duhej të merrej edhe mendimi im. I them: 'Kemi ndërmend që të bëjmë këto ndryshime...! Jo, ndryshime tani nuk do të bëjmë, ndryshime të mëdha do të bëjmë pas kongresit thotë - dhe ti e shikon, thotë, që gjendja tek ne është bërë e padurueshme me qëndrimin që po mban Sekretari i Parë (Enver Hoxha) lidhur me ngjarjet në Kosovë. Më pas vazhdoi: Është vënë në rrezik ekzistenca e Shqipërisë, prandaj duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që të ndryshojë kjo gjendje. Dhe filloi të më shpjegojë, domethënë, si të thuash, për gjendjen që ishte krijuar dhe problemet që kishin dalë dhe si bëhej e domosdoshme, që me hir ose me pahir, kjo gjendje duhet të ndryshojë. Këtë Mehmeti ma tha në qershor të vitit 1981, duke më theksuar në mënyrë të veçantë, që, "për këto probleme që po flas me ty tani, kam biseduar gjërë e gjatë me Kadri Hazbiun dhe Feçor Shehun".

Ja pse spiun folklorik me radiomarrëdhënës në shtëpi dhe antenë të futur në oxhak, si në filmat për pesë lekë, e përshkroi vetëm Enver Hoxha

gjithçka di dhe pa fshehur gjë, do të që një kontribut. Mirëpo së fundi ajo shprehu habinë për disa gjëra që po dëgjonte dhe nuk i kishte ditur më parë. Bëhet fjalë për një rol të qartë të Tiranës në përgatitjen e asaj gjendjeje që u manifestua me demonstratat e marsit. Në materialin që kam mbledhur, Mehmet Shehu (bashkë me Kadri Hazbiun), kanë protagonizim të dukshëm. Mirëpo, njëllor si zozja Hoxha, edhe Ramiz Alia në librin e tij "Jeta ime" nuk e pranon këtë ndikim apo, po e quajmë "organizim nga brenda". Fillimisht të bëjnë përshtypje se në 510 faqe të librit, kësaj ngjarje tepër të rëndësishme në historinë e shqiptarëve, Alia i kushton vetëm më pak se dy të tilla. Sidoqoftë, pohon se "Udhëheqja shqiptare i vlerësoi së tepërmi demonstratat kosovare dhe i trajtoi me shumë kujdes e përgjegjësi zhvillimet dhe pasojat eventuale që mund të shfaqeshin më tej...Kishte mundësi që autoritetet serbe, të fillonin ndonjë aksion hakmarrës kundër kosovarëve, një terrorizëm shtetëror kundër shqiptarëve. Por gjithashtu, kishte mundësi që ky terror të shndërrohej edhe në një sulm të organizuar kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Të dyja këto mundësi, udhëheqja e Partisë i diskutoi dhe, për të dyja rastet, mori masat përkatëse duke vënë në lëvizje forcat e armatosura. Sepse vendi ynë nuk do të qëndronte indiferent nëse në Kosovë plaste terrori serb dhe kosovarët do të rrëmbenin armët për t'u mbrojtur, ashtu siç do të ishte kurdoherë i gatshëm, për të ruajtur me vendosmëri përkrahshërinë e kufijve të atdheut tonë".

Siç e shihni, Ramiz Alia deklaroi për një rol shqiptar për të mos u përzierë më parë, por

Nesti Nase ka gënjyer nën shtrëngim. Një të njohuri të tij, kur doli nga burgu, i pati thënë se nën pranga nuk mund të që hero. Në Ministrinë e Jashtëm e mbajnë akoma mend si burrë të qytetëruar, korçar fin, por edhe diplomat të saktë. Ndërkohë, po të shohësh arkivin e këtij institucioni, kupton se ai që edhe shumë i dhënë pas Partisë së Punës, ndonjëherë duke anashkaluar raportin me profesionin. Sigurisht, atë kohë Nase e donte Enver Hoxhën dhe u arrestua vetëm për ta dhunuar që ta akuzonte Mehmet Shehun se kishte sabotuar përpjekjet e PPSH-së për të shpëtuar nga zgjedha shqiptarë e Kosovës. Është një përdorim i pacipë i çështjes kombëtare. Informojmë lexuesin se pasi e hoqën, nën sulm kritikash, nga detyra e Ministrisë të Jashtëm, e mbajtën pak kohë aty, në Institutin e Studimeve Ndërkombëtare. Pinte cigare pa

Hazbiu

Mund ta dini se edhe Kadri Hazbiun...jo vetëm e torturuan egërsisht, por kur e vranë, oficeri i lartë që e qëlloi në zverk, pa se arma e tij i hapi një gropë të madhe sikur ta kish qëlluar me antitank



Kadri Hazbiu gjatë sencevave gjyqësore në gusht 1983

fund në zyrën e vet në katin e parë dhe priste ta arrestonin. Tufa e pranguesve erdhi një mëngjes, u thanë të gjithë diplomatëve të atij kati të futeshin nëpër zyra e të mos dilnin, i hodhën batanjinë në kokë dhe e futën në "Gaz". Nuk kishte fëmijë. E shoqja, prej tronditjes, fillimisht u përpoq të vetëdijëje. Kur nuk ia doli me këtë mënyrë, u vetëvar në dhomë. Pas viteve të gjata të burgut, Nesti Nase jetoi tek një nip i tij, sepse edhe shpëtinë e jo më veshjet e trupit, ia kishin marrë.

Kështu romaneskja "Tabloja sinoptike" kushtoi shumë jetë. Ishte masakra më e madhe e dekadës së purgës enveriane.

-Në të vërtetë, sipas jush, cilat qenë arsyet e këtij "spastrimi" të pamëshirshëm mes të vetëve?

-Pushteti personal, asnjë arsye tjetër. Kjo pyetje është bërë vazhdimisht edhe për të njëllojtin veprim nga Stalini. Purga e madhe shqiptare me vrasje fizike nuk ndodhi kur ngjau e ashtuquajturë Plenumi i Katërt, dënimi i "shfaqjeve borgjezo-revizioniste" në fushën e kulturës, pranverë 1973, por pas dhjetorit të atij viti, kur Enver Hoxhës i ra infarkti pas kësaj e kreu për të shfarosur të gjithë emrat e grupet e mundshme, që në një rast tjetër të ngjashëm, do ta bënin të pafuqishëm dhe rrëzonin, në mos edhe ta vrisnin. I zhdukur më

pëpara. Duhet thënë se në këtë kasaphanë ishte tepër metodik dhe gjithçka e kreu në kohën e duhur.

-Mihallaq Çiçishti, më premtuat të jepni një mendim.

-Do të vritej patjetër edhe ai, jo thjesht se pati shqiptuar në morg, kur pa kufomën e Mehmet Shehut, se e kishin vranë. Ai u likuidua jo për këtë, por sepse në gjyqin kundër Kadri Hazbiut formuloi akuzat (gënjeshtat) kryesore për të "provuar" se ky ishte spiun jugosllav dhe sovjetik, si edhe krahu i djathtë i "poliagjentit" Mehmet Shehu. Tregoi dhe "ngjarje" konkrete, si të thuash paraqiti "dokumente". Ato ia kishin imponuar. Që të mos e tregonte më pas të vërtetën, e shfarosën. Pjesë tepër e rëndësishme e skemës së falsifikuar të "Tablosë..." ishte edhe Fiqirete Shehu. Çfarë nuk tha ajo kundër të shoqit, me gjoja data, persona, vendtakime. Në burg u helmua dhe vdiq. Llambi Peçini, njeriu i parë i sigurisë së Mehmet Shehut gjatë udhëtimit të tij me "Queen Elisabeth", ku ky gjoja u takua me Titon, u vra po ashtu. Mund ta dini se edhe Kadri Hazbiu nuk u likuidua fizikisht thjesht se duhej zhdukur si ngatërrestar i nesërm në punët e trashëgimit të pushtetit, por sepse më shumë se të gjithë dinte përmasat e mashtrimit të "Tablosë...". Atë, jo vetëm e torturuan egërsisht, por kur e vranë, oficeri i lartë që e qëlloi në zverk, pa se arma e tij i hapi një gropë të madhe sikur ta kish qëlluar me antitank.

-Pas kaq vitesh reflektime të shprehura në shumë libra e dëshmi të shkruara nga ju në formën e frymëzimeve letrare, të shtyra nga realitetet historike të jetuara aktivisht, cilat janë planet tuaja të afërta e ato të mesme në këtë aspekt?

-Krijimtaria ime modeste në fushën e kronikës, të rrëfimit dhe analizës, është prirë gjithnjë nga pasqyrimi i ngjarjeve më kryesore të historisë shqiptare. Tashmë kjo përpjekje ka marrë një formë dhe mozaiku i thurur vetëm po plotësohet dhe mbushet. Deri tani janë 21 libra. Nga pas nëntëdhjeta janë librat "Skafistët në top sekret", "Nano dhe Berisha", "Mig 19'97", "Kush e vrau Adem Hajdarin", "Ditari i Romës" e disa të tjerë. Për luftën çlirimtare në Kosovë në italisht kam publikuar "Homo balcanicus" si edhe në shqip "Një kolonel midis Tiranës dhe Prishtinës" dhe "Lamtumirë kallashnikov". Këtë prill do të botoj "7 prilli i Ahmet Zogut" dhe në vjeshtë një libër për të qajturin Revolucionin e Qershorit, pra edhe figurën tjetër politike të spikatur të kësaj kohe, Fan Nolin. Edhe në këto dy raste të fundit, jam kujdesur të kem interpretime dhe dokumente krejt të reja, rrefim artistik si edhe thurje subjektive të rraja.

Purga e madhe shqiptare me vrasje fizike nuk ndodhi kur ngjau në... pranverë 1973, por pas dhjetorit të atij viti, kur Enver Hoxhës i ra infarkti



Koment

“Referendumi” i dytë pa kundërshtarë



NGA PREÇ ZOGAJ

vijon nga faqja 1

... kartë për ta detyruar qeverinë të respektojte ligjin dhe vullnetin e zgjedhësve në qarkun e Fierit: kartën e statusit. Qeveria, nga ana e saj, e ka parë çështjen e Fierit si mundësi belli të opozitës për të mos i cundësuar asaj një bonus europian në prag të zgjedhjeve politike, siç mund të ishte statusi i vendit kandidat në BE. Rebusi i krijuar është realisht i madh, plot pikpyetje dhe kundërpikpyetje çarmatosese, që flasin për rënien në mjergullim dhe meskinitet të politikës që bëhet në Tiranë. Në fakt nuk shoh asnjë mundësi që përgjigja për këtë lloj rebusi të mund të merret nga një referendum. Për arsyt e thjeshtë se nuk mund të shtrohet; tre ligjet nuk kanë kundërshtarë, siç nuk kishte heqja e imunitetit, për të cilin Berisha pat hedhur vitin e kaluar idenë e mbajtjes së një referendumi.

Por rebusi në fjalë mund të shtrohet në zgjedhje, si çështje politike, domethënë, kush e ka përgjegjësinë për mosmarrjen për të tretin vit radhazi nga Shqipëria të statusit të vendit kandidat në BE. Kam përshtypjen se kryeministri e ka hedhur idenë e referendumi për tre ligjet pikërisht për të sjellë në vëmendjen e demokratëve dhe publikut një çështje politike prej së cilës do të tentojtë të përfitojë elektoralisht. Pra e ka hedhur për tani dhe jo për më vonë. E ka hedhur për të rreshtuar zgjedhësit e 23 qershorit. Bashkë me Ilir Metën, që po flet shpesh për tre ligjet, Berisha ka parë në këtë pikë një mundësi reale për ta vënë në vëshitësi opozitën, duke e akuzuar si shkaktoreshë e refuzimit të statusit nga Brukseli dhe si të detyruar (për të përdorur një shprehje shumë të butë) në orjentimin e saj europianist. Natyrisht, ka patur e ka gjithnjë plot kundërtënie në retorikën europianiste të kryeministrit. Fjala vjen, nëse ka siguri dhe bindje se marrja e statusit varet nga votimi i tre ligjeve, pse nuk lëshon qeveria në Fier, aq me tepër kur dihet se zgjedhjet në atë qark i ka fituar opozita? Si mund të sakrifkohet një gjë aq e madhe si statusi për ambicet e vogla të disa militantëve vendorë, që kanë bërë allshverishe me votat e zgjedhësve? Argumentat dhe kundërgargumentet për këtë çështje janë të tashmë njohura, pasi janë shkëmbyer e përplasar disa herë në media dhe në foltoret e shumta të politikës. Aktualisht, ndërsa jami para faktit të kryer se statusi na është refuzuar edhe për shkak të mosvotimit të tre ligjeve dhe Brukseli ka qenë në përgjithësi e vazhdimësi në lidhje me arsyet e plota të refuzimit, argumentet e opozitës për këtë çështje po e humbin forcën që kishin. Qeveria ka parë këtu një korridor sulmi kundër saj.

Është ironike dhe e trishtueshme padyshim të shohësh të akuzohet si shkaktoreshë e bllokimit të statusit një opozitë që ka qenë protagoniste e procesit të integritimit, sidomos nga vjeshta e vitit 2011 deri në vjeshtën e vitit 2012. Kjo opozitë ka ecur me parimin se për integrimin duhet të silllemi si qeveri dhe kjo është një qasje e drejtë në të gjitha pikpamjet. Opozita duhet të ruajë këtë linjë. Një koalicion partish që kërkon dhe premtion vendosjen e shtetit ligjor e ka në favor çdo lajm të mirë nga fronti i integritimit. Por gjithë ky investim rrezikon të hajë goditje ngjitesë nëse nënvlerohet politika agresive e krejeve të shumicës për ta bërë opozitën kokë turku për dështimin e statusit. Peticioni i punojësve buxhetorë, si formë e vjetër e stilit enverist, është në thelb pjesë e kësaj politike. A mos mendon kush se me këtë peticion shumica

kërkon t'i mbushë mendjen Ramës të votojë ligjet? Po të ishte kështu, do të kishin gjetur një formë tjetër dhe do të kishin shkruar me një gjuhë tjetër. Qëllimi i ideatorëve dhe realizuesve të peticionit është parasëgjitsh të nervozojnë dhe neverisin opozitën. Që kjo të mos i votojë ligjet dhe qeveria të mund të përfitojë elektoralisht nga kjo gjë, duke e ditur se publiku shqiptar, e dhe pse i mbërthyer nga njëmijë halle, vazhdon të jetë shumë i ndjeshëm për Europën. Jo thjesht për këtë shkak, por parasëgjitsh në emër të vizionit europianist, opozita, tani që u pa se kushti taktik nuk funksionoi dhe as Fieri nuk po zgjidhet dhe as statusi nuk po merret, duhet ta rishikojë ndërvartësinë e tre ligjeve nga zgjidhja e ngërcit të Fierit. Pra ta bëjë nul edhe referendumin e dytë pa kundërshtarë të kryeministrit.



Mbledhje e Grupit të PD-ë

Fejtoni

Weekend mes ankthit e peshës së karrikes së deputetit



NGA BARDHYL BERBERI

vijon nga faqja 5

...ta prishi qeverinë para zgjedhjeve dhe do të bëhet qeveri teknike. Po të duash, të them dhe se ku është bërë marrëveshja. -Ku?- Kuriozohet tjetri. -Në Tetovë kur vdiq i ndjeri Ar-

bën Xhaferi. Qëndruan kokë më kokë mbi tre orë vetëm për vetëm Edi Rama me Ilir Metën. -Ti ha miza me të lartët,- i kthehet një tjetër i majtë që gjendet me familjen në Tushemisht. -Pusho, - i hakërrehet e shoqja. Na e helmova krejt fundjavën, erdhëm të shplohdim kokën. - Të thashë, vazhdon bisedën tjetri. - Ilir Meta do të jetë vendimtar në këto zgjedhje ai do të jetë si ajo tupa që i vihet shishes sipër, jo si ai i yni që mbledh ata të vegjlit që kanë një furgon me elektorat. Është i zgjuar ai, është lojtar i fortë.

listën e deputetëve dhe më pas vjen pyetja tjetër se çfarë numuri rendor do të kenë në listë. Ndonëse qëndrojnë me pushime pak metra më poshtë rezidencës së Enver Hoxhës, gjoja të braktisin rutinën rraskapitëse të jetës aktive dhe të fushatës tepër të lodhshme që ka filluar herët, ata luftojnë për listën. - Urime,- i thotë njëri-tjetrit. Je i treti në listën e qarkut të Korçës. - Kush ta tha? Pyet kandidati. - Ja prit pak ditë do ta marrish vesh zyrtarisht. Edhe pse ata kanë ndryshuar peizazhin e të ushqyerit me tava korani, mish kaprolli dhe lepuj të egër dhe gjumin e bëjnë pa zile, ata kanë ngehur "robër" të emocioneve dhe të pasioneve për karrige. Ata duken të corientuar, pasionantë, të tendosur, të

mbërthyer nga emocione të forta që nuk mund ti zotërojnë. Ata ndihen të zbrazët dhe gjithë ankth. Kur dikush ju telefonon nga Tirana, ata herë qeshen dhe herë ngrysen në fytyrë, sikur iu është hapur ndonjë hummerë. Për "Ata" nuk ka prekje dhe pushime këto ditë kur janë të mbërthyer nën peshën e karrikes dhe listës së deputetëve. Para asaj, nuk ka vlerë asgjë. Dhe të kesh një karrike të rëndësishme nuk është pak se të tjerat vijnë pas saj. Dielli është në të perënduar sipër maleve të Mokrës dhe një breg i tërë i liqenit prushitet prej zjarrit të tij në perëndim që ngjitet lart, deri sa djeg me flakë majën e Malit të Thatë dhe ndonjë person tjetër vip që prentendon të jetë në listën e deputetëve...me numër rendor sa më të afërt.

Blog / Live from life

Liri për një të majtë në robëri!



NGA ANJEZA SHATKU

Të bësh pyetje, të ngresh pyetje, apo të kesh pyetje? Të alternativa për të pangopurit me fjalë, si unë: nuk më mjaftojnë dështimet e qarta, gafat e sakta, lapsuset e përkryera, paragrafet e shqy-

era, tonet erotiko-politiko-kërcënuese, ngritje-ujlet e vetullasve, kërcitjet sklavëruese të deklafushatave. Asgjë nuk mund të të mjaftojë, nëse ti kërkon nga vetja më shumë se c'mund të kërkosh nga ai që ngrihet në një tribunë, apo ulet në një karrige. Të krahasosh një grusht politikaneësh me një grusht tjetër të të njëjtit trup, kjo është, jo vetëm e pak-uptimtë për vlerën krahasuese në vetvete, por edhe sfilitesë, pasi këtu më shumë flitet për asimetrinë, sesa për ndryshim të mirëfilltë. Njëra dorë lan tjetrën? Apo njëra dorë fshin tjetrën? Po, sikur njëra dorë të fshihë tjetrën?

Po sikur ta ndihmojë tjetrën dhe të dyja së bashku të fërkohej e të dashurohej, në dëm të trupit? Ka tupa që përdorin më shumë dorën e majtë, më saktë janë shtuar këto kohët e fundit. Shumica e trupave të tjerë përdorin të djathtën dorë, se ashtu ka qenë, është dhe nuk i dihet, a do të jetë më vonë! Trupat me dorë të majtë, që për lehtësi po i thërras të majtë, janë më të paktë; të djathtët (trupat, ë!) janë të shumtë, shumë të shumtë, të sh(k)umëzuar fare! Pa dallim moshe, krahine, seksi, këta të fundit e pranorin pa justifikim, që të përdorje të djathtën ishte gjëja më e dobishme, më e sigurt, më e rregullt, më korrekte që

duhej bërë. Unë nuk kuptoja trembjen time dhe gërlitjen e tyre! Nuk kuptoja as sytë mizorë të mësuesve kur dikush përdorte të majtën. Pa shpjegime, pa më të voglin shpjegim kemi jetuar ne, brezi i viteve '80, vit kur Shqipëria hynte në rekordet ekonomike botërore për rritjen me 1%. Ne hodhëm shtat, Shqipëria gjithashtu! Të majtë ca më shumë u lumturuan, dolën nga "mos"-et dhe "keq"-et! Të djathtët vazhduan të korrin sukseset e të qenit "normal". Shqip-Mendja vazhdon të pyesë për dallimet me tyre: "Kujt t'i thërras për ndihmë, të majtës, apo të djathtës? Ah, sikur t'u thërrisja këmbëve!"

Shfaqja

■ ■ ■ TIRANE

DHURATA HAMZAI

Suksesi i tenorit shqiptar Saimir Pirgu në 2009-n në Zyrih me rolin e Dukës së Mantovës në operën "Rigoletto", ende nuk është harruar. Saimir Pirgu në atë kohë këndoi në krah të baritonit më të madh të epokës Leo Nuçi. Sh-typi zviceran shkroi një pas një artikuj me gjërma të mëdha për zërin e rrallë të tenorit shqiptar. Me sa duket, sukseset e njëpasnjëshme të Saimir Pirgut në shumë skena botërore i kanë nxitur drejtuesit e operës së Zyrihut që të kontratojnë me të dhe tashmë ai do të jetë protagonist për shtatë ditë shfaqjeje rresht në skenë duke kënduar për rolin kryesor, Duka e Mantovës. Premiera e operës së njohur "Rigoletto" e Verdit, sipas kalendarit të shfaqjeve do të ngjitet në skenë më 3 shkurt në Shtëpinë e Operës në Zyrih dhe theksohet që së bashku me emra të njohur të muzikës që përbëjnë trupën e kësaj opere "do të ngjitet në skenë edhe tenori i madh shqiptar Saimir Pirgu". Roli i Dukës së Mantovës do të shfaqet i plotë për herë të parë për publikun zviceran nga tenori shqiptar, dhe kjo do të jetë një nga sfidat e radhës për të, ndërsa dihet që opera "Rigoletto" konsiderohet ndër më të njohurat dhe njëherësh më të vështirat në literaturën muzikore botërore nga kritika e muzikës. Premiera e operës së njohur të mjeshtrit Giuseppe Verdi do të jepet më tre shkurt në Shtëpinë e Operës në Zyrih të Zvicrës. Opera "Rigoletto" e Verdit konsiderohet ndër më të njohurat dhe njëherësh më të vështirat në literaturën muzikore botërore. Saimir Pirgu me këtë fitesë premiere në operën e Zyrihut shprehet se shfaqja lidhet me një ngjarje të veçantë. "Ndihehem shumë i nderuar, sepse shfaqja ka të bëjë me një ngjarje të veçantë në botën e madhe të muzikës. Këtë vit e gjithë bota po po feston 200-vjetorin e lindjes së kompozitorit të madh italian Verdit", shprehet tenori shqiptar para shfaqjes. Në operën "Rigoletto" të realizuar në



Pirgu

Ndihehem shumë i nderuar, sepse shfaqja ka të bëjë me një ngjarje të veçantë në botën e madhe të muzikës. Këtë vit e gjithë bota po po feston 200-vjetorin e lindjes së kompozitorit të madh italian Verdit", shprehet tenori shqiptar para shfaqjes.

Në foto: Tenori Saimir Pirgu gjatë provave në Opernhaus Zürich

Saimir Pirgu shtatë ditë me "Rigoletto" në Zyrih

Tenori i famshëm luan rolin kryesor të Dukës së Mantovës

"Opernhaus" të Zyrihut krahas Pirgut do të interpretojnë edhe emra të njohur të botës operistike si Aleksandra Kurzak, që interpreton rolin e Xhildës, Rigoletton e luan Quinn Kelsey, ndërsa trupën e kësaj opere do të ketë edhe gjashtë ringjite të tjera në skenë, të gjitha brenda muajit shkurt. Saimir Pirgu njihet si një nga zërat më brilantë të operës botërore, i cili deri më sot ka luajtur në një numër të madh të veprave klasike dhe këmba e tij ka shkelur në shumicën e teatrove më të njohura të operës në botë. Pirgu pas çdo premier ka marrë vlerësime të larta, ndërsa të gjitha interpretimet e tij janë bërë në skenat më prestigjioze të botës operistike si në atë të Vjenës, Madridit, Strasburgut, Zyrihut, Londrës, Bilbao, Munihut, Berlinit, e të tjera. Para publikut të Zvicrës, përveç shfaqjeve që jep në Shtëpitë e Operës në Zyrih e në

Lozanë, Saimir Pirgu është paraqitur edhe me dy shfaqje të tjera jokonvencionale të operës, në të cilat ai ka pasur si gjithmonë rolet kryesore. Ai ka pasur rolin kryesor në operën "Bohème" të realizuar në ambientin e ndërtesave të vjetra të një lagje banimi të Bernës dhe "La Traviata", në Stacionin Hekunduror të Zyrihut.

SUKSESAT E SAIMIR PIRGUT NE SKENAT BOTËRORE

Saimir Pirgu është lindur në

Elbasan në vitin 1981, derisa fillimisht do të mësonte për violinë. Tek më vonë ai u zbulua si talent i rrallë i këngëtarit lirik. Kështu, ai do të mbarojë studimet për kanto në konservatorin e Tiranës dhe në atë të Bolzanos, Itali, ku zëri i tij pati një pjekje të parakohshme duke thyer statusin e moshës. Ndërsa një këngëtar operash ngjitet në role të mëdha vetëm pas moshës 25 vjeçare, Saimir Pirgu në moshën 23 vjeçare ishte protagonist i roleve të mëdha në skenat botërore. Po

në moshë të re, tenori i njohur shqiptar Saimir Pirgu fitoi disa nga çmimet më të rëndësishme që jepen në botën e operës. Ai ka fituar vendin e parë në konkursin "Caruso" dhe në atë "Tito Scipa" në vitin 2002, Medalja Eberhard-Vveçter për rolin e Memorinos me operën "Elixir d'amour" të Donizettit në Operën Shtetërore të Vjenës. Ai është çmuar lart edhe nga mentorët e tij, tashmë i ndjeri Luciano Pavarotti. I lindur në Elbasan në vitin 1981, Pirgu fillimisht do të mësonte

për violinë. Vetëm pastaj te ai u zbulua talenti i rrallë i këngëtarit lirik. Kështu, ai do të mbarojë studimet për kanto në konservatorin e Tiranës dhe në atë të Bolzanos, Itali. Deri më sot Pirgu ka luajtur në një numër të madh të veprave klasike të operës botërore dhe ka shkelur në shumicën e teatrove më të njohura të operës në botë, duke merituar vlerësimin më të lartë të skenave prestigjioze si Vjena, Madridi, Strasburgu, Cyrihu, Londra, Bilbao, Munihi, Berlini etj.

'Rigoletto' jepet më 3 shkurt 2013.
Fillon në orën 19.00. Ajo zgjat, përfshirë pauzat, 2 orë e 45 minuta. Pas premierës do të ringjitet në skenë edhe në datat 5, 8, 10 13, 17, 26 shkurt etj.

Ekspozita

Agim Sulaj në Oxford me imazhe të fëmijërisë dhe plagë sociale

■ ■ ■ TIRANE

Piktori shqiptar Agim Sulaj çel ekspozi-tën e tij të radhës në "North Eall Arts Centre" të Oxford-it. Ekspozi-ta do të çelot në datën 5 shkurt e do të presë vizitorë deri në 1 mars. "Në peizazhet e tij, piktori shpreh nostalgjinë për bukurinë e natyrës, gjatë fëmijërisë së tij, ndërsa karikaturat e tij përshkruajnë probleme të mëdha sociale dhe politike të shekullit të 21-të, të tilla si varfëria në botë, ndotja e mjedisit dhe migracioni", thuhet në njoftimin e North Wall Arts Centre.

Agim Sulaj ka fituar çmime prestigjioze rreth globit dhe ka ekspozuar krijimet e tij, së bashku me artistë të njohur, të tilla si De Chirico, Balthus, Nerdrum, Sandorfi dhe David Hockney. Ai aktualisht jeton në Rimini, Itali, me gruan dhe dy fëmijë, dhe punon si një artist ilustrator dhe karikatunist.



Sulaj trajton temat shoqërore, vazhdon të kritikojë dukuritë, jo mbartësit. Në vite ka ekspozuar dhe është vlerësuar jo vetëm në të katër

anët e Italisë, por edhe në Greqi, Amerikë, Turqi, Belgjikë, Francë, Azerbajxhan, Kinë, Iran, Hungari, Poloni, Bullgari, Luksemburg.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Uzina Godževo dhe Bullonave Kavaje
NJOFTIM

Njoftohen aksioneret e U G B sht Kavajë se me datë 18 shkurt, ora 15:00 diçën e hënë bëhet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme me këtë rëndësi:

- 1- Zmadhimi i kapitalit me emetime të aksioneve të reja
- 2- Të tjera

Mbledhja zhvillohet në selinë e shoqërisë "Lagaja", nr. 4, pranë stacionit të trenit, Kavajë

U G B



Disiplina

Seria A, rrebesh dënimesh për Juventusin

ROME

Ekipi i Juventusit është dënuar nga Disiplina për sjelljet në fund të ndeshjes me ekipin e Genoas për një 11-metërsh të mohuar në minutën e fundit të ndeshjes. Trajneri i ekipit Antonion Conte është dënua me dy javë pezullim për thir-

rjet e tij ndaj arbitrit napoletan. "Të të vijë turp" me këto fjalë ju drejtua Conte arbitrit në fund të ndeshjes. Mbrojtësi Bonucci u dënua me dy javë, Vućinic me një javë dhe Kiellini dy javë pasi u fut në fushë pa autorizimin e drejtuesit të garës duke zbritur nga tribuna. Drejtori teknik Beppe Marotta është dënua me qëndrimin larg stadiumeve të Serisë

A deri në datën 18 shkurt, ndërsa klubi është gjorbatur me 50 mijë euro. Para vendimit trajneri i ekipit të Juventusit Conte u tërhoq duke bërë një hap pas nga deklaratat. "Arbitrat janë një skuadër ashtu si ne dhe punojnë nën presion. Mund t'u falen edhe gabimet por e rëndësishme është që të punojnë me seriozitet gjatë punës së tyre duke mos u ndikuar. Jam dako-

rd me deklaratat e kreut të Shoqatës së Arbitrave, Marcello Nicchi që i konsideron arbitrat italianë si më të mirë, por kur nuk fitoj, asnjëherë nuk e bëj gjumin të qetë sepse edhe barazimin e konsideroj si një gjysmë humbje" shprehet trajneri i Juventusit Antonio Conte. Por vendimi ishte më i rëndë nga se e priste në të vërtetë.

De Biasi këshilloi portierin te veronezët

Samir Ujkani firmos me ekipin e Kievos

Transferimi në formë huazimi

VERONA

DYLBER BALLA

Destinationsi i portierit të kombëtares shqiptare të futbollit do të jetë ekipi i Kievos. Marrëveshja mes dy palëve është arritur dhe gjatë ditës së sotme pritet që të bëhet edhe prezantimi i gardianit me fanellën e veronazëve. Ujkani është transferuar në formë huazimi deri në fund të edicionit.

vari me pasaportë shqiptare nuk pranoi ofertat, pasi nuk pranonte të ishte rezervë, port ë luante në formacionin e parë. Mundësi të cilën askush tjetër në Serinë A nuk mund t'ja ofronte përveç ekipit të Kievos. Drejtuesit e dy ekipeve kanë rënë dakord që Ujkani të transferohet në formë huazimi deri në fund të edicionit më të

drejtë blerje të gjysmës së kartonit. Largimi i gardianit nga ekipi i Palermos erdhi për shkak të formës së dobët që tregoi në pjesën e parë të edicionit duke lënë një përshtypje jo të mirë, pasi në disa ndeshje ka pësuar gola aksidentale që i kanë kushtuar disa pikë Palermos. Por duhet thënë edhe ana tjetër e medaljes që Ujkani



Portieri Samir Ujkani

ka realizuar edhe ndeshje të mirë, megjithatë portieri është ai që kryqëzohet sa herë që pësohen golat. Palermo, pavarësisht se nëpërmjet presidentit dhe trajnerit konfirmuan disa herë se kosovari nuk do të largohet se ka besimin e stafit drejtues e prënë në besë duke afruar Sorrentinon. Një lëvizje e tillë i mbylli derën trajnerit

të përfaqësueses kuqezi që të qëndronte duke pranuar largimin. Një ndikim të madh në zgjedhjen e Kievos nga ana e Ujkani ka bërë edhe trajneri i ekipit kombëtar De Biasi, i cili e ka këshilluar që të mos zgjedhë ekipet e mëdha dhe të qëndrojë në stol, pasi kështu do të humbiste edhe vendin në kombëtare.

LAJME SHKURT

Droga te Gallatasaray

Destinationsi i sulmuesit Didier Droga nuk do të jetë as Milani dhe as Juventus, por ekipi turk i Gallatasaraty. Marrëveshja mes dy ekipeve është arritur sipas shtypit turk dhe pritet që të zyrtarizohet në orët në vijim. Galatasaray arrin një tjetër goditje të madhe pas Eesley Sneijder. Galatasaray i ofroi një kontratë për 1 vit e gjysmë me të drejtë rinovimit edhe 1 sezon tjetër ndërsa vlera e saj do të jetë 7.5 mln euro dhe 30 mijë euro për çdo ndeshje të luajtur.

Gana dhe Mali në çerekfinale

Ghana dhe Mali kalojnë në çerekfinale të Kupës së Afrikës, duke nxjerrë jashtë Kongon dhe Nigerin. Mbohani shënoi golin e dytë personal në këtë edicion pas atij me Ganën. Mali kundërpërgjigjet në minutën e 14' me anë të Samasa-s. Gana kalon në avantazh në minutën e 6' me anë të Gyan Asamoah. Në minutën e 23' Atsu kthen në gol asistin e dhënë pikërisht nga kapiteni Gyan Asamoah. Në minutën e 49 Boye vulos fitoren me një super gol. Në çerekfinale Gana do të përballlet me Kepin e Gjelbër, ndërsa Mali ndeshet me Afrikën e Jugut.

Merkato

Baloteli i jep lamtumirën City-t

ANGLI

Mario Baloteli nuk do të jetë pjesë e ekipit të Manchester City-t për pjesën e mbetur të edicionit duke u divorcuar nga sheikët pas një serie problemesh me trajnerin Mancini, i cili për ironi të fatit vetë e solli dhe vetë do ta largojë nga Anglia. Lajmi bëhet i ditur nga 'The Sun' që deklaroi se Mario ka shtuar një darkë në shtëpinë e tij për shokët e ekipit me arsyen se do të largohet. Në fund të darkës me miqtë e tij, Super Mario ju ka deklaruar shokëve të ekipit se do të rikthehet të luajë në 'San




Kontrata

Xavi firmos me Barçën deri në 2016

Xavi Hernandez ka firmosur zyrtarisht kontratën me Barcelonën. Mesfushori spanjoll dje në praninë e presidentit Rosell ka nënshkruar kontratën e re, e cila do deri me 30 qershor të vitit 2016. Jam i lumtur për mundësinë dhe

faktin që do të jem i Barcelonës deri në fund të karrierës. Kjo është një mundësi që secilin e bën të lumtur" deklaroi Xavi. Mesfushori është një nga pikat më të forta të ekipit të Barcelonës së bashku me Mesin e Iniestën.




Kupa e Mbretit

Ronaldo: Mezi po e pres "El Clasicon" me Barcelonën

SPANJE

Ylli i Realit të Madridit, Cristiano Ronaldo në prag të ndeshjes së parë për gjysmëfinalen e kupës së Mbretit përballë ekipit të Barcelonës ka deklaruar se mesi po e pret sfidën.

"Çdo "El Clasico" është e rëndësishme dhe e komplikuar në të njëjtën kohë. Barcelona është një ndër ekipet më të mëdha dhe të forta të momentit. Luajmë në fushën tonë dhe besoj se kemi mundësi të mëdha për të fituar. Mezi e presim ta luajmë këtë përballje, ku




shpresojmë të marrim një rezultat sa më pozitiv" shprehet Ronaldo. Ndërkohe që dje ka bërë prezantimin portieri Diego Lopez ku ka deklaruar se nuk ka ardhur për të zënë vendin e Casillas.

PARADE FJALEKRYQESH

INGA Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

- Fillojnë matjen.
- Në krye të sportistëve.
- Skuadra që nuk duhet... shkëlur.
- Arben, që që bomber i paharuar.
- Gjysmë recete.
- Gjysma e klubit.
- Mish pa kocka.
- Një gimnasikë në muzikë.
- Oerter që hidhte diskun.
- Riproduar pjesërisht.
- Gabim pa ekstreme.
- Personazhi në foto.
- Personazhi në foto.
- Qendër mësimi.
- Ente Lokale Durrës.
- Rusi këngëtare.
- Fiket pa fe.
- Do aktore.
- Poeti kur... nuk pi
- Si moral.
- Gilman te

VERTIKAL

- Gjysmë milion.
- Andej nga kreu.
- Derisa... janë në fund.
- Pak servilizëm.
- Eshhtë skuadër.
- Të parat më slalom.
- Ka bërë golin.
- Thomas te Bayern.
- De Biassi në stolin kuqezi.
- Slade de... skuadër franceze.
- Mund të jetë shërimi.
- Fillojnë takimin.
- Mund të kërsejnë së gjati.

- Dy herë në skenë.
- Le... siç thirrej Michel Platini.
- Markë e njohur orësh.
- Eshhtë artistik me tutu.
- Fortuzi... që ishte Zogu te Tirana.
- Tare që hidhte diskun dikur.
- Mbledh basket separatistë
- Gjysmë rekord.
- Një brazilian te Sampdoria.
- Ente Kërkimore Fier.
- Në krye të skuadrës.
- Gol për Gerd Müller.
- Pak misterioze.
- Fillojnë llogarinë.
- Diku në qendër.
- Me të nxjerrin një tapë.
- Fillojnë një periudhë.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 39 KUTI

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																
2																
3																
4																
5																
6																
7																
8																
9																
10																
11																
12																

HORIZONTAL

- E famshme ajo e psherëtimave.
- Eshhtë shkollë i Prospero-s -Fillojnë afër.
- Eshhtë shtëpi i ndarë nga feja.
- Mbetur në fund.
- Ndal në kryqëzim.
- Initiallet e Lane aktore.
- Janë kolektivë si populli.
- Kaluar në krye.
- Herman që krijoi Moby Dick.
- Katerina e fundit e Henrikut VIII.
- Eshhtë telefilm.
- Initiallet e Armstrong Satchmo.
- Makinë indiane.
- Një kandidatë për titull.
- Skuadër greke.
- Mund të jetë i formës së prerë.
- Amerika në Brazil.
- Kush nuk ka... s'ka as kohë e dëshirë.
- Ajo e punës paguhet.
- Një është shiljeje.
- Ohjra Automjetëve të Ndërrimit.
- Ritet pa ekstreme
- Janë politike.
- Ndal në kufij.
- Patricia këngëtare.


- Këndonte dikur.
- Ekstreme në letër.
- Mund të jenë kanalet.
- Lumë në Spanjë.
- Vincenzo që kompozoi Norma.
- Avatit regjisor.
- Initiallet e Moravia-s.
- Makinë çeke.
- Janë statet në videogame.
- Initiallet e Redford.
- Fise pa fe.
- Eshhtë e lehtë më meeting.
- Agjenci Ekonomike Polake.
- Mund të jenë edhe polare të tilla.
- Komandohen nga gjeneralët.
- Ela e volejbolit.
- Kokëkujia e Maranello-s.
- Një anestetik.
- Kompozoi II trillo del Diavolo.
- Haset pa kufij.
- Një shtet aziatik.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME




FJALEKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMER TË NJËJTË



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



HOROSKOPI nga zozja MERI

DASHI
Sot dita nuk do keje vetëm prëmtime pom ë të njëjtën kohë do ndjeni se nga fjalët kalohet në vepra. Udhëtime me njerëz të dashur dhe plane për fillime të reja në projektet tuaja do kenë përparësi në ditën e sotme.

DEMI
Do keni një ditë ku zotësia por edhe shanset që do ju jepen do bëjnë që të keni një sukses të madh. Do keni mundësi të bëni blerje apo të qelësoni në problem familjar që lidhet me ndryshime apo me ekonomi.

BINJAKET
Për ju dita e sotme do jetë dita e vënis në funksionim të planeve tuaja. Cdo gjë që ka të bëjë me jetën personale do ketë një zhvillim pozitiv drejtë zgjidhjes së tyre. Ka mundësi të keni sukses në një cështje sentimentale.

GAFORRJA
Dita e sotme do rezultojë një rzigjim apo një dalje nga konfuzioni, që ju ka përfshirë në shumë aspekte të jetës. Një cështje ekonomike do sjell fitime dhe në disa raste të vecanta mund të dëmshpërbleheni.

LUANI
Ka mundësi që sot të gjeni mbështetjen dhe përkrahjen që keni kërkuar nga miqtë dhe përkrahësit tuaj. Mund të keni një njëje të reja të cilat do rezultojnë shumë të mira dhe të qëndrueshme sin ë shoqëri ashtu dhe në dashuri.

VIRGJËRRESHA
Dita e sotme do jetë e vçantë, sidomos në lidhje me kamierën dhe emrin tuaj si dhe publikimin e punës. Ka shumë mundësi të fillori një proces të rëndësishëm për ju apo të zini një pozicion të rëndësishëm në bashkëpunimet apo punën tuaj.

PESHORJA
Kjo periudhë duhet shfrytëzuar nga ana juaj përse i përket planeve që mund të keni përse i përket studimeve, kontakteve me jashtë, udhëtimeve apo marrëveshjeve nga më të rëndësishmet për të ardhmen tuaj.

AKREPI
Kjo periudhë më shumë se kurrë flet për planet tuaja në aspektin ekonomik. Në diskutimet apo levizjet që do keni përse i përket cështjeve ekonomike ka mundësi të shikoni të ardhurat tuaja të shtohen por edhe mundësi të zgjeruar marrëdhëniet

SHIGJETARI
Dita e sotme do ketë të bëjë më shumë në lidhje me marrëdhëniet që keni me të tjerët. Në cift me sa duket do jetë më të vërtetë e sqarueshme në rast problemesh dhe në se keni dyshim për temarë vendime serioze këtë do ta bëni tani.

BRICJAPI
Kjo ditë do ketë të bëjë në përgjithësi me jetën tuaj të mërditshme dhe sidomos me punën. Do keni mundësi të vendosni për një ndryshim në lidhje me punën. Do keni akoma dhe mundësi që të rrisni të ardhurat tuaja.

UJORI
Dita e sotme do jetë një ditë me të vërtetë e mrekulueshme përse i përket cështjeve erotike. Do keni mundësi në mirë përse i përket një bashkëpunimi dhe do ndjehni shumë të kënaqur me këtë bashkëpunim.

PESHQIT
Dita e sotme do ketë të cështje që lidhen me shtëpinë. Do keni mundësi të punëshoheni nga dikush i afërt apo të rrisni të ardhurat e një biznesi. Nuk përjashtohet mundësia e një ndryshimi në ambientet e shtëpisë apo një zhvendosje.

SUDOKU

		6	9	8				
	7	4		8	1	3	6	
8	1		7		5		4	
	8	5				7		4
2	3						8	6
4	9					5	2	
	9		5		3		1	7
	4	1	9	7		6	5	
		2		4	6			

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

3	2	1	6	5	8	9	4	7
7	8	4	3	1	9	2	6	5
9	5	6	7	2	4	1	3	8
5	4	9	1	3	2	7	8	6
6	7	2	4	8	5	3	1	9
8	1	3	9	7	6	5	2	4
1	9	5	8	6	3	4	7	2
4	3	8	2	9	7	6	5	1
2	6	7	5	4	1	8	9	3

LAJME
NGA BOTA

■ **Opozita mbron Krasniqin**
Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi nuk e shteh të rrezikuar të ardhmen e tij politike pas pezullimit të aktivitetit politik në Partinë Demokratike të Kosovës. Ai tha se për këtë vendosin vetëm qytetarët e Kosovës. Në daljen e parë para gazetarëve pas njoftimit se nuk do të marrë pjesë në kongresin e PDK-së, kryeparlamentari Krasniqi nuk deshi të komentonte më shumë rreth kësaj çështjeje.

■ **Daçiq: UÇPMB si Al Qaeda**
Kryeministri serb Daçiq nga Shkupi porositi se nuk do të lejohet që shqiptarët të provokojnë Serbinë me përmendore të ushtarëve të UÇPMB-së, të cilët edhe një herë i quajti terroristë. "Serbia nuk është banana-republikë, ajo ka ligjet e veta. Mendoni sikur të ekzistojnë në Nju Jork përmendore e Al Kaeedës ose në Spanjë përmendore e grupeve terroriste. Prandaj lapidarin në Preshevë nuk mund ta komentoj ndryshe veçse si provokim ndaj shtetit të Serbisë. Në Preshevë ekzistojnë 22 përmendore të UÇK-së dhe UÇPMB-së dhe shteti ka heshtur, derisa u vendos ajo përmendore në qendër të Preshevës, para ndërtesës së komunës", deklaroi Daçiq.

■ **Berlusconi: Mussolini, një lider i madh**
Kandidati për t'u rikthyer në pozicionin e Kryeministrit të Italisë, Silvio Berlusconi, ngjalli polemika kombëtare, pasi përgëzoi ish-diktatorin Benito Mussolini, në ditën përkujtimore të Holokaustit në Itali. Në një ceremoni përkujtimore në nder të viktimitave në Milano, ditën e hënë, Berlusconi tha se "Ducja" kishte gabuar me ligjet e tij të diskriminimit racor dhe nenet e adresuara veçanërisht ndaj hebrenjve, por se në total, "ai mbetet një lider i madh".

■ **Ekzekutohet babai që hëngri fëmijët nga uria**
Një koreanovenc u ekzekutua pasi vrau dhe hëngri dy fëmijët e tij, raporto "Daily Mail" ditën e hënë, duke cituar burime brenda vendit më të izoluar të botës. Sanksionet e reja ndërkombëtare, bashkuar me shpenzimet marramendëse ushtarake, duket se po krijojnë një zi të re buke në vendin komunist me 25 milionë banorë.

■ **Chavez rikuperohet nga infeksioni në mushkëri**
Presidenti i Venezuelës, Hugo Chavez, është rikuperuar plotësisht nga një infeksion në rrogët e frymëmarrjes, që i rrezikoi jetën pas një ndërhyrjeje për heqjen e një mase tumorale në Kubë, muajin e shkuar. Ishte Ministri i Informacionit, Ernesto Villegas, ai i cili bëri të ditur këtë zhvillim pozitiv të shëndetit të presidentit, në raportin e tij të përgjithshëm mbi gjendjen e 58-vjeçarit.

■ **Irani dërgon një majmun në hapësirë**
Irani arriti të dërgonte me sukses një majmun në hapësirë, lajmëruan dje mediat ndërkombëtare. Primati udhëtoi me raketën "Pishgam", e cila arriti në një lartësi prej 120 kilometrash, përpara se të fluturonte në orbitë dhe të rikthehej e padëmtuar në tokë. Televizionet kombëtare treguan imazhe të majmunit, i cili do të kapsula e tij në gjendje të shkëlqyer shëndetësore.

■ **Trashëgimi i fronit në Holandë**
Mbretëresha e Holandës do t'i adresohet mbrëmjen e së hënës popullit ku sipas hamendësimeve të medias vendase pritet të njoftojë tërheqjen nga fronti për t'i hapur rrugë emërimit të djalit të saj, Princit Willem-Alexander. Mbretëresha Beatrix, e cila së shpejti do të mbushë 75 vjeç, ka regjistruar mesazhin e saj nga Pallati Mbretëror në Hague. Tërheqja e saj do t'i japë fund mbretërimit 23-vjeçar.

■ **Medvedev: Regjimi i al-Assad po shembet**
"Shanset e presidentit Bashar al-Assad për të qëndruar në pushtet po zbehen dita ditës, ndërsa revolta 2-vjeçare kundër regjimit të tij po forcohet gjithmonë e më shumë". Ky ishte vlerësimi që i bëri situatës në Siri kryeministri i Rusisë, Dmitry Medvedev, në një intervistë të transmetuar mbrëmjen e së dielës në rrjetin "CNN".

DIGITALB

TOKESORE
KANALI 48Do na ndiqni në
gjithë Shqipërinë

DIGITALB

SATELITOR
KANALI 50Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë,
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi
dhe në pjesën tjetër të Europës

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIERALBANIAN BROADBAND COMMUNICATION
KANALI 158

kasketa

nga **KAstro ZIZO**

cdo të mërkurë
dhe të shtunë
ora 23:00

NË TELEVISIONIN

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit

• Alba Malltezi
Drejtoreshë e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group• Anila Basha
Drejtoreshë e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor• Genc Kondi
Zv. Kryeredaktor• Politika: Jakin Marena
• Ekonomia: Genc Kondi
• Sociale: Esmeralda Keta
• Kulturë: Admirina Peçi• Design: Altin Aliaj
Genti Manelli• Website: Suela Gera
Indrit Maraku• Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com• Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
Ermal Kacaniku
cel: +355696088847